
Fjala jonë	2
Falluxha.doc	3
Iraku u sulmua për t'u mbrojtë Izraeli.....	6
Lufta kundër terrorizmit	9
Nata kur u dogjën mus-hafet	11
Shejtanët e ndryshëm dhe metodat e tyre	14
Jeto një jetë të mirë!.....	17
Shpalosi zullumi fytyrën e vërtetë.....	21
Veçoritë e ummetit të Muhammedit, alejhisselam.....	26
Dyert e të mirës.....	30
Lënia e dispozitave të shariatit nga ana e shteteve muslimane ka sjellë padrejtësi njerëzve	36
Të veshura, të zhveshura.....	37
Parapëlqehet ndarja e gjinive në arsim	43
Mbulesa nëpër kohëra	44
Përhapja e kulturës së çiltërisë.....	50
Imam Muhammedi	52
El-Begavi	53
Imam Taberani	54
Ibën Hibban	56
Letra e humbur	60
9. Lidhja farefisnore	62

edicion i botuar / viti i parë / nr: 9

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

redaktor teknik: Azem Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Falluxha.doc

Falluxha nuk është ndonjë “qytet i shenjtë” por megjithatë çdo shpirt fisnik refuzon shtypjen dhe poshtërimin dhe në këtë mënyrë Falluxha, Iraku dhe çdo vend mbi tokën e Allahut posedon këtë ndjenjë që kërkon o një jetë me dinjitet o një vdekje dinjitoze duke u përpjekur për ta arritur atë.

Rezistenca ndaj pushtimit kolonialist britanik në Falluxha kur njerëzit e saj ishin të mobilizuar nga Shejh Dari dhe bënë të mundur rrëzimin e aeroplanëve britanik. Shumë irakenë u martirizuan në atë përpjekje dhe vdekja e shejh Darit atëbotë ishte e parë si një fillimi i fundit të pushtimit kolonialist.

Forcat e koalicionit tani shkaktuan këtë rezistencë në Falluxha ndaj tyre me budalla-llëkun e tyre dhe moskokëqarjen e konsideratave më themelore humanitare. Forcat amerikane janë vërsulur përpara me një ngut dhe në mënyrë provokuese për të imponuar kontrollin e tyre mbi qytetin.

Ata iu përgjigjën demonstruesve paqësorë që protestonin sjelljen e forcave të koalicionit dhe kërkonin largimin e tyre duke qëlluar mbi ta, duke vrarë dhe plagosur një numër nga ata. Ata erdhën me një shfajsim të përgatitur që para se ata i vranë ata dymbëdhjetë demonstrues në “vetëmbrotje”. Është i njëjti shfajsim që bënë kur ata dërguan aeroplanët e tyre dhe lëshuan bomba mbi civilët. Pastaj ata vazhdojnë për të shpjeguar në detaje pallavrat e Departamentit Amerikan të mbrojtjes që objektivat e forcave të koalicionit janë për të çliruar 30 milion nje-

rëz — njerëzit e Irakut. Atëherë kush janë ata që luftojnë tani? Kush janë ata njerëz të cilët janë ngritur kundër tyre në çdo moment?

Administrata e Bushit fitoi luftën e saj kundër regjimit despotik dhe tiran të partisë ba-the në Irak. Megjithatë pa asnjë lloj legjitimiteti a do të jetë e aftë të bëjë të njëjtën gjë kundër masave muslimane.

Refuzimi i agresionit të huaj është një ndjenjë në rritje që është duke u përhapur nga Falluxha deri tek të gjitha qytetet e Irakut. Falluxha është një gacë e ndezur flakë.

Ky qytet mbi Eufratin nuk njeh qetësi. Përballet tërë natën me të gjitha llojet e sulmeve, duke sakrifikuar gjakun e banorëve të saj të ndershëm. Ata njerëz janë duke e paguar çmimin për heshtjen e muslimanëve dhe popujve të botës të cilët janë duke injoruar çfarë është duke u ndodhur atyre.

Më tepër sesa 700. 000 njerëz jetojnë në Falluxha, me durim përballojnë bombardimet dhe bllokadat ndërsa xhamitë dhe ballkonet e shtëpive të tyre janë bërë shënjestra për snajperat e forcave të koalicionit.

Imazhet që njerëzit janë duke parë janë duke nxitur zemërimin dhe urrejtjen e tyre. Është duke i bërë ata të refuzojnë demokracinë e raketave, bombave të zgjuara dhe ushtarëve të verbër.

Politikat agresore të forcave të koalicionit janë vetëshkatërruese. Ata janë duke insistuar me kokëfortësi në gabimin që nuk do t'i çojë ata askund në marshimin e gjatë.

Çfarë të mire ka tek ata të cilët flasin për miqësi, liri dhe paqe ndërsa veprat e tyre flasin për luftë, arrogancë dhe shkatërrim? Në këtë mënyrë ata kanë humbur të gjithë kredibilitetin me njeriun e rrugës në shoqëritë arabe dhe muslimane. Ka një proverb arabe: "Si mund të të besoj, kur kjo është një prerje e sëpatës tënde?"

Fjala "falluxha" në arabisht do të thotë vend që është i mirë për punim. Tani një qëndrim heroik është duke u rritur atje në një bereqet historik dhe të ndershëm.

Në mënyrë alternative "falluxha" do të thotë një përshkrim dhe një fitore. Kjo është një ndjenjë optimiste për ata të cilët janë aq pak të pajisur (me mjete lufte) dhe të cilët janë duke mbrojtur të drejtat e tyre, nderin e tyre dhe pavarësinë kundër një kundërshtari shumë të armatosur dhe të ashpër.

Lutjet e muslimanëve janë për ata njerëz, duke i kërkuar Allahut ndihmë dhe për t'i dhënë atyre sukses. Ne duhet të lutemi në thellësitë e natës dhe të bëjmë dua, duke iu lutur Zotit tonë...

Ne duhet të kemi besim në premtimin e Allahut. Ne duhet të jemi të durueshëm, besnik dhe të jemi të sigurtë në zemrat tona. Ne nuk duhet të sulmojmë njëri-tjetrin, nga zemërimi dhe vuajtjet tona.

Përsa i përket irakenëve ata janë njerëz të vendosur që ne presim që do të përballojnë plagët e tyre me fuqi. Ata duhet të punojnë për të siguruar bashkimin e tyre dhe për të shmangur konfliktin midis njëri-tjetrit.

Ne kërkojmë prej Allahut - që përveç Tij nuk ka zot tjetër - Krijuesit të qiejve dhe tokës për t'i mbrojtur irakenët dhe për t'i dhënë atyre fitore.

Shkroi: Selman el-Avde
Përktheu: Ammar Abdulxhelil

Sqarim nga Komisioni i përhershëm për hulumtime dhe fetva në Arabinë Saudite rreth ngjarjeve në Falluxha

Komisioni i përhershëm për studime shkencore dhe fetva, ditën e enjte (25/02/ 1425H/ 15/04/2004 G) nxorri një sqarim në të cilin dënon ashpër krimin e okupuesve të Irakut, të cilin krim e bëjnë anekënd Irakut, e në veçanti në Falluxha.

Në vijim mund të lexoni tekstin e plotë të sqarimit:

Hamdi i takon All-llahut, paqa dhe mëshira qoftë mbi Resulull-llahun, familjen e tij, shokët e tij dhe atyre që shkojnë pas udhëzimit të tij...

All-llahun e falënderojmë, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, familjen, shokët dhe ata që udhëzohen me udhëzimin e tij...

Komisioni i përhershëm për studime shkencore dhe fetva në Mbretërinë e Arabisë Saudite reagon ashpër kundër kësaj që u ndodh vëllezërve tanë musliman në Irak, e sidomos në qytetin Falluxha, siç është vrasja, trishtimi i njerëzve të sigurtë, shkatërrimi i pronës, rrënimii xhamive mbi kokat e falësve, nga dora e okupatorit të këtij vendi musliman dhe këtë që është duke i ndodhur muslimanëve në Irak e konsiderojmë prej armiqësisë dhe zullumit më të madh.

Komisioni i përhershëm për studime shkencore dhe fetva duke reaguar kundër këtij veprimi kriminel, i cili i tejkalon të gjithë kufinjët, e thërret secilin njeri të paanshëm në botë, qoftë musliman ose jomusliman që të reagojnë kundër këtij sulmi të egër dhe të veprojnë me të gjitha mjetet dhe mënyrat për ta ndalur këtë krim dhe për ti denuar përgjegjësit për këtë vepër.

Komisioni i nxitë vëllezërit në Irak që të durojnë dhe të përqëndrojnë, të kenë unitet dhe të jenë të sinqertë në kontributin për ta ndihmuar fenë e All-llahut, për ta ngritur fja-

lën e Tij dhe për ta zbatuar sherijatin e Tij, e le të jenë të bindur në ndihmën e Zotit, pasi që All-llahu u ka premtuar robërve të Tij fitore dhe sundim, kurse premtimet e Tija janë të vërteta, ato sigurisht se do të realizohen, edhe nëse vonohet pak realizimi i tyre...

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) All-llahun, Ai ju ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja”. (Muhammed: 7).

“...E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues”. (El-Haxhxh: 40).

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit”. (en-Nur: 55).

E lusim All-llahun e Lartë dhe të Fuqishëm që ta ndihmojë fenë e Tij dhe ta ngrisë Fjalën e Vet, ta ruan Irakun dhe banorët e Irakut dhe të gjitha vendet e muslimanëve nga çdo e keqe dhe e urrejtur.

Paqa dhe bekimi qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhammedin, mbi familjen dhe mbarë shokët e tij...

Komisioni i përhershëm për studime shkencore dhe fetva
Kryetar: Abdul-Aziz ibën Abdull-llah Alu Shejh
Antar: Salih El-Feuzan
Antar: Abdull-llah ibën Abdurrahman El-Gudejan
Antar: Abdull-llah ibën Muhamed El-Mutlak
Antar: Abdull-llah ibën Ali Er-Rekban
Antar: Ahmed ibën Ali Sejr el-Mubareki
Përktheu: Bekir Halimi
Omer Berisha

A ka kush e qanë Falluxhën?!

Ai që vështron sot botën sheh gjëra të çuditshme, sheh hegjemoninë amerikane e cila përfaqësohet nga kjo qeveri republikane, e cila i vihet në kokë secilit që i kundërshtohet hirit të sajë, ose nuk i nënshtrohet dëshirave të saja...Nuk do të flas për çorodinë që e bën kryetari amerikan, Bushi junior, dhe qeveria e tij në botë, sepse mbarë bota është mbushur me çorodinë e tyre dhe nënçmimin e vullnetit të popujve dhe aftësitë e tyre. Ata botën e shikojnë si sklevër, të cilët duhet ti nënshtrohen dëshirës së tyre. Shembulli më i madh për këtë është kjo që ndodh sot ne Falluxha. Ky gjenocid që është duke ndodhur atje, e as një të dhjetën e kësaj nuk e ka bërë Sadam Husejni.

Falluxha është në shtettrëhim, i rrënohen spitalet, i shkatërrohen xhamitë, vriten gratë dhe fëmijët, tërë kjo ndodh para syve të mbarë botës, mirëpo askush nuk mundet as të flet, as të denoncon, as të kundërshton këtë. Edhe ata që kanë pasur shpresa në Kombet e Bashkuara, edhe ata i kanë humbur këto shpresa kur, të mërkurën, 17, sefer, 1425, ose 07, prill, 2004, kur Sekretari i Përgjithshëm doli që të flet për konfliktin në Sudan, kjo tregoi qartë se lufta në botë është selektive. Ai kërkonte nga faktorët relevant ndërkombëtar që të ndërhyjnë ushtarakisht për Darfordin, mirëpo nuk pati mundësi ta thotë as një fjalë për ndodhitë e Falluxhës heroike!

Pasha All-llahun, kjo është turp për tërë botën, e cila nuk ka mundësi që zullumqarit t'i thotë: "ti je zullumqar".

Unë do të përmendi në vijim disa gjëra që kanë të bëjnë me ndodhitë e fundit të Falluxhës heroike:

Një: Asgjë nuk mund ta shkatërrojë Amerikën dhe forcat e aleancës sikur xhahadi në rrugë të Zotit, dhe le ta dijë Bushi dhe banda e tij se xhahadi do të mbetet deri në ditën e Kijametit.

Dy: e kemi obligim t'i mbështetim publikisht vëllezërit tanë në Falluxha, me pasuri, armë, lutje, barëra, përhapje të lajmeve të tyre dhe me mbulimin e ndodhive atje në mënyrë të reale në të gjitha mjetet e informimit.

Tre: pasha All-llahun është vërejtje për të gjitha qeveritë, të cilat frikohen nga terrorizmi, se Amerika është shkaku që të lindë terrorizmi... kur sheh gjakun e muslimanëve duke u derdhur... andaj xhelozia për nderin dhe gjakun e tij është ajo që e shtyn në këtë veprim...

Katër: secili që është lojal ndaj Amerikanëve duhet të dijë kufinj të kësaj çorodie dhe të distancohet nga terrorizmi amerikan dhe ta armiqësojë atë në të gjitha format.

Pesë: Falluxha nuk do të pushon dhe nuk do t'i nënshtrohet armikut, sepse një tokë që ka thithur gjak të dëshmorëve do të nxjerr gjenerata krenare, luftare dhe të lira.

Gjashtë: të gjitha rajonet irakiane duhet të ecin në rrugën e Falluxhës, ta luftojnë okupatorin, ta zmbarsin terrorizmin dhe bandën e tij, ti hapin frontet okupatorit në tërë Irakun dhe le të jetë parulla e tyre: "nisemi për luftë".

Shtatë: gazetaria arabe duhet të ketë pak turp dhe le ta kryej detyrën e saj gazetareske, ti mbulojë ndodhitë e Falluxhës ashtu siç duhet dhe le ta demaskojë terrorizmin amerikan.

Tetë: ju, o, luftëtarët e Falluxhës, kujdes nga mosmarrëveshjet dhe përçarjet, keni parasysh ngritjen e fjalës së All-llahut, kërkimin e Kënaqësisë së Tij dhe vdekjen në rrugën e Tij. Dëgjoni dhe respektoni udhëheqësit tuaj, kujdes nga mosdëgjimi i tyre dhe ikja nga zbatimi i urdhërave të tyre.

Nëntë: o ju shoqëri muslimane në mbarë botën, mbështetne Falluxhën... ngjallni çështjen e tyre në forume, parlamente, tubime shkencore dhe kulturore dhe shpallni zullumin amerikan.

Dhjetë: o ju shkrimtarë musliman, kujdes nga prekja e nderit të muxhahidëve, akuzimi i tyre ose përbuzja e tyre, sepse ata janë duke e mbrojtur një anë prej anëve të islamit. Qëndroni larg cilësive të dytërisë.

All-llahu ynë, nxito fitorën dhe sundimin, na gëzo syrin dhe na rehato zemrën me dështim të okupatorit. Amin.

Dr. Velid Uthman Reshudi
16.4.2004

Iraku u sulmua për t'u mbrojtë Izraeli

Iraku nën udhëheqjen e Saddam Husseinit nuk paraqiste rrezik për SHBA-të por për Izraelin, që është një shkak që Washingtoni sulmoi shtetin arab, thuhet në një fjalim të bërë nga një anëtar i një grupi të kundërzbulimit të shkallës së lartë të Shtëpisë së Bardhë.

Inter Press Service (IPS) zbuloi këto thekse nga Philip Zelikow, që tani është drejtor ekzekutiv i grupit që është themeluar për të

hulumtuar sulmet e 11 shtatorit 2001 në SHBA, komisionit të 11 shtatorit, në të cilën ai thotë se motivi kryesor për invazionin para një viti ishte të eliminohet rreziku për Izraelin, aleatin kryesor amerikan në Lindjen e Mesme.

Deklarimi i Zelikowit se invazioni në Irak është lansuar për të mbrojtur Izraelin duket kundërshtim i pozicionit publik të presidentit amerikan George Bush dhe administratës së

tij, që asnjëherë nuk ka bërë ndonjë lidhje ndërmjet luftës kundër regjimit të Saddam Husseinit dhe brengën për sigurinë izraelite.

Administrata në vend të kësaj ka insistuar se ka lansuar luftën për të çliruar popullin irakian, për të shkatërruar armët irakiane për shkatërrim masiv dhe për të mbrojtur SHBA-të.

Zelikow ka bërë deklaratën e tij rreth “kërcënimit të papërmendur” gjatë pozitës së tij në grupin e mirëinformuar dhe të mirëlidhur të njohur si Bordi i Këshilltarëve të Presidentit për Kundërzbulim të Jashtëm (PFIAB) që drejtpërdrejt i raporton presidentit.

Ai i shërbeu bordit ndërmjet viteve 2001-2003.

“Pse Iraku do ta sulmonte Amerikën ose do të përdorte armatim bërthamor kundër neve? Do t’ju tregoj pse mendoj që kërcënimi i vërtetë (është) dhe që ishte prej vitit 1990 - është rreziku ndaj Izraelit”, ka thënë Zelikow para publikut në Universitetin Virginia më 10 shtator 2002, duke folur në një panel të ekspertëve të politikës së jashtme, ku trajtohej ndikimi i 11 shtatorit në luftën e ardhshme kundër organizatës Al-Qaeda.

“Dhe ky ishte kërcënimi që nuk guxoi ta thotë emrin, për shkak se evropianët nuk brengoseshin thellë për atë kërcënim, ju them sinqerisht. Dhe Qeveria Amerikane nuk dëshironte të mbështetet retorikisht në të, për shkak se nuk është një shitje e famshme”, ka thënë Zelikow.

Këto informata janë të parat që paraqiten nga një burim shumë i afërt me Administratën e Bushit, duke pranuar se lufta, që deri tani ka shkaktuar vdekjen e rreth 600 ushtarëve amerikanë dhe mijëra irakianë, ka qenë e motivuar nga dëshira e Washingtonit për të mbrojtur shtetin hebre.

Administrata, që është e rrethuar nga pro-izraelitë, neokonservativë, aktualisht është duke luftuar në një fushatë për të refuzuar akuzat se ajo ka kthyer “luftën kun-

dër terrorizmit” të cilën e lansoi pas 11 shtatorit, duke u ndalur në Irak, që del se nuk ka paraqitur asnjë kërcënim të drejtë për drejtë kudnër SHBA-ve.

Izraeli është aleati më i madh amerikan në Lindjen e Mesme dhe ai pranon ndihmë vjetore të drejtpërdrejtë prej 3-4 miliardë dollareve amerikanë.

Edhe pse 16 anëtarët në PFIAB vijnë jashtë Qeverisë Amerikane, ata gëzojnë besimin e presidentit dhe kanë qasje në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me kundërzbulimin e jashtëm, që është e nevojshme për ta luajtur rolin e tyre vital të këshilltarëve.

E njohur në qarqet e kundërzbulimit si “Piffy-ab”, bordi vlerëson agjencitë vendase të kundërzbulimit dhe kontrollon gabimet që i bëjnë.

Të caktuarit e papaguar në bord kanë nevojë për një pastërti sigurie e njohur si “code word” (fjala kod) që është më e lartë se “top secret” (top sekret).

Këshilltari për siguri nacionale i presidentit të parë George Bush (1989-1993) Brent Scowcroft, aktualisht udhëheq me bordin në punën e tij që vëzhgon një numër të grupeve kundërzbuluese, duke përfshirë edhe agjencinë CIA, grupe të ndryshme të kundërzbulimit ushtarak dhe Zyren Kombëtare për Hulimtim në Pentagon.

As Scowcroft, e as Zelikow nuk janë përgjigjur në thirrjet telefonike dhe në e-mail porositë nga IPS për këtë raport.

Zelikow ka lidhje të vjetra me Administratën e Bushit. Para caktimit të tij në PFIAB në tetor të vitit 2001, ai ishte pjesë e ekipit presidencial për tranzicion në janar të vitit 2001.

Në atë kapacitet, Zelikow formuloi një memorandum për këshilltaren për Siguri Nacionale Condoleezza Rice për ri-organizimin dhe ri-strukturimin e Këshillit për Siguri Nacionale.

Richard A. Clarke, që ishte koordinator kundër-terrorizmit për paraardhësin e Bu-

shit, presidentin Bill Clinton (1993-2001) që poashtu ka punuar edhe për Bushin e parë, paradokohe ka akuzuar administratën aktuale për mosmarrjen parasysh të paralajmërimeve terroriste, ka thënë Zelikow që ishte një nga ata që kanë paralajmëruar për një rrezik urgjent nga Al-Qaeda në dhjetor të vitit 2000.

Vetë Rice ka shërbyer në Këshillin për Siguri Nacionale gjatë administratës së Bushit të parë, dhe vazhdimisht iu ka bashkangjitur Zelikow rreth përpilimit të librit të botuar në vitin 1995 rreth ribashkimit të Gjermanive.

Zelikow ka pasur lidhje edhe me një zyrtar tjetër të lartë të Administratës së Bushit – Robert Zoellick, përfaqësues aktual i tregtisë. Këta të dy kanë shkruar tri libra së bashku, duke përfshirë edhe atë në vitin 1998 rreth SHBA-ve dhe “Muslim Middle East” (Lindja e Mesme muslimane).

Përveç pozitës në komisionin e 11 shtatorit, Zelikow tani është poashtu edhe drejtor i Qendrës Miller për Marrëdhënie Publike dhe profesor i historisë në Universitetin Virginia.

Lidhjet e ngushta me administratën shkaktuan akuza të konfiktit të interesit në vitin 2002 nga familjet e viktimave të sulmeve të 11 shtatorit, të cilët protestonin caktimin e tij për pozitë në grupin hulmues.

Në fjalimin e tij, Zelikow, i cili fuqishëm ka mbështetur sulmin kundër diktatorit irakian, ka sqaruar edhe kërcënimin ndaj Izraelit duke argumentuar se Baghdadi gjatë viteve 1990-1991 ishte duke përgatitur sasi të mëdha të “pasurisë” për të lidhur “komunikacionet kundër pulsit elektromagnetik”, një efekt anësor i shpërthimit bërthamor që do të mund të shkatërronte komunikimet nëpërmjet radios, ato elektronike dhe elektrike.

Ajo ishte “një shpenzim jashtëzakonisht absurd, përderisa nuk planifikohet këmbim bërthamor – ata (zyrtarët irakianë) nuk ishin duke përgatitur këmbim bërthamor me

ne. Ato ishin përgatitje për këmbim bërthamor me Izraelin”, ka thënë Zelikow.

Ai poashtu ka sugjeruar se rreziku i rënies së armatimit biologjik në duart e lëvizjes kundër-izraelite Hamas, do të kërcënonte Izraelin e jo SHBA-të, dhe ato armë ndoshta kanë mundur të zhvillohen deri në pikën që ato do ta largonin Washingtonin nga sulmimi i Hamasit.

“Luani këto skenare”, ka thënë ai para audiencës, “dhe do t’ju tregoj, njerëzit kanë menduar për atë, por vetëm nuk janë duke folur për të shumë”.

“Mos i shikoni lidhjet ndërmjet Irakut dhe Al-Qaedas, parashtroni pyetjen, ‘a është Iraku i lidhur me Hamasin dhe Xhihadin Islamik Palestinez dhe me njerëzit që janë duke kryer sulmet vetëvrasëse në Izrael?’ Pyetje e lehtë për t’ju përgjigjur; dëshmitë janë të shumta”.

Deri tani, mundësia që SHBA të sulmojë Irakun për të mbrojtur Izraelin ka qenë shumë pak e përmendur nga disa intelektualë dhe shkrimtarë, me vetëm disa pohime nga burimet e afërta me administratën.

Analistët që i vëzhguan deklaratimet e Zelikow kanë thënë se ato janë dëshmi konkrete për një faktor në racionalen e fillimit të luftës, që është mbajtur në heshtje.

“Ne që kemi folur për të, në njëfar mënyre ne i referoheshim mbrojtjes së Izraelit si komponentë”, ka thënë Phyllis Bennis nga Instituti për Studime Politike me seli në Washington. “Por kjo është një pjesë shumë e mirë e dëshmisë për të”.

Të tjerët thonë se administrata duhet të akuzohet (fajësohet) për mos bërjen publike të qëllimeve të vërteta të saja dhe motiveve të vërteta të invazionit në Irak.

“Ata (administrata) vendosën të sulmojnë Irakun, dhe pastaj filluan të kërkojnë një politikë për ta arsyetuar atë. Ajo ishte një vendim në kërkim të politikës dhe për shkak të mënyrës nëpër të cilën kaluan, njerëzit janë

duke u përpjekur të lexojnë diçka në të”, ka thënë Nathan Brown, profesor i shkencave politike në Universitetin George Washington dhe ekspert për Lindjen e Mesme.

Mirëpo ai nuk i dha rëndësi lidhjes izraelite. “Sa i përket sigurimit të Izraelit, për mua nuk ka kuptim, për shkak se izraelitët ndoshta janë më të brengosur për Iranin se sa ishin për Irakun në aspektin e kërcënimit strategjik

afatgjatë”, ka thënë ai. Mirëpo, Brown ka thënë se fjalët e Zelikowit kishin peshë.

“Pa dyshim pozita e tij do t'i lejonte të flet me një ekspertizë më të madhe rreth mendimit të Administratës së Bushit, por nuk habitem që ai është pak më autoritativ se Wolfowitzi, ose Rice, Powell, ose kushdo tjetër. Të gjithë ata në njëfar mënyre ishin duke peshuar për një arsytim të vendimit që tani më ishte bërë”, ka thënë Brown.

Emad Mekay - IPS News
9.4.2004

Lufta kundër terrorizmit

Pasi që terrorizmi i kaplon edhe civilët paqësor, ajo paraqet një formë shumë të poshtër të heroizmit. Pa marrë parasysh se sa e drejtë është çështja, nuk arsyetohen këto mjete të urrejtura dhe sulmet e 11 shtatorit, 2001, dhe rastet tjera si ato në Kasablankë, Rijad, Istanbul, Moskvë, Hajfa, Kuds, kjo shkakton vetëm mllfosje dhe hidhërim. Këtë e bëjnë edhe disa qeveri gjë që njihet si terrorizëm shtetëror, si reagim kundër tyre.

Sulmet e vrazhda dhe të papritura të 11 shtatorit destabilizuan shumë shtete, andaj edhe nxituan për të nxjerur ligje që përkufizojnë krimet e reja dhe i ndalojnë disa organizata, i kufizojnë disa liri fetare dhe garanca kundër tejkallimit të disa të drejtave themelore. (Shih raportin e Organizatës “Amnesty international” për vitin 2002).

E para që ndërmori këto rregullime ishin Sh.B.A.- të, kur kongresi amerikan votoi më 26 tetor 2001 ligjin nacional, i cili i jep policisë dhe aparatit të sigurimit të drejta të mëdha, e përkufizon rolin e mbrojtjes dhe ri-

shikon imunitetin personal, që i nënkupton edhe të drejtat individuale. Ky ligj jep hapësirë për ndalime, internime dhe izolime të të dyshuarve, siç është rasti me të huajët, të cilët mund të burgosen pa kohëzgjatje të caktuar. Nuk është e domosdoshme posedimi i lejës ligjore për kontrollim dhe përgjim të bisedave telefonike ose për kontrollim të postës së thjeshtë dhe asaj elektronike.

Në kontekstin e devijimit të tepruar të sigurimit, kryetari Bush nënshkroi më 13 nëntor 2001 vendimin, sipas të cilit hapen gjykata ushtarake për të gjykuar të huajët dhe u ngrit burgu i Guatenamos, kurse më 5 janar 2004 filloi zbatimi i “programit për vizitë të Sh.B.A-ve”, që sipas të cilit bartësi i vizës duhet dhënë shenjat e gishtave dhe fotografi personale.

U konfirmuan ky varg i ligjeve imponuese dhe të çuditshme në kohën e paqës si shembull i shteteve tjera, duke filluar nga Britania, e cila nuk mendoj shumë për të kërcyer përmbi nenin e pestë të konventës europjane për të drejtat e njeriut (shih: “The

Economist”, 6. 12. 2003), që të nxjerë në vitin 2001 një ligj kundër terrorizmit, i cili u jep të drejtë të burgosjes të pakufizuar dhe pa akuzë ose gjykim, për secilin të huaj, i cili mund të paraqet rrezik për sigurinë e vendit.

Ministri i punëve të brendshme David Blanket shpreson në shtrëngimin e këtij ligji, i cili është më i rrepti në tërë Europën, dhe zbatimi i tij për të gjithë banorët e Britanisë. Nëse mund të gjykohen të akuzuarit në formë paraprake, në mungesë të jurisë, kurse njerëzit e sigurimit i zgjedhin gjykatësit dhe avokatët në këto gjykata speciale, për ta lehtësuar sjelljen e dënimeve kundër të dyshuarve. David Blanketi dëshiron që pasaportat të kenë elemente elektronike që i ruan shenjat e gishtave dhe të syve.

Brenda kësaj klime, e cila përputhet në shumë gjëra me romanin e Xhorxh Orvelit, qeveria franceze e ka shtuar edhe më shumë aparatin e sigurimit duke u mbështetur në ligjet e “Së pari Sarakoza” (mbi sigurinë në janar të vitit 2001 dhe mbi sigurinë e brendshme, shkurt të vitit 2003), pastaj ligjin tjetër në shkurt të vitit 2004. Ky ligj i fundit, i cili u kundërshtua nga sindikata e avokatëve, dallohet me ligjin mbi bisedat informative automatike, domethënë pa e ditur

njeriu, sipas mjeteve sekrete, kundër të cilave nuk mundet të bëjë asgjë dhe në kohë të pakufizuar. Sipas këtij ligji, i akuzuari mund të mbahet në paraburgim deri në 96 orë, me kusht që policia të përdorë teknologji të sofistikuar në këtë analizë, siç është përgjimi, depërtimi në grupe të ndryshme, nëpërmjet bashkëpunëtorëve të tyre, vendosja e mikrofoneve dhe kamerave në vende të veçanta dhe bastisja gjatë natës, kur nuk ka askush në rrugë.

Ky shembull i qeverive demokratike i ka stimuluar qeveritë diktatoriale që të nxisin për të hyp në trenin e luftës kundër terrorizmit. Në shtete siç është Kolumbia, Indonezia, Kina, Kongo, qeveritë mundohen ta ngulfatin opozitën duke u ngjitur atyre akuzë për “Raporte të mira me terrorizmin”.

Demokracitë e mëdha ato të cilat zakonisht e kanë perceptuar rrezikun e shkeljes të drejtave ekonomike, shoqërore dhe kulturore, kurse mbrojtjen e të drejtave politike i kanë vendosur në krye të preokupimeve.

Vallë, a do ti shtyjë frika e terrorizmit që ta mohojnë këtë kërkesë kryesore?

A vetvriten demokracitë para syve tona duke konfirmuar gjendje të jashtzakonshme dhe duke e vendosur policinë në palcë të sistemit të vet?

Ignacio RAMONET

Marrë nga: “Le Mond Diplomatic”, versioni arabisht, shkurt, 2004.

Përktheu: Bekir Halimi
2.4.2004



Nata kur u dogjën mus-hafet

Xhamia Bajrakli në Beograd është xhamia e vetme e mbetur nga 272 xhami, sa gjithsejt i ka pasur Beogradi nga gjysma e shekullit XIX, këto ditë përjeton momentet më të vështira të historisë së gjatë 315-vjeçare, sipas të dhënave zyrtare. Të dhënat tjera thonë se ajo është e vjetër edhe për 100 vjet më shumë, që është mjaft për të qenë objekti kulturor historik më i vjetër në qytet. Xhamia emrin e ka marrë sipas bajrakut me të cilën u ka dhënë shenjë xhamive tjera për fillimin e namazit.

Duke e djegur Xhaminë Bajrakli në mbrëmjen e 17 dhe 18 marsit, turmat e pakontrolluara si duket nuk kanë menduar për vlerën e saj historike dhe vendin që kjo xhami e ka në zemrat e muslimanëve të Beogradit.

Edukatori i mbrëmjes në internatin e medreses së Beogradit, ndërtesa e së cilës gjendet pranë xhamisë, tregon:

"Rreth orës 22:00 disa nxënës të medreses i kishte zënë gjumi, ndërsa disa të tjerë përgatiteshin për të fjetur. Në orën 23:00 kur u dëgjua zhurma para xhamisë, askush nuk ka menduar se kjo natë do të hyjë në histori. Duke dëgjuar britmat në afërsi të xhamisë, lajmërova policinë dhe muftinë e Beogradit. Zërat e paartikulluar të njerëzve dëgjoheshin gjithnjë e më shumë, por pastaj përnjëherë u qetësuan. Si qetësia para stuhisë. Xhandarmëria kishte refuzuar sulmin e parë të një grupi më të vogël prej rreth 100 huliganëve, por pastaj i lëshoi pozicionet e saja (si duket sipas urdhërave) duke e lënë një grup të policëve me disa vetura që ta sigurojnë xhaminë".

Në atë kohë në Nish, shumë njerëz ishin fotografuar para zjarrit të xhamisë së ndezur Hadrviç.

Turma e refuzuar shumë shpejt i konsolidoi radhët e saja, i përforcoi me një forcë shtesë fizike, mjete ndezëse dhe gurë, dhe pastaj guximshëm u nis drejt xhamisë duke i befasuar (?) policët që ishin duke e ruajtur dhe të cilëve u ishte urdhëruar të mos përdorin gaz lotsjellës dhe të mos gjuajnë në demonstruesit.

Turma mposhti policët dhe pastaj në mënyrë heroike u nis drejt xhamisë dhe ndërtesës së bashkësisë Islame si dhe medresesë. Për disa momente xhamia ishte në zjarr. Nxehtësia e zjarrit i thante lotët në sytë e Muhamedit, imamt kryesor të Beogradit, i cili gjith atë akt e vështronte nga afërsia. Xhamia në të cilën ka filluar të ecë dhe ka thënë fjalët e para të jetës, tani digjet para syve të tij.

Shumë qytetarë të Beogradit dhe gjith botes atë mbrëmje kanë mundur të përcjellin drejtpërdrejt dramën nga xhamia Bajrakli. Mirëpo, ajo dramë ka një akt, të cilën opinioni nuk e ka parë e as që ka mund ta shoh nëpër ekranet televizive. Në fjalë, ai akt bart me vete një tragjedi edhe më të madhe nga vetë akti i djegies së xhamisë.

Edukatori tregon: Në momentet kur policia ka ofruar "rezistencën" e fundit barbarëve, në ndërtesën e medreses kanë qenë rreth 15 djem, nxënës të medreses. Të frikësuar dhe të traumatizuar i mblodha në një dhomë duke menduar se çka të bëj: t'i nxjerr jashtë – do të thoshte se i vendos në mëshirën e

turmës së çoroditur. Kushedi sa prej nesh do të mbijetonin. Prita duke shpresuar se edhe ky sulm i huliganëve do të refuzohet. Zbrita në katin përdhesë të ndërtesës të shoh se çfarë po ndodh para xhamisë. Duke parë se “mbrojtja” e xhamisë ofron “mbrojtjen” e fundit, i çova fëmijët përmes shkallëve të mesme të ndërtesës (që nuk shihen nga rruga) deri te depoja e restorantit të xhamisë. Derën e deposë e çela me çelësin e dyerve kryesore dhe pastaj nxënësit një nga një, dolën në oborrin prapa ndërtesës. Kur dola në oborr dhe u ktheva prapa, ndërtesa e medreses ishte në zjarr! Nxënësit dilnin nga restoranti dhe panë huliganët se si hynë dhe ndezin medresen. Falenderimi i qoftë Allahut që katastrofa u shmang – vetëm disa sekonda na ndanin nga tragjedia e vërtetë! Deri sa qëndronim në oborr dhe mendonim se çfarë të bëjmë më tej, për shkak se huliganët ishin edhe jashtë oborrit, përnjehere u dëgjua zëri i një gruaje që kishte banuar në afërsi të medreses: “Ja ku janë, ja ku janë!” Një fqj serb na ofroi disa shkalë, me të cilat dolëm nga ana tjetër, në një oborr të një fqjuti, dhe prej atje u larguam të sigurtë”, përfundon edukatori.

Të nesërmen rreth drekës, vendosa të shkoj deri te xhamia. Në një afërsi prej rreth 10 metrave nga xhamia qëndronte një grup më i madh i policëve, të cilët e mbronin (siguronin) xhaminë. Nuk më lejuan të hy. Duke qëndruar jashtë zonës të cilën e mbronin policët, vështroja kalimtarët e rastit dhe ato të qëllimtë, të cilët e komentonin “incidentin”. Disa kalonin me buzëqeshje dhe me një gëzim të pafshehur, disa të tjerë me dëshprim, keqardhje dhe me lot në sy. Një djalosh pranë meje me një fanellë të vizatuar me ambleme të ndryshme tifoze fotografonte pamjen (thonë se një pjesë të mirë të huliganëve e përbëjnë tifozyt). Mendova:

“Ky ka ardhur ta lartësojë triumfin e mbrëmshëm”. Pranë masës së mbledhur kalon një gjysh me një shenjë në gjoks në të cilën qëndronin katër shkronja “S”. Disa momente më vonë u dëgjua një muzikë e zëshme e cila dilte nga brendia e një veture të kuqe që i afroheshte masës. Vetura “këndonte” këngë patriotike - çetnike. Shikimet e kalimtarëve drejtohen drejt veturës dhe djaloshit të buzëqeshur që ishte vozitës i veturës. “Të panë të gjithë – tani mund të shkosh në shtëpi” – u dëgjua një koment nga masa. Grumbullit të njerëzve që vështronin xhaminë iu afrua një grua me një djalë të vogël, i cili pyeste atë dhe drejtonte gishtin drejt xhamisë. Përgjigja e nënës së tij u dëgjua qartë: “Ajo është xhamia, bir. Mbrëmë xhamia u dogj, mbrëmë të gjithë u gëzuan”.

Edhe pse qëndroja dhjetëra metra larg xhamisë, pash qartë rezultatet e vandalizmit të mbrëmshëm. Por, dëmet e vërteta arrita ti shoh më vonë pas hyrjes në xhami dhe në ndërtesën e medreses. Në hyrjen e oborrit të xhamisë pash fytyrat e zbehura dhe të mërzitura të muftisë së Beogradit dhe dy djemve të tij Muhamedit dhe Mustafës. Nuk ndërruam asnjë fjalë, por u morëm vesh mirë.

Oborri i xhamisë ishte përplot mbeturina, ndërsa nga libraria edhe më tej dilte tym. Kush do të thoshte se këtu ndonjëherë ka pasur librari!? Hyra në xhami për të satën herë në jetë, por edhe më tej mu duk si të jetë hera e parë. Për shkak se xhamia është ndërtuar nga guri, në të nuk ka pasur çka të digjet përveç qilimave dhe ornamenteve. Në disa vende të xhamisë kishte grumbull mbeturina, prush dhe pjesë të librave të mbetur. Pasi që vandalët nuk kanë pasur “fat” në djegien e çilimit, ata kanë marrë Kur’anat dhe librat nga libraria dhe biblioteka dhe i kanë djegur. Ata atëherë “vërtetë” iu kanë

gëzuar zjarrit. Që edhe më tej të rrisin festimin, ata kanë urinuar nëpër Kur'anë dhe libra, për të cilën dëshmojnë mbeturinat e djegura që u vie era urinë. Në dyshemenë e xhamisë gjendeshin grumbuj mbeturina dhe prush dhe disa pjesë të mbetura të Kur'anit të cilat nuk ishin djegur. Në vetëm gjysëm metre largësi nga një grumbull mbeturinash, ma tërhoqi vëmendjen një libër që kishte mbetur i paprekur. Mora librin, fshiva pluhurin nga kapakët dhe e lexova titullin me zë: Dita e Gjykimit – ndërsa nëpër trup më kaloi një impuls i ftohtë dhe një mendim: A do të kishte bërë një akt të tillë një mendje e shëndoshë nëse e dinte edhe një pjesë të vogël të asaj që e pret në Ditën e Gjykimit?

Dola nga xhamia dhe u nisa drejt ndërtesës së medreses. Zyra e imamit, profesorit të medreses si dhe zyra e myftisë ishin të djegura tërësisht së bashku me arkivin, librat... Biblioteka e madhe dhe luksoze me disa mijëra tituj dukej si një skenë për inçizimin e filmave horror. Para bibliotekës gjendej një grumbull i mbeturinave të librave të djegura mes të cilave edhe ndonjë libër që kishte rezistuar zjarrit.

U nisa nëpër shkallët që çonin drejt dhomave të fjetjes së medreses. Nëpër shkallë ma tërhoqin vëmendjen gazetatat, të cilat për çudi kishin arritur aty të paprekura. Aty gjendej javorja nga Sanxhaku, "Glas Islama" (Zëri i Islamit). Në faqen e parë të saj me

shkronja të mëdha shkruante: "Inicijativa za objedinjavanje islamskih zajednica na području SR Jugoslavije." (Inicativë për bashkimin e bashkësive islame në hapësirat e RS të Jugosllavisë). ...

Dhomat e fjetjes në medrese më nuk ekzistojnë. Ekzistojnë vetëm mbeturinat dhe tavani. Nuk shkova më tej. Duke u përpjekur të mbaj forcën dhe vlerësimin e shëndoshë u ktheva dhe së bashku me disa djem, kërkua nëpër mbeturina disa libra gjysëm të dëmtuara, të cilat mund të përdoren edhe më tej. I bartëm librat në një dhomë të zbrazët, në të cilën nuk kishte pasur ndonjë gjë që të digjet.

... E largova nga koka mendimin që më erdhi për këtë që po na ndodh. Nuk desha të mendoj për atë tani, do të ishte shumë. Në momentin kur kisha ndërmend të dal prej xhamisë, mu afrua një njeri në uniformë dhe më tha se ka për detyrë ta ruajë xhaminë gjatë natës. Ai më pyeti: "A dëshiron që dikush prej jush të mbetet dhe ta ruajë xhaminë gjatë natës?"

"Jo, i thash, sonte ruajeni ju, sepse ne nuk kemi çka të ruajmë më në të".

Dola nga oborri, u ktheva ta shoh, dhe menjëherë tërhoqa shikimin. Tani, para mbrëmjes çdo gjë dukej me mërzë të pakrhasueshme, sikur të kisha dëgjuar vajin e xhamisë. Përnjëherë më kaploi një mllef i përzier me dhimbje...

Abdullah Haris
Marrë nga: Islambosna.com
Përktheu: Xh.A.
27.3.2004

Shejtanët e ndryshëm dhe metodat e tyre

Të nderuar vëllezër, vërejtjet e shumta kur'anore të cilat na tërheqin vërejtjen kundër shejtanëve janë përmendur në aq shumë ajete sa që e kemi vështirë tash në këtë vend që t'i tubojmë të gjitha, por fillimisht duhet që çdo musliman të dije se shejtani është armiku i tij më i përbetuar, siç thotë Allahu, subhanehu ve teala, në suren Isra, ajeti 53: "Me të vërtetë shejtani është armik i hapur i njeriut".

Prandaj vëlla musliman kij kujdes nga metodat e tij të fëlliqura sepse ai disa herë përdorë:

-metodën e frikësimit tek frikacakët, siç thotë i Lartmadhëruari në Kur'an: "ai është shejtani, i frikëson ndjekësit e tij, e mos iu frikësoni atyre por Mua më frikësoheni" (Ali Imran: 175);

-metodën e zbukurimit, siç thotë Allahu i Lartmadhëruar në Kur'an: "kur shejtani atyre ua beri veprat e tyre (të këqija-haramet) të bukura dhe iu tha: sot nuk ka kush prej njerëzve që ju mundën... "(Enfal: 48) dhe poashtu thotë Allahu, subhanehu ve teala, se: "(Iblisi) tha: Zoti im, për shkak që më përzune, unë do t'ua zbukuroj (të këqijat) në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t'i mashtroj (largoj nga rruga e vërtetë)". (Hixhr: 39);

-metodën e istihvadhit ndaj njerëzve. (Istihvadh d. t. th. kaplim, mbisundim, nënshtrim, vërshim në të gjitha anët, moslënie rahat asnjëherë) Siç thotë Allahu, subhanehu ve teala, në Kur'anin fisnik: "ata i ka nënshtruar

(istihvadh) shejtani dhe ua ka bërë që ta harrojnë të përmendurit Allahun..." (Muxhaddele: 19)

-metodën e mbjelljes së urrejtjes dhe armiqësisë në mesin e njerëzve, siç thotë Allahu xhel-le ve ala në Kur'an: "por shejtani dëshiron që të mbjellë në mes juve armiqësinë dhe urrejtjen..." (Maide: 91);

-metodën e vesveses, siç thotë Allahu xhel-le ve ala në Kur'an: "(shejtani) i cili ban vesvese në gjoksat e njerëzve" (Nas: 5);

Prandaj, ulemaja janë unanimitë se janë dy lloje shejtanësh edhe atë:

1-shejtani xhinn dhe

2-shejtani njeri,

edhe ate bazuar në ajetin e 5-të të sures "Nas" ku Allahu, xhelle shanuhu, thotë: (shejtani) prej xhinëve dhe njerëzve i cili ban vesvese në gjoksat e njerëzve", dhe në ajetin 112 të sures En'am, në të cilin Allahu na tërheq vëmendjen dhe na bën me dije se çdo peygamberi i ka dërguar armik-shejtan dhe në të njëjtën kohë na bën me dije për llojet e tyre, e kështu duke na treguar për llojet e tyre thotë: "dhe kështu çdo peygamberi i bëmë armiq nga shejtanët njerëz dhe xhinn që njëri tjetrit i sinjalizojnë me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë në mashtrime. . "

Ulemaja shkuan deri në mendimin sa që thanë se shejtani njeri (shejtanul insi) është më i rrezikshëm dhe më i dëmshëm se shejtani xhinn (shejtanul xhinni), prandaj muslimani duhet të ruhet më shumë nga ky shej-

tan dhe ta njohë mirë atë e t'ia njohë disa drredhi dhe metoda që i ka, e që Allahu do na mbrojë nga ata.

Ata (ulematë) kanë thënë se:

- çdonjëri që bashkëpunon me Iblisin, apo është prej ushtarëve të tij që mashtrojnë dhe largojnë nga e vërteta dhe bën të dashur munkerin (veprën e shëmtuar) dhe kurvërinë, është shejtan;

- çdonjëri që bën përpjekje apo nxit apo është pjesëmarrës në largimin dhe pengimin e njerëzve nga rruga e Allahut, është shejtan;

- çdonjëri që thirrën në rrugët e batilit (të pavërtetës) me çfarëdo lloji, metode, mënyre apo preteksti, është shejtan;

- çdonjëri që përpriqet në ndarjen e dy çifteve bashkëshortore që duan njëri tjetrin në hallall, është shejtan;

- çdonjëri që shkakton fitne në mesin e njerëzve, është shejtan;

- çdonjëri që shkakton fesat dhe e nxit atë, është shejtan; etj,

Shejtani i këtij lloji, pra njeri, është më i rrezikshëm se vet Iblisi sepse Iblisi: "gjithsesi se kam t'i mashtroj që të gjithë ata përveç robërve Tu (o Zot) që janë shumë të sinqerët" (Hixhr: 40) dhe ka thënë: "unë gjithsesi do t'i shfarros pasardhësit e tij, me përjashtim të një pakice" (Isra: 62).

Iblisi pra, nuk dëshiron mbisundim mbi të gjithë kurse ky lloj shejtani (shejtani njeri) kërkon të mbisundon të gjithë pa përjashtim me të gjitha format e fitneve, të mashtrimeve dhe të devijimit. Kurse Allahu, subhanehu ve teala, në Kur'an ka thënë: "kërko mbrojtje tek Allahu nga shejtani i mallkuar" (Nahl: 98) dhe nuk ka thënë "kërko mbrojtje tek Allahu nga Iblisi" për shkak të numrit të shumtë të gjinive dhe llojeve të shejtanëve të cilët largojnë nga rruga e Allahut, subhanehu ve teala.

Sa shumë armiq kanë pasur peygamberët nga shejtanët njerëz të cilët u paraqitën në çdo kohë dhe vend, të cilët i pengonin peygamberët që ta përcjellin mesazhin hyjnor deri tek njerëzit, saqë disa prej peygamberëve edhe i vranë!

Allahu, xhel-leshanuhu, ka lajmëruar për cilësitë e shejtanëve të këtyllë në Librin (Kur'anin) e Tij që kemi mundësi përmes tyre edhe t'i njohim.

Kështu pra, na ka lajmëruar se prej natyrës së tyre është mendjemadhësia dhe krenaria, kërkim të lartësimit në tokë dhe rrefuzim të çdo gjëje që nuk del nga ata po qoftë ajo edhe e vërtetë dhe e dobishme.

Ky shejtan e armiqëson dhe e kundërshton hakun nëse del nga tjetërkush e jo nga ai. Me të vërtetë ai urdhëron në të keqe me të gjitha llojet dhe format e tij dhe në çdo mënyrë ua bën njerëzve ta duan dhe dëshirojnë kurvërinë.

Të këtyllët i shohim sot, se si:

-fesadin e emërojnë reformë në të mirë;

-komplotet, fitnet e ndryshme dhe shkeljen e premtimeve i emërtojnë çlirim;

-të tradhtuarit Allahun dhe daljen nga Milleti (feja) e Ibrahimit, alejhis-selam, e emërojnë patriotizëm;

-kryerjen e kurvërisë e emërojnë qytetërim;

-devijimin dhe largimin nga e vërteta e emërojnë si civilizim dhe prosperitet;

-lënien pas dore dhe shkeljen e dispozitave të Librit të Allahut (Kur'anit) dhe mosveprimin sipas tij e emërojnë progres dhe bashkëecje me aktualitetin bashkëkohor.

Prandaj, besimtari duhet që të kërkojë sa më shumë mbrojtje (eudhu bil-lahi-n) nga Allahu, subhanehu ve teala, prej shejtanit të mallkuar i cili thotë: "...për shkak se më humbe mua, unë do t'u ulem atyre në rrugën Tënde të drejtë, mandej do t'u sillem

atyre para, prapa, nga e djathta dhe e majta e tyre dhe shumica e tyre nuk do të të falenderojnë " (A'raf: 16-17)

Sherri i këtyre shejtanëve është bërë i madh, ushtarët dhe miqtë e tyre janë shtuar shumë, fitnet e tyre kanë vërsuar shumë, saqë tregtojnë me trurët, me turbullimin e të menduarit, me ndryshimin e fakteve, llojlojshmërimin të batilit (të pavërtetës) dhe distribuimit të tij me ngjyra të llojlojshme.

Prandaj dijetarët kanë vendosur dhe kanë thënë se:

-ai që hesht përpara hakut (të vërtetës) është shejtan i heshtur;

-ai që flet me të pavërtetë (batil) dhe nxiton në të, është shejtan që flet;

-penguesi i njerëzve që urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, është shejtan;

-ai që rezillëkun e bën të dashur me çfarëdo lloji mënyre qoftë, është shejtan;

-ai që kurvërinë e bën të dashur në mësin e njerëzve në çfarëdo mënyre dhe e përhap atë, është shejtan;

-ai i cili punon në heqjen e turpit nga shoqëria, është shejtan;

-gazetari i cili shkruan shkrime që janë në kundërshtim me shariatën e Muhammedit a. s. dhe me Mil-letin e Ibrahimit a. s., është shejtan;

-shkrimtari i cili shpërndan material që e prish moralin, është shejtan;

-ai i cili i mashtron njerëzit përmes fjalëve apo punëve të tija që t'i emitojnë armiqtë e Allahut dhe armiqtë e pejgamberëve të Tij përmes veshjes, modës, festimit të festave të ndryshme, është shejtan sepse ai flet përmes gjuhës së situatës në të cilën gjendet apo gjuhës së cilësive që i ka dhe thotë për mosbesimtarët se: "ata janë në rrugë më të drejtë se ata që besuan (besimtarët)"! (Nisa: 51)

Të këtillët i gjejmë se si shpenzojnë pasuri të majme në pengim nga rruga e Allahut, subhanehu ve teala, siç thotë Allahu, subhanehu ve teala, në Kur'anin fisnik: "shpenzojnë pasurinë e tyre për të penguar nga rruga e Allahut. Ata do të shpenzojnë atë dhe ajo do të bëhet dëshprim i tyre, madje ata do të mposhten. E ata që mohuan, do të përmblihen vetëm në xhehennem"! (Efal: 36)

Andaj pra duhet patur kujdes nga shejtanët e këtillë sepse Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "e nëse u bindesh (i rrespekton) shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut..." (En'am: 116)

I lutemi Allahut, subhanehu ve teala, që të na mbrojë nga shejtanët e këtillë e në veçanti t'i mbrojë të rijntë dhe të mos lajthitin nga e vërteta, Amin!

(Pjesë nga hutbeja e mbajtur me 12. 03. 2004 në xhematin shqiptar » el Buhari »-Wien)

Emin Limani,

imam në xhaminë "el Buhari"-Wien

16.4.2004

Jeto një jetë të mirë!

Të gjithë ne dëshirojmë jetë të mirë pa halle, shqetësime e probleme. Po si është ajo jetë? Një ditë Ibrahim Ed`hemi ishte me disa vëllezër të tij musliman dhe ishin duke ngrënë ushqim ndërsa iu drejtua duke iu thënë: “O vëllezërit e mi sikur ta dinin sundimtarët e fëmijët e tyre se çfarë jete të mirë po jetojmë dhe çfarë kënaqësie po ndiejmë në adhurimin tonë ndaj Krijuesit Bujar, do të donin të na e merrnin atë qoftë edhe me armët e tyre”.

Shumica e njerëzve sot mendojnë se jeta e mirë është në të qenurit milioner apo në të pasurit shumë gra apo në të shëtimit nëpër botë apo duke ndërtuar pallate apo duke patur shumë fëmijë apo duke bërë mëkate me alkool, imoralitet e gjëra të tjera që ia ka qejfi epshit. Oh sa i mjerë është ai që kështu mendon... Allahu i Lartmadhërishtëm paralajmëron: “Kush ia kthen shpinën dhikrit (Kuranit) Tim do t’i japim atij jetë të ngushtë (plot halle, vështirësi, të parehatshme) dhe do ta ngjallim Ditën e Kijametit qorr (të verbër)”. (TaHa:124).

A nuk e sheh se Allahu i Lartmadhërishtëm tha se edhe mëkatarit do t’i japë jetë, por çfarë jete? Do t’i japë jetë plot shqetësime. Atëherë pra çfarë është jeta e mirë? A me të vërtetë mendon se e din? Si jetohej pra ajo jeta e mirë me pasuri apo me dashuri? Jeta e mirë jetohej kur të adhurosh sinqerisht Zotin tënd. Po, po, kur ti falësh dy rekate namaz për TË.

Një djalosh besimtar i mirë ishte shumë i varfër dhe shpesh nuk kishte ushqim tjetër përveç se bukë me vaj. Por ai shpesh recitonte duke thënë: Në dunja kam veç bukë me vaj, shpresoj tek Allahu shpëtim pastaj.

Kur të lexosh këtë shembull, mendo hallin e shumë njerëzve sot...

Allahu i Lartmadhërishtëm thotë:

„e nëse do ti numëronit dhuntitë e Allahut ndaj jush nuk do t’ia arrinit dot. Me të vërtetë njeriu është përbuzës e mohues i të mirave“. (Ibrahim:34)

Po, me të vërtetë njeriu është përbuzës. Sot dikush ka shtëpi në të cilën fle, ka makinë me të cilën lëviz, ka pasuri nga e cila ushqehet, ka grua e fëmijë e pastaj thotë: bëjmë durim në caktimin e Allahut. Po a nuk e sheh ai se Allahu i Lartmadhërishtëm ia ka dhuruar të gjitha dhe e ka kursyer nga sprova? A mos është ky njëlluj mohimi i mirësive të dhëna prej Tij? O njeri! Ti a nuk je duke e parë se sa i pasur je? A don të jetosh jetë të mirë? Mos u mërzi o robi i Allahut! Provoje njëherë të shkosh në një nga shtëpitë e Allahut të Lartmadhërishtëm, në errësirën e mëngjesit apo të mbrëmjes; hape Kur’anin, harroje dunjanë për ato pak minuta me gjithë që ka ajo. Lexo, lexo me kujdes, me gjuhë edhe me zemër, përmende Allahun e Lartmadhërishtëm -Bujar e Fisnik.

Pastaj pyete veten a gjete kënaqësi në këtë vepër të dashur për Krijuesin Fuqiptotë?

Shpresoj që po. E nëse jo, dije pra se ti je shkaku i humbjes apo i mosgjetjes së kësaj kënaqësie! Ti me mëkatet e tua po ndalon veten nga kënaqësia në punë të mira! Pastaj pyet dikush: zemra nuk po më qetësohet, kam shumë halle, pse kështu?

Dikush e pyeti në telefon një mik të tijin që bënte mëkate haptazi e i tha:

Pashë Allahun, sot ke bërë gibet, ke ... ke ... më thuj a gjete rehatinë e shpirtit? Të

më përgjigjesh drejtë, e mos më gënje! Ai iu përgjigj: jo!

Dikush shkoi tek një dijetar dhe e pyeti: Nuk di çfarë kam, jam nervoz, i shqetësuar, shtëpia nuk më pelqen, as kur jam me femijet nuk mund të gjej kënaqësi!

Dijetari i tha: A mos je i varfër?

Ai u përgjigj: kam pasuri që s'ia di fillin e fundin! Subhanallah!

Allahu thotë: "mos të të çuditë ty pasuria dhe femijet e tyre! Allahu don vetëm t'i dënojë me to në dunja" (Teube:55)

Çfarë dallimi ka kjo gjë nga ajo që na tregon Pejgamberi, alejhis-selam: "Të them 'Subhanallah, Elhamdulillah, La ile he il Allah, Allahu ekber' është më e dashur për mua se çdo gjë mbi të cilën lind dielli",

Dhe ajeti:

"Ata burra dhe ato gra që shumë e përmendin Allahun, Ai u ka premtuar atyre falje gjynahesh dhe shpërblim të madh" (Ahzab: 35)

Don jetë të mirë? Le të jetë pra gjuha jote e lagët nga të përmendurit Allahun.

Pejgamberi, alejhis-selam, flente në një shtrat prej kashte, vendoste dy gurë nga uria në barkun e tij dhe qante.

Tregon Bilali, radijallahu anhu, se hyri tek Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi te, ta thërrasë për sabahun dhe e gjeti duke qarë. A mendon ti se ai nuk ishte i lumtur apo se ka dalë nga kjo dunja pa ndërjet kënaqësi në të? Jo asses! Ka qenë i kënaqur dhe Allahu ia zgjeroi gjoksin dhe ia mblodhi dunjanë para duarve të tij. Ate, alejhis-selamin, e mohuan mushrikët! I bënë bllokadë, e lanë pa ushqim, e gjuajtën me gurë, e nxorrën nga Meka, ia thyen dhëmbin, ia shpuan faqen dhe iu mbushën sandalet me gjak, shpifën kundra familjes së tij dhe ai ishte i rehatuar dhe i tha Omerit, radijallahu anhu, "A nuk je i kënaqur ata mosbesimtarë ta kenë dunjanë e ne ahiretin?"

Allahu thotë "Ahireti tek Zoti yt është për të devotshmit" (Zuhruf:35)

Sot ka prej muslimanëve injorantë që kërkojnë fetva që të konsiderohet i shpëtuar ai që kryen vetvrasje! Jo, asnjëherë! Në zjarr do të jenë!

Po a e dini pse duan ta bëjnë këtë? A e vret veten ai që jeton një jetë të mirë? Jo sepse nuk ka arsye! E ata duan ta vrasin veten që të shpëtojnë nga dënimi e vuajtja që po përjetojnë në këtë jetë!

Dënim e vuajtje të shpirtit! Jo, mos ashtu! Përmende Zotin tënd, falju Atij, kërko falje. Kush lyp falje prej Allahut, Ai ia lehtëson hallet!

Allahu thotë: "Allahu nuk i dënon ata sa të jesh ti (o Muhammed) mes tyre" (Enfal:33)

Pejgamberi, alejhis-selam, vdiq! Pastaj çfarë do të ndodhte?

Në vazhdim të këtij ajeti Allahu thotë: "Allahu nuk i dënon ata (njerëzit) derisa ata janë duke kërkuar falje mëkatesh" (Enfal: 33)

A nuk e din pse vjen jeta e vështirë, fesadi e shkatërrimi në tokë? Nga gjynahet e kundërshtimi e shkelja e kufinjve të Allahut. E belaja kur vjen nuk largohet përveç se me pendim dhe istigfar. Mos të të mashtrojë dunjaja! Shumë njerëz duan fitore e krenari në dunja e në kohën e sabahut flejnë! Kur'an lexojnë vetëm në namaz (edhe ate po u falën!)?!

Si do vijë jeta e mirë me këtë gjendje? Dobësia është tek ne, mos shih kënd tjetër pos vetes! Të pyes me çfarë ushqehesh? Me çfarë e hap iftarin tënd kur agjëron? Me çfarë të duash dhe me çka të ka qejfi!

Han çfarë të duash dhe të pëlqen shpirti dhe përsëri nuk je i kënaqur e i rehatuar!?

Dëgjo pra: e pyetën një fshatar se me çfarë ushqehet?

-Nuk kam tjetër veç grurit, u përgjigj ai.

-Po a ka lezet të hash vetëm grurë?-i thanë.

-Të ha grurë e të shpresoj shpëtimin pastaj tek Allahu, kjo është ushqimi më i mirë!-tha ai.

Sa çudi!

Ti mendon se si do të jetosh pasnesër, pas një viti, pas 20-vitesh, si do të jetë gjendja e fëmijve tuaj?! A harron se do ta lesh këtë dunja së bashku me çfarë ka në të dhe po kështu do ta lënë edhe ata që vijnë pas teje?

Ky mendim i tepërt për dunjanë i çoi njerëzit në mëkat! Po ata besimtarët e mirë që bëjnë jetë të mirë, ata janë që i njohin mirësitë e Allahut. Veç ata që janë të mjerë i përbuzin mirësitë e Allahut!

A e din ti se sa i pasur je? A do ta jepje rininë tënde për të pasë pasuri por duke qenë plak i moshuar? Sigurisht që jo! A do ta jepje gjuhën tënde e kurrë më të mos flasësh nëse të premtohet pasuri e madhe? Sigurisht që jo! A e sheh pra se sa i pasur je dhe se sa Allahu të ka nderuar? A e sheh se sa dhunti Ai i Lartmadhërishtëm të ka dhuruar?

E pyetën një besimtar që kishte rreth 50-vjet e që falte namaz duke qarë shpesh në të: A gjete kënaqësi dhe çfarë do të dëshiroje tjetër? U përgjigj e tha: do të doja të jetoj edhe 50 vjet të tjera e të falja namaz sikur deri tani!

Të vërtetën e ka thënë Pejgamberi, alejhis-selam: "Më është bërë kënaqësia ime në namaz".

Me të vërtetë më të lumturit që jetojnë mbi tokë janë besimtarët në Allahun: "Kush bën punë të mirë duke qënë besimtar qoftë burrë apo grua do t'i japim atij jetë të mirë" (Nahl: 97)

A do jetë të mirë? Veni pra kufi vetes dhe fal 5-namazet, mundësisht me xhema.

Kur Seid ibën Musejeb ishte në shtratin e vdekjes e pa të birin duke qarë dhe e pyeti: pse qan o biri im? Ai iu përgjigj se më vjen keq për ty!

Seidi i tha: mos qaj për mua, por qaj për veten tënde! Unë 40-vjet kam falë namazin në xhaminë e Pejgamberit, alejhis-selam, duke qenë në xhami para se të thirrej ezani. Allahu i Lartmadhërishtëm thotë:

"Ata që besuan u qetësohen zemrat me përmendjen e Allahut" (Ra'd:28)

A do jetë të mirë? Kur të shkosh të falësh sabahun në xhami, pas namazit rri pak aty përmende Krijuesin tënd dhe madhëroje Atë, falenderoje Atë!

Tregohet se Abdullah ibën Mubarek me shokët e tij prisnin namazin e jacisë që prej kohës së akshamit duke përmend Allahun në vete apo duke lexuar Kuran.

Shumë njerëz sot, sa hyjnë në xhami, i nisnin muhabetet e dunjasë, pas sabahut e harronin dhikrin e flasin për dunja. Leje pra njëherë dunjanë, të paktën duke qenë brenda në xhami, o robi i Allahut!

Një herë kur doli Pejgamberi, alejhis-selam, për namaz të jacisë i gjeti sahabet ashtu si i kishte lënë pas akshamit dhe i pyeti:

-çfarë keni bërë këtu qysh prej kohës së akshamit?

Ata iu përgjigjën:

-e falëm njërin namaz dhe e pritëm tjetrin.

A e dini si e pritën? Duke lexuar Kuran e duke bërë ibadet dhe istigfar. Pastaj ata bënë ashtu edhe herë të tjera derisa njëherë Pejgamberi u tha: Dëshmoj për ju se Allahu i Lartmadhërishtëm krenohet para melaikeve me ju duke u thënë: A i shikoni robët e mi?"

Aliun, radijallahu anhu, e dëgjuan njëherë në xhami duke thënë pas namazit të sabahut, kur iu kujtua dunjaja: "Oj dunja ik prej meje e kërko dikë tjetër" dhe pastaj qau.

Dy fjalë janë të lehta për gjuhën, të rënda në peshojën e Ditës së Gjykimit e të dashura për Allahun; "SubhanAllahi ve bihamdih SubhanAllahi-l-adhim".

Sa herë i ke thënë ato sot? A ke thënë "La ilahe il-lallah" sot? A do jetë të mirë? Pendohu, leri gjynahet, përkujtohu! Mjaft më, se gjynahet po ta ngushtojnë jetën!

Allahu i Lartmadhërishtëm i thirri në pendim të krishterët dhe ata që i keqtrajtuat

besimtarët, e ti çfarë po pret? A do jetë të mirë? Thuaj: "pendohem tek Allahu"!

Të parët e mirë thonin: nuk ka hajr prej syve të mi nëse nuk lotojnë për Allahun.

Mos u habit e të mendosh se e gjetën lumturinë ata që ia kanë kthyer shpinën Allahut e qeshin me fytyrat e tyre. Jo, në asnjë mënyrë! Ata me zemrat e tyre janë më fatkeqët.

Në natën e 27 të Ramadanit për të cilën mendohet se është Nata e Kadrit i sheh xhamiat plot; njerëzit luten, falen, lexojnë Kuran. E ndoshta ka mes tyre ndonjë që një sexhde nuk e bën për Allahun gjatë gjithë vitit. E presin Natën e Kadrit të pendohen e nuk e dinë se ndoshta Allahu ia merr shpirtin para se të vijë ajo natë e pastaj në Kijamet e shohin veten para xhehenemit!

Mendo mirë si do të jetosh!

Muhamed ibën Vasia ishte një besimtar të cilit para se të vdesë i tha dikush: lajm i mirë për ty, njerëzit po flasin mirë për ty, po bëjnë dua për ty.

Ai e shikoi atë që ia dha këtë lajm, nga sytë i dolën lotët e tha: Çfarë mund të më ndihmojnë mua ato, nëse më lidhen duart e këmbët e hidhem në dënim?

Jeto i qetë, qofsh i pasur apo i varfër; jeto i kënaqur me atë që të dha Allahu i Lartmadhërishëm!

Allahu thotë: Nuk u bie fatkeqësi përveç se me lejen (caktimin) e Allahut, e kush i beson Allahut, ai ia udhëzon zemrën" (Tegabun:11)

Me të vërtetë kush i beson Allahut ia udhëzon zemrën e ia zgjeron gjoksin.

A i ke parë ata njerëz që nuk kanë rehati por veç i sheh duke diskutuar: filani ka shumë pasuri, filani më ka bërë këtë të keqe, filani më ka hak se më ka fyer...?

A do jetë të qetë? Faljau krijesave të do-

bëta e mbështetju Krijuesit të Plotfuqishëm .

I thanë një të mençuri: po të përgojnë. ai iu përgjigj: ja kam falë atij. E Allahu i Lartmadhërishëm thotë:

"E ata që ia falin njerëzve, Allahu i don punëmirët"(Ali Imran:134)

Mos u çudit që të përgojnë se njeriu është i prirur të mohojë.

Ali ibën Husejnin, pra nipin e Aliut, radijallahu anhu, e shau dikush. Ai e thirri atë person e i tha:

-Ajo çfarë the ti për mua është shumë pak, a mos ke nevojë për diçka? Pastaj i fali atij rroba e të holla. Njeriu kur e pa këtë sjellje tha: për Allahun betohem se ti je prej pasardhësve të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem!

A do të jetosh pra jetë të qetë?

Allahu thotë:"ktheje të keqen me të mirë se ndoshta ai me të cilin ke armiçësi do të bëhet mik i afërt. E këtë nuk e arrin veçse durimtarët" (Fussilet:34)

Njerëzit janë duke e shkatërruar veten për dunjanë e nuk marrin prej saj vetëm se pak.

Edhe ti puno, ushqehu, gëzohu, qesh siç qeshte Pejgamberi, alejhis-selam, me nipat.

Allahu thotë: "Kush i ndalon bukuritë që Allahu i krijoi për robërit e Tij dhe të mirat prej rizkut" (A'raf:32)

Por kur të vinte nata, Pejgamberi, alejhis-selam, dhe shokët e tij bënin ibadet, kur vinte çështja e ashpër tregoheshin burra të sigurtë.

Si përfundim nëse do jetë të qetë e të mirë shtojë dhikrin, leximin e Kuranit, adhurimin, istgfarin, largo nga shpirti lakminë e hasretin, inatin e zilinë për besimtarët, bëhu i qetë e puno punë të mira se Allahu thotë: "Kush bën prej jush vepër të mirë qoftë burrë apo grua do ti japim atij jetë të mirë." (Nahl: 97)

Nebil el AUDANI

Përktheu dhe përshtati: Rinia Islame „El Buhari“ - Vjenë
26.3.2004

Shpalosi zullumi fytyrën e vërtetë...

Ju porosis që të keni frikë All-llahun, Atij ti ktheheni në mirëqenje dhe vështirësi, në ngushticë dhe gjërësi, nuk ka humbur ai që prej Tij frikohet, nuk dëshpërohet ai që Ate e shpreson, nuk nënçmohet ai që për All-llahun kapet:

“...e kush ja ka frikën All-llahut, atij Ai i hap rrugë, dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare. ...”. (Et-Talak: 2-3).

O ju musliman!

All-llahu, subhanehu ve teala, në Kur'an thotë:

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit”. (En-Nur: 55).

All-llahu premtimet i ka të vërteta, sepse Ai është më drejtfolësi dhe ia ka relizuar të gjitha premtimet Pejgamberit të Tij. Për këtë shkak këtë fe e kanë bartur burra dhe udhëheqës, të cilët i ka mësuar Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sel-lem, që mos të frikohen nga askush përveç se nga Zoti, mos t'i nënshtrohen askujt përveç Zotit, të cilit i nënshtrohen të gjitha krijesat, në Dorë të të cilit janë shkaqet e frikës dhe sigurisë:

“Po atë (propagandë) e bëri vetëm shejtani që dëshironte me miqtë e vet (idhujtarët), t'ju friksojë, po ju mos u frikësoni prej tyre, frikësomuni Mua, nëse jeni besimtar”. (Ali Imran: 175).

Sot, bota islame kalon një gjendje të vësh-

tirë dhe fatkeqësi të njëpasnjëshme. Mbarë ummetit islam i shihet dhimbja, mëdyshja dhe shqetësimi në sytë e tij. I shtohet kjo dhimbje dhe shqetësim kur të shikon herë pas here gjendjen e vet. Ky ummet sulmohet me valë vullkanore, para të cilave ummeti nuk gjenë strehim, rrugëdalje ose fshehje, ku do të mbrohen nga zullumi i zullumqarit dhe terrorizmi ndërkombtar i legalizuar me ligje të ndryshme. Ajo goditet herë pas here, saqë edhe rrëzohet prej tyre, tërë kjo ka qenë shkak që ta kaplon këtë ummet një iluzion, iluzion i cili ka arritur deri në atë gradë saqë i dobëti te ai duket si i fuqishëm, i afërti i largët, sigurinë frikë, shpëtimin shkatërrim, andaj nga shkak i këtij iluzioni sillet sikur të jetë me epilepsi, nuk sheh se çka e ka goditur dhe çka nuk e ka goditur.

O ju musliman!

Jetojmë në një kohë kur muslimanët janë sprovuar me përçarje dhe përleshje të epshëve të tyre, janë mbuluar me injornacë, ballafaqohen me pengesë për ta njohur gjendjen e armiqve të tyre, industrinë dhe pasurinë e tyre. Kjo është bërë shkak që ata t'i nënshtrohen okupatorit të egër, i cili vjen me armë të mëdha dhe të çuditshme, të cilat kanë shkaktuar këtë iluzion, iluzionin se gjindemi para një force që nuk mund të mundet, madje se duhet ditur se ajo fuqi sundon toka të mëdha dhe gjërë e gjatë botën. Mirëpo tërë këtë njeriu, i cili është i lirë nga ky iluzion, e sheh si të dobët, dhe se nuk ka mundësi të sulmon e as të mbrohet, sepse çdo lëvizje sado që të është e dobët i shkakton

dridhjen e kësaj force, nëse nuk shkakton rrënimin e tërësisëm të tyre, kur depërtohet drejt pronës së tyre. Kjo forcë është e frikësuar nga çdo lëvizje në botë. Çdo ndodhi që ndodh në botën islame dhe arabe, shkakton dridhje të madhe në forcat e zullumit dhe mendjemadhësisë, të përhapura anë e mbanë botës së dobët dhe në tokat islame.

Edhe përskej kësaj që thamë, ne e shohim se kjo çështje nuk është më e paqartë për mbarë muslimanët, ata nuk janë të mbuluar me mbulesën e iluzionit. Nëse shikojmë edhe më shumë do të vërejmë se edhe vet forcat e kufrit kanë kuptuar se janë të dobët, mirëpo në të njëjtën kohë ata japin kontributin e tyre me sa kanë fuqi për të mbuluar dobësinë e tyre, kurse mbulesa më e mirë është iluzioni. Andaj ata në çdo rast bëjnë zhurmë dhe bërtasin që të zgjojnë iluzionet, e të pengojnë shpалosjen e të vërtetës, përndryshe një shikim i vogël dhe perceptues na garanton zbulimin e këtyre gjërave.

Robër të All-llahut!

Njerëzimi në përgjithësi participonë në mundësinë për t'u ardhur sprovat, pa dallim të përkatësisë fetare ose nacionale, mirëpo kur sprovohen muslimanët, ata rrotullohen mes krahëve të mirësisë dhe qetësisë, nëse ata e kanë parasysh urdhërin e All-llahut dhe krijimin e Tij. Andaj tërë çështjet e tyre janë mirë për ta, nëse i godet e mira, ata falënderojnë, e kjo është mirë për ta, e nëse i godet e keqeja, ata durojnë, edhe kjo është mirë për ta. Kjo nuk i takon askujt përveç ummetit islam. Andaj All-llahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

"A do t'i bëjmë kriminelët të barabartë me muslimanët? Ç'është me ju, si gjykoni ashtu?". (El-Kalem: 35- 36).

"A mos do t'i barazojmë ata që besuan dhe bënë vepra të mira me ata që bënë shkatërrime në tokë, apo do t'i konsiderojmë njësoj si të ruajturit prej të këqijave, si ata që janë mëkatarë?". (Sad: 28).

Dhimbjet vrasëse që i godasin muslimanët në këtë kohë dhe ngacmimet nga të cilat nuk kanë shpëtuar në këtë shekull, tregon se ummeti ka nevojë që të ndalet para këtyre ndodhive me kërkesë për përmirësim, duke patur parasysh disa çështje, më të rëndësishmet janë këto:

Një: të jemi të kënaqur me All-llahun dhe Caktimin e Tij, sepse ajo që e ka goditur ummetin nuk ka patur ta huqë dhe se ajo që e ka huqur nuk ka patur ta godas. Se guximi, trimëria dhe fitorja nuk vijnë larg sprovës, ngushticës dhe brengave dhe se me vështirësitë vjen lehtësimi:

"Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi". (El-Inshirah: 6).

Një vështirësi nuk mund të mund dy lehtësime.

Dy: ky ummet duhet të përpiqet në bashkimin e radhëve, unitetin e qëndrimeve dhe burimit të dijes, nëse e dëshiron shpëtimin. Burimi i tyre duhet të jetë Kur'ani dhe Sunneti dhe përpjekja për ti eliminuar të gjitha simbolet e fanatizmit dhe epsheve injorante. Ummeti duhet të konfirmon gabimet e veta dhe mangësitë ndaj Zotit dhe skajësimin e sherijatit të përhershëm nga realiteti jetësor.

Tre: vetëm parapëlqimi nuk ban dobi, e as reagimi dhe kundërshtimi?! Ne me këtë fjalim nuk kërkojmë ndonjë grua me qira që të na vajtojë, ose ti bjer vetvetes, e as person që çështjet tona i grumbullon në ato vende që se shohin aspak dritën, ose mjaftohet vetëm me qarje, sepse qarja nuk e ngjall të vdekurin, as keqardhja nuk e kthen gurbetqarin, mirëpo puna është çelësi i suksesit, vërtetësia dhe sinqeriteti, së bashku me pasimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, konsiderohet shkalla e shpëtimit:

"Dhe thuaj: "Veproni, All-llahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët, ...". (Et-Teube: 105).

Katër: ummeti islam duhet të shpreson

shpërblimin te All-llahu për këto fatkeqësi që e kanë goditur, duke e ditur se ka shpërblim dhe dobi nëse duron dhe përpiqet, sepse çdo gjë që e godet njeriun, qoftë lodhje, sëmundje, madje edhe thera që e shpon, All-llahu për te i shkruan shpërblim, siç ka thënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Këtë hadith e transmeton Muslimi.

Duke i patur parasysh këto gjëra demonstrohet trimëria dhe guximi, nënshtrimi ndaj caktimeve të sodit dhe të nesërme, pasiqë e di se krenaria dhe fuqia, të gjitha këto i takojnë vetëm All-llahut:

"E atyre (shokëve të Pejgamberit) që dikush u tha: "Populli (idhujtarët) është tubuar t'ju sulmojë, pra kini frikë!" Ajo, vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: "Neve na mjafton që kemi All-llahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!" Dhe atë pa i gjetur kurrfarë e keqe fituan begati e mirësi të mëdha nga All-llahu dhe e arritën kënaqësinë e Tij, All-llahu është dhurues i madh". (Ali Imran: 173- 174).

Këtë e thonë ata që e mbrojnë vatanin e tyre dhe që e rruajnë fenë e tyre, kur takohen me forcat e të keqes dhe errësirës duke u thënë:

"Thuaj: "Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga All-llahu; Ai është ndihmëtar yni". Prandaj, vetëm All-llahut le t'i mbështeten besimtarët". (Et-Teube: 51).

Duke u thënë gjithashtu:

"Thuaj: "Ç'pritni për ne tjetër, pos njëres nga dy të mirat (o fitues, o dëshmorë)? ". (Et-Teube: 52).

Me këtë kanë qëllim fitimin e betejës duke ngadhnjyer ndaj armiqve, forcave të errësirës dhe tiranisë ose vdekjen, për fitore dhe ngadhnjim edhe kjo poashtu është e mirë, sepse ajo që është te All-llahu është më e mirë dhe më e përhershme, për dallim nga armiqët e fesë dhe forcave të errësirës, ata edhe nëse fitojnë edhe nëse humbin janë mes dy dënimeve: të tashme ose të ardhshme:

". . .Ndërsa na presim për ju që nga ana e

All-llahut, ose përmes duarve tona, t'ju godasë me dënim. Pra, ju pritni, e bashkë me ju presim edhe ne". (Et-Teube: 52).

Përndryshe ligji i All-llahut për ndryshimin e gjendjeve vazhdon pa ndalë, kurse lufta rrjedh:

"Në qoftë se juve u preku çka u dhemb (në Uhud), edhe atë popull (armikun) e pat prekur dhembje si kjo e juaja (në Bedër). Ne, këto ditë i ndërrojmë (u japim në përdorim) mes njerëzve për t'u ditur tek All-llahu ata që besuan dhe për t'i zgjedhur disa prej jush për dëshmorë (ose dëshmues). All-llahu nuk i do zullumqarët. Dhe që All-llahu t'i pastrojë besimtarët, ndërsa gradualisht t'i shkatërrojë mosbesimtarët". (Ali Imran: 140 - 141).

Pra, të të mer Zoti dëshmor qenka dhunti dhe vlerë nga Zoti, pasiqë shehidllëku nuk është e keqe e as humbje, por është zgjedhje, selektim, nderim dhe përveçim. Këtu del në shesh fjala e Farukut (Omer ibën Hat-tabit), radijall-llahu anhu, që ia ka thënë Ebu Sufjanit gjatë betejës së Uhudit, i cili në atë kohë akoma s'ishte bërë musliman: kjo ditë për ditën e Bedrit, kurse lufta akoma rrjedh. Omeri, radijall-llahu anhu, i tha: nuk jemi të barabartë. Të vrrarët tanë janë në xhennet, kurse të vrrarët tuaj në zjarr. (Ahmedi, sahih).

Pesë: Ummeti duhet ta kuptojë mirë se logjika e kriminelëve është e njëjtë dhe se politika faraonike shfaqet herë pas here, se ithtarët e kufrit dhe zullumit, sado që paraqiten si reformator dhe thirës në liri, ata në realitet janë shkatërrues dhe rrënues, thirrës në interesat e tyre personale dhe kënaqësit e tyre individuale. Si mos të jetë kështu, kur All-llahu, i ka përshkruar:

"E ata që mohuan (Kur'anin dhe Muhammedin), për ta është njësoj ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. All-llahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamurit e tyre ka një perde, e ata kanë një dënim të madh. Ka disa njerëz që thonë: "Ne i kemi besuar All-llahut dhe je-

tës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë. Në zemrat e tyre kanë sëmurje, e All-llahu u shton sëmundje edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtrojnë, pësojnë dënim të dhembshëm. E kur atyre u thuhet: "Mos e prishni rendin në tokë!" Ata thonë: "Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)!" Veni re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë". (El-Bekare: 6- 12).

Realiteti, vëllezër të nderuar është argumenti më i madh për këtë që themi, andaj mund të parashtrijmë pyetjen: çfarë lirie dëshirojnë ti sjellin irakut të lënduar dhe Palestinës së dhunuar?! Çfarë lumturie do ti kaplon ata njerëz nga gypat e topave dhe britma e automatikëve?! Për çfarë jete të këndshme kanë ardhur të na përgëzojnë, kur këtë ata janë duke e bërë mbi kufoma, vrasje, shkatërrime dhe rrënime të shtëpive të adhurimit dhe faltoreve?! Ajo që mund ta dimë shumë mirë është se natyrat e logjikshme akoma nuk i kanë ndryshuar kriteret saqë të mendojnë se rrënimi dhe vrasja është jetë, kurse kaosi është rregull, e zullumi drejtësi.

Të gjithë njerëzit e mençur janë të pajtuar se kjo është vetëm logjikë faraonike, të cilën e njohin muslimanët e lindjes dhe të perëndimit, shekuj me rradhë, nga leximi i Kur'anit: "...Faraoni tha: "Unë nuk kam mendim tjetër t'ju japë pos atij që ju thashë dhe nuk jam duke ju udhëzuar tjetër pos në rrugën e drejtë!". (El-Gafir: 29).

A mund të jetë e logjikshme që vrasja e katër personave është krim që nuk falet, kurse vrasja e një populli në tërësi, është çështje e vogël?! A është e logjikshme që të ballafaqohemi me dëshirën e popujve dhe shoqërive ndërkombëtare në kundërshtimet e vrasjes së civilëve, okupimin, përdhunimin, vrasjen e fëmijëve, pleqve dhe luftëtarëve, a

është e logjikshme që kjo të përballet me të drejtën e vetos, duke e kthyer mbrapsht dëshirën e mbarë botës?! Ku janë të drejtat e supozuara të njeriut?! Ku është liria në të cilën thërrasin ata?! Vallë, pretendimet e të drejtave të njeriut, mëshira, drejtësia, vlen vetëm për të ndihmuar dhe mbrojtur organizatat ndërkombëtare, dashamirët e qenve dhe kafshëve shtëpiake?! Vallë, qentë e prangosur janë më të rëndësishëm dhe më të mëdhenjë se foshnjat, madje edhe se tërë bota islame?! Pasha All-llahun, kështu vdesin të drejtat dhe arrihet në fund.

Në këtë mënyrë janë përmbytur kriteret logjike, saqë i marrë është ai që mundohet ta mer të drejtën e vet në emër të drejtësisë, ose mëshirës ndërkombëtare, i pafat është njeriu i dobët, i përlulur në gjuhë para këtyre forcave zullumqare dhe të padrejta, duke e kërkuar të drejtën e vet, duke kërkuar insaf, duke i kërkuar me lot e jo me gjak, kështu që na u bë e qartë se nuk ka drejtësi ndërkombëtare, atje ku ka tirani ndërkombëtare, nuk ka paqë, atje ku ka luftë, kurse fuqitë e mëdha nuk e kujtojnë drejtësinë dhe të drejtat e njeriut përpos kur kanë të bëjnë me të fuqishëm si ata, kurse në tërë këtë proces njeriun poseduesin e vërtetë të vendit të vet e konsiderojnë terrorist, kurse hajnin i cili e ka okupuar tokën e tyre, të drejtat dhe shenjtëritë e konsiderojnë pronar të ndershëm të shtëpisë, posedues i tokës, jo me gjallërim sipas legjislaturës fetare, por gjenocide dhe strese globale. Ata po të kishin një xixë të mëshirës, po të ishin të paanshëm, nuk do ta sjellnin punën që i mposhturi dhe i shtypuri me gjuhën e gjendjes së tij të thotë:

Kur u sëmurëm erdhëm t'u vizitojmë.

E kur gabuat, erdhëm falje t'u kërkojmë.

Me këto gjëra humbën shpresat për tu kthyer të drejtat e tyre të dhunuara, për shkak të të keqës që i ka goditur nga teprimi i forcave të zullumit dhe tiranisë. Mirëpo depërtoj te ve-

shët e tyre një shushuritje, e cila i trishtoi:

"Të mos mashtrojë bredhja nëpër qytete e atyre që nuk besuan. Ajo është një kënaqësi e pakët, e pastaj vendi i tyre është xhennemi që është vend mjerimi". (Ali Imran: 196- 197).

All-llahu më bekoftë mua dhe ju me Kur'anin e madh, na bëftë dobi me argumentet dhe përkujtimet që gjenden në te, e thash këtë që dëgjuat, nëse është e saktë, kjo është prej All-llahut, e nëse është gabim është prej meje dhe shejtanit, andaj kërkoj falje nga All-llahu, sepse Ai është Falës.

II

Vetëm All-llahun e falënderojmë, paqa dhe bekimi qofshin mbi ate që pas tij nuk ka pejgamber tjetër...

Keni frikë All-llahun, musliman të nderuar dhe dijeni se All-llahu ka shkruar krenarinë, epërsinë dhe lartësinë për robërit e Tij besimtarë, muslimanët janë më të lartit, me fenë, besimin dhe principet e tyre edhe nëse dëshojnë ushtarakisht, edhe nëse okupohen nga okupatori. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë". (Ali Imran: 139).

Kur Ebu Sufjani tha ditën e Uhudit: i lartësuar qoftë Hubeli. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: a ka kush i përgjigjet?! I thanë: o i Dërguar i All-llahut, çka ti themi? Tha: "thoni: All-llahu është më i lartë dhe më i madhërishtëm". Pastaj tha Ebu Sufjani: Ne kemi Uzanë, kurse ju nuk keni Uzaa. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: a nuk i jepni përgjigje? Thanë: çka ti themi? Tha: thuani: All-llahu është

miku ynë, kurse ju nuk keni mik". (Buhariu).

Fitorja është duke ardhur për ummetin islam, e nëse vonohet ardhja, për ndonjë urtësi të Zotit, duhet ditur se premtimi i All-llahu do të ndodhë sigurisht dhe thënia e tij do të zbatohet:

"E tashmë fjala (premtimi) e jonë u është dhënë më parë robërve tanë të dërguar, se ata, pa dyshim do të jenë të ndihmuar. Dhe se ushtria jonë do të jenë ata ngadhënjësit". (Es-Safat: 171- 173).

Ne, musliman të nderuar, duhet ti plotësojmë shkaqet, të cilat e sjellin premtimin e Zotit, sepse popujt tonë All-llahun e njohin, andaj nuk do të humbë nga një popull që nuk e njeh Zotin dhe një popull që e njeh të vërtetën, nuk mund të humbë nga një popull që nuk e njeh të vërtetën.

"S'ka dyshim se ata që e kundërshtojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, të tillët janë ndër më të poshtëruarit. All-llahu ka përcaktuar (shkruar në Levhi Mahfudh): "Unë dhe të dërguarit e Mi patjetër do të ngadhënjëjmë!" All-llahu është i fortë, ngadhënjës". (El-Muxhadele: 20- 21).

Dërgoni salavate mbi njeriun më të mirë dhe më të pastër, Muhammed, ibën Abdull-llahun, pronar i haudit dhe shefatit, All-llahu ju ka urdhëruar me një gjë, me të cilën ia ka filluar nga Vetveteja, pastaj i ka përmendur melaqet, e pastaj juve besimtar, duke thënë:

"Është e vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përsëndeteni me selam". (El-Ahzab: 56).

Suud Shurejmi
Imam dhe hatib në Mesxhidul-Haram
Hutbe e mbajtur më: 19/2/1425
Përktheu: Bekir Halimi
Marrë nga: alminbar.net
16.4.2004

Veçoritë e ummetit të Muhammedit, alejhisselam

O ju musliman, e porosis vehten dhe juve që të keni frikë nga All-llahu, sepse me te, dalim nga çdo ngushticë, me të arrijmë shpëtimin nga vuajtjet:

"...e kush ka frikë All-llahun, atij Ai i hap rrugë, dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare...". (Et-Talak: 2-3).

Musliman të nderuar!

Ummeti islam sot, edhe pse është në udhëkryq, vuan nga sulmet e njëpasnjëshme të armiqve, sprovohet me llojloj sfidash, përjeton dëme të ndryshme, jeton nën rreziqe të shumta, ka shumë nevojë që të përmirëson gjendjen e vet dhe t'i drejton çështjet e veta. Ai sot ka shumë nevojë për gjëra që ia kthejnë vetbesimin dhe qetësinë, për gjëra që ia forcojnë rrigën e krenarisë dhe epërsisë, që e shtojnë rrugës së shpëtimit dhe lumturisë.

Ummeti islam sot ka shumë nevojë për të rishikuar veçoritë e veta, ti kupton komponentet përbërëse të tij, sepse një ummet që ka veçori nuk mund të jeton jetë të mirë, nuk mund të hypë shkallëve të plotësisë, nuk mund të rreshtohet në rradhët e të lumturve, fitimtarëve, shpëtimtarë dhe krenarë, përveç se duke i zbatuar ato.

Musliman të nderuar!

Veçoria më e madhe e këtij ummeti është fakti se ai i nënshtrohet All-llahut dhe Atij i dorëzohet në çdo gjë të jetës së tij, duke patur parasysh ajetin:

"Thuaj: "Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i

pari i muslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!". (El-Enam: 162- 163).

Pra, është dorëzim i plotë para All-llahut dhe Pejgamberit në të gjitha sferat e jetës, në gjërat e mëdha dhe në ato të voglat, duke zbatuar fjalën e All-llahut:

"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden singërisht". (En-Nisa: 65).

Ummeti islam nuk mund të arrijë lumturi, shpëtim, krenari dhe mëkëmbësi, vetëm se duke e realizuar tërësisht besimin e pastër dhe të kulluar:

"Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë". (El-Enam: 82).

Siguria dhe qetësia në të gjitha segmentet nuk mund të arrihet pa besim, sepse njeriu me besim të fuqishëm vetëm All-llahut i frikohet, sepse ai e di se çdo fuqi para fuqisë së Zotit është asgjë, çdo pushtet para pushtetit të Zotit është vegim. All-llahu, subhanehu ve teala, duke folur për Ibrahimin, alejhisselam, thotë:

"...Unë nuk u frikohem atyre që ju ia bëni shok, vetëm nëse Zoti im do ndonjë send (të më godas, ai më godet). Me dijen e Tij Zoti im ka përfshirë çdo send, a nuk e merrni me mend?". (El-Enam: 80).

Vëllezër musliman!

Prej veçorive të ummetit islam është edhe qëndrimi larg gjërave të kota në çdo formë

të sajë dhe në të gjitha sferat. Ikja nga vep-
rimet e kota dhe epsheet e ndaluara, pasiqë
është ummet që dëshiron të mbetet në pozi-
tën e vet të lartë, të cilën e kërkon besimi në
All-llahun si Zot të tyre, islamini si fe të tyre
dhe Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,
si peygamber të tyre. Është ummet serioz dhe i
përmirësimit. E mbush tërë jetën e vet me gjëra
të dobishme dhe shfrytëzon tërë potencialin e
vet për zhvillim, ndërtim dhe epërsi.

Ummeti Islam është ummet që e lidh sho-
qërinë e vet me pastërtinë dhe dliresinë në
tërë sjelljet dhe dëshirat e veta. Ajo çdo
herë ngadhënjën ndaj epsheet të vet, egoizmit
dhe pasionet personale, në përjashtim të
gjërave që i ka lejuar Zoti, i Plotfuqishëm.
All-llahu, subhanehu ve teala, duke i sqaruar
veçoritë e ummetit të Muhammedit, sal-lall-
llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtar-
rët: ata të cilët janë të përlulur dhe të kuj-
desshëm gjatë faljes së namazit, ata të cilët
i shmangen të kotës (fjalë a punë), dhe ata
të cilët rregullisht e japin zeqatin, dhe ata të
cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës
intime), me përjashtim ndaj grave të veta
(me kurorë) dhe ndaj atyre (robëreshave)
që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk
janë të qortuar,..". (El-Muminun: 1-6).

Musliman të nderuar!

Ummeti islam prej veçorive më të dalluara,
komponenteve të krenarisë dhe shkaqeve të
mirësisë ka principin e pajtimit në çdo të mirë,
bashkimi në çdo bamirësi dhe uniteti nën hije të
besimit islam dhe premisave të kësaj feje. All-
llahu subhanehu ve teala, thotë:

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fe-
në dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përça-
ni!...". (Ali Imran: 103).

Kurse Peygamberi ynë, sal-lall-llahu alejhi
ve sel-lem, na thotë:

"All-llahu ua pëlqen tre gjëra dhe ua urren tre

tjera. Ua pëlqen: Ate ta adhuronin dhe në adhu-
rim mos ti përshkruani shok, të kapeni për litarin
e All-llahut të gjith dhe mos të përçaheni. Kurse i
urren: thashethëmet, pyetjet e shumta dhe
humbjen e pasurisë". (Muslimi).

Andaj, çdo herë që ummeti largohet nga
këto veçori, përçahen mes vehte, kanë qën-
drime të ndryshme ndaj ndodhive, elimino-
het uniteti, atëherë dobësohet fuqia e këtij
ummeti, largohet prestigji i tij dhe dështon
në të gjitha çështjet e veta.

"Dhe respektojeni All-llahun e të dërguarin
e Tij, e mos u përçani mes vete, e të dobë-
soheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të
jeni të durueshëm se All-llahu është me të
durueshmit". (El-Enfal: 46).

Ummeti sot duhet ti haroj mosmarëveshjet
dhe ti jep përparësi interesit të përgjithshëm
para atij të veçantë, të ecë hapave të të tjerëve,
duke i zbatuar shkaqet e unitetit dhe bashkimit
në udhëzim, mirësi dhe përmirësim.

Prej veçorive të këtij ummeti është fakti se
ata janë ummeti më i mirë që kanë dalur për
njerëzimin:

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur
për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për
mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të
besoni në All-llahun. ...". (Ali Imran: 110).

Në realitet ky ummet ka dalur që të jetë
në krye dhe udhëheqëse në çdo të mirë.
Obligimi i tij është nxerja në shesh për po-
pujt tjerë mirësinë e cila personifikohet në
besimin e shëndoshë, moralin fisnik dhe
principet e vlefshme. Pra, është ummeti më i
mirë për shkak se realizon besimin e shën-
doshë, i zbaton detyrat e ummetit të mirë,
me të cilat e ruan jetën e njerëzimit nga çor-
rodia, e keqeja dhe kobi. Thirrja që e bën ky
ummet për vlera dhe jetë të pastër shpjen
në peshojë të drejtë dhe vlera të mira.

Për këtë, çdo herë që ummeti i humb këto
komponente të mirësisë, të cilat janë të ve-

çanta për te, ose e le mangut ndonjë shkak prej shkaqeve, bjer në dëme, sprova dhe e kaplojnë të gjitha të këqijat dhe kobet. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Pasha Ate në Dorë të të Cilit është jeta ime, ose do të urdhëroni në të mirë dhe do të ndaloni nga e keqeja, ose së shpejti All-llahu do të dërgoj mbi ju dënim prej Tij, pas-taj do të luteni, mirëpo nuk do tu përgjigjet". (Hasen, Tirmidhiu).

Musliman të nderuar!

Ummeti islam prej veçorive të veta ka edhe faktin se është ummet i ndihmuar nga Zoti, pa marr parasysh se çfarë pengesa janë vënduar para tij, pa marr parasysh se sa kundërshtime ka në këtë rrugë, pa marr parasysh se sa e përdorin ithtarët e të kotës fuqinë e zjarrit, reklamata e ndryshme dhe shpifjet cinike, ai ka premtime për ngadhënjim dhe krenari të plotë, në fenë dhe dynjanë e vet, në luftën dhe paqën e vet. Mirëpo kjo fitore është e kushtëzuar me vërtetësi të besimit, zbatim të islamit, veprim sipas sunnetit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, orientim sipas jetëpërshkrimit të tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"E tashmë fjala (premtimi) e jonë u është dhënë më parë robërve tanë të dërguar, se ata, pa dyshim do të jenë të ndihmuar. Dhe se ushtria jonë do të jenë ata ngadhënjuesit". (Es-Saffat: 171- 173).

"Ne patjetër do të ndihmojmë të dërguarit tanë në jetën e kësaj bote, edhe ata që besuan, e edhe në ditën e prezentimit të dëshmive". (Gafir: 51).

Ummeti islam ka premtime për mëkëmbësitë e ruzullit tokësor, për sundim të fuqishëm me fenë e vërtetë, për jetë të sigurtë nga reziqet dhe dëmet. Mirëpo ky premtim është i ndërlidhur me zbatimin e të gjitha obligimeve që dalin nga kjo fe, ta respektojmë Zotin në të gjitha vendimet e Tija, duke

mos lënë në mesin tonë epsh në zemër dhe çdo veprimtari në këtë botë ta bëjmë duke pasuar udhëzimin e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

"Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit. Falni rregullisht namazin, jepni zeqatin dhe respektoni të dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni". (En-Nur: 55- 56).

Ky është besimi, i cili e shtyn ummetin të drejtohet ka Zoti me sinqeritet, në sferën e besimit dhe adhurimeve, në legjislacion dhe vendime, në veprimtari, sjellje dhe lëvizje. Besim i cili na shtyn që islamit ta kemi metodë jete, për ta realizuar mëkëmbësinë në ruzullin tokësor, mëkëmbësi të cilën e ban ummeti i Muhammedit, alejhisselam, i cili mer përsipër procesin e përmirësimit dhe ndërtimit e jo të prishjes dhe çorodisë, ummet i cili zhvillohet në bazë të drejtësisë dhe bamirësisë, e jo në bazë të padrejtësisë dhe zullumit.

Ti, o, ummet i vlefshëm! Zbatoni kushtet, kuptoni premtimet dhe të premtuarat dhe përkujtoni se gjatë historisë së ummetit të Muhammedit, alejhisselam, kur ata kanë përqendruar në metodën e kënaqshme, çdo herë që kanë ecur sipas këtij rregulli Kur'anor, çdo herë që kanë gjykuar këtë metodë hyjnore dhe kanë pëlqyer me te në të gjitha çështjet, atyre u është realizuar premtimi për mëkëmbësi, siguri, shpëtim dhe lumturi, kurse çdo herë që kanë kundërshtuar këtë metodë, ata kanë mbetur në bishtin e karvanit, janë mposhtur pas krenarisë, u ka futur frika në mesin e tyre pas sigurisë dhe e kanë sulmuar armiqët nga çdo anë.

O ju musliman!

Si ka mundësi që ummeti islam të kërkon shpëtim, kur ka humbur shumë komponente të veta?! Si ka mundësi të synon krenarinë dhe mëkmëbësinë, kur i kanë lënë pas dore bazat dhe kushtet?! Si ka mundësi të shpëtojë një ummet, i cili nuk gjykon me ligjin e All-llahut dhe kur jetën e vet e orineton sipas udhëzimeve tjera?! Si ka mundësi të shpreson shpëtimin nga rreziqet, kur i ka lënë pas dore në shumë segmente bazat e përmirësimit, që është urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga të këqijat, në jetën e vet dhe mes fëmijëve të vet?! Si ka mundësi që ummeti të arrijë në krenari dhe zotërim, fitore dhe lumturi, kur muslimanët janë dhënë pas epsheve, duke mos respektuar asnjë rregull të sherijetit të pastër, i cili i rregullon mangësitë dhe e mbron ummetin nga çorodia në çdo sferë?! Si ka mundësi ummeti të shpëton nga fatkeqësitë dhe sprovat që i kaplojnë ithtarët e vet nga vet populli i vet, ata që veprojnë për ta devijuar shoqërinë muslimane, që janë shkak për përhapje të imoralitetit, nëpërmjet programeve të pavlera, të cilat përmbajnë çdo të keqe dhe çdo dëm?! Kurse All-llahu, Zoti ynë, thotë:

"Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënimi i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk i dini". (En-Nur: 19).

All-llahu na bekoftë me Kur'anin, na bëftë të kemi dobi nga zotëriu i njerëzimit. E them këtë që dëgjuat dhe kërkoj falje për mua, për ju dhe për mbarë muslimanët nga çdo mëkat, andaj edhe ju kërkoni falje prej Tij, sepse ai është Falës dhe i Mëshirshëm.

II

All-llahun e falënderojmë për bamirësinë e Tij ndaj nesh, e falënderojmë për suksesin dhe begatitë. Dëshmoj se ska hyjni tjetër përveç Tij, i cili është Një dhe pa ortak, duke e madhëruar Ate dhe dëshmoj se zotëriu dhe Pejgamberi ynë, Muhammedi, është robi dhe i Dërguari i Tij, i cili ka thirur për te kënaqësia e Tij. All-llahu ynë, dërgo salavatet dhe selamet te Pejgamberi, familja, shokët dhe vëllezërit e tij.

O ju musliman!

Ju porosis ju edhe vetveten që të kemi devotshmëri, sepse kjo është porosia e Zotit për mbarë njerëzit, të parët dhe të fundit.

Musliman të nderuar!

Ummeti islam është ummet që ka metodë të qartë, metoda e tij është metodë e udhëzimit dhe besimit, metodë e sherijetit dhe islamit, çdo herë që i kundërshtohet dhe largohet nga rregulli, e godet vuajtja e dynjasë para se të vjen ajo e ahiretit, jeton në dilema dhe kaos, e kaplon vështirësia nga çdo anë:

"... Nëse u vjen nga Unë udhëzim (libër e pejgamber) kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në Dunja) e as nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër). E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjall të verbër". (Taha: 123- 124).

All-llahu na ka urdhëruar me një urdhër të madh, i cili na e pastron jetën, e ajo është ta shtojmë dërgimin e salavateve mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem...

Husejn Alu Shejh,
Xhamia e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem
Medinë: 12/2/1425
përktheu: Bekir Halimi
www.alminbar.net,
9.4.2004

Dyert e të mirës

Ju porosis, o ju njerëz, që të jeni të devotshëm, keni frikë All-llahun, nëse dëshironi të mëshiroheni.

Ai që dëshiron shpëtim le të pasurohet me devotshmëri, ai që dëshiron të jetë mik i All-llahut, le të miqëson të devotshmit, sepse njerëzit më të ndershëm të All-llahu, janë më të devotshmit, kurse ahireti u takon të devotshmive. Ai që troket dyert tjera duke i haruar të Zotit, rrëshqet, kurse ai që nuk i falenderon të mirat e Zotit, dështon. Ymri është i llogaritur, veprat e regjistruara, koha kalon si retë, takimi është ditën e llogarisë, kurse All-llahu është furnizuesi, e fundi i takon të devotshmive, andaj keni frikë All-llahun, subhanehu ve tealë.

O ju musliman!

Njerëzit dallojnë për nga brengat, dallojnë për nga natyra, për nga synimet, dëshirat dhe lakmitë, mirëpo të gjithë së bashku janë të plotë, njëri tjetrit i shërbejnë:

“A thua ata e përcaktojnë mëshirën (pejgamberllëkun) e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime. E mëshira (caktimi për pejgamber) e Zotit tënd është shumë më e dobishme se ajo që ata grumbullojnë”. (Ez-Zuhuf: 32).

All-llahu i udhëheqë çështjet e njerëzve, ligjet e Tija mbi ta zabatohen, i ka ndarë prirjet dhe pronësitë, ashtu sikur ua ka ndarë rizkun, natyrën dhe moralin e tyre. Dallojnë për nga perceptimet dhe kuptimet, ashtu siç dallojnë për nga gjuha dhe ngjyra:

“Nga argumentet e Tij është krijuar i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz”. (Er-Rum: 22).

“E All-llahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni”. (ES-Saffat: 96).

Vëllezër të nderuar!

All-llahu, subhanehu ve tealë, ka krijuar krijesat për ta adhuruar dhe për ta respektuar, mirëpo edhe ka ndarë hisen e tyre në to, ka bërë dallime mes tyre në përpjekjet e tyre, disa prej tyre janë të regjistruar si namazli dhe të devotshëm, e tjerët si sadakadhënës dhe bamirës, e të tretët si agjërues, e të katërt si muxhahidë, e kështu me rradhë. U hapen dyert e veprave të mira dhe të kërkuara prej tyre, qofshin adhurime vullnetare, ose obligime kolektive, ku bëjnë gara garuesit dhe dallohen të parët. Ai që ka hise në më shumë adhurime ai që ka gradën më të lartë dhe më të madhe në xhennet.

Mendoni, All-llahu ju ruajtë, mbi këtë hadith.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, thotë: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

“Ai që shpenzon dy gjëra në rrugë të All-llahut thirret nga dera e xhennetit: o rob i All-llahut, kjo është e mirë, ai që është namazli, ai thirret nga dera e namazit, ai që është i xhihadit, thirret nga dera e xhihadit, ai që është i sadakasë, ai thirret nga dera e sadakasë, ai që është i agjërimin, thirret nga dera e agjërimin dhe dera e Rejanit”. Ebu Bekri radijall-llahu anhu, tha: ç’farë nevojë

ka ai që thirret nga këto dyer. Tha: a ka mundësi dikush të thirret nga të gjitha dyer-të? Tha: po, shpresoj që të jesh ti ai, o Ebu Bekër". (Buhariu). Në transmetimin e Ibën Hibbanit qëndron:

"Ti je ai, o Ebu Bekr".

Kurse në transmetimin e Ahmedit dhe Ibën Ebi Shejbes qëndron:

"Secili vepërmirë ka nga një derë të xhen-netit, nga e cila do të thirret".

Dëgjone këtë fjali nga Imam Maliku, rahimehull-llah, i cili iu përgjigj një letrës, të cilën ia kishte shkruar Abdullah el-Omeriu, i cili e stimulonte Imam Malikon në izolim dhe vepërim individual, kurse Imam Maliku, iu përgjigj:

"All-llahu i ka ndarë veprat ashtu sikurse i ka ndarë rizqet, ndoshta dikujt i është hapur dera e namazit, e nuk iu ka hapur dera e agjërimit, tjetrit i është hapur dera e sadakësë e nuk iu ka hapur dera e agjërimit... Përhapja e dijes është prej veprave më të mira të bamirësisë, andaj unë jam dakord me atë që më është hapur dhe nuk mendoj se vepra të cilën e bëj unë është më e vogël se vepra të cilën e bën ti, shpresoj se që të dy jemi në mirësi dhe bamirësi". ("Et-Temhid", 7/ 185).

Abdull-llah ibën Mubareku, rahimehull-llah, ka thënë:

"Nuk kam parë dikën të jetë ngritur sikur Imam Maliku, nuk ka pasur shumë namaz dhe agjërim, përveç nëse ka pasur diçka të fshehur". ("El-Hilje", 6/ 330).

Imam Dhehebiu në lidhje me këtë thotë:

"Përhapjen e diturisë që ka bërë Imam Maliku është më e mirë se namazi dhe agjërimi vullnetar, për atë që shpreson Fytyrën e All-llahut". ("Sijeru A'lamun-Nubela", 8/ 97).

O ju musliman!

Rrugët e të mirës janë të shumta dhe dyert e veprave të mira janë të hapura, andaj dijetarët kanë thënë: "Nuk i hapen të gjitha

dyert e veprave të mira, zakonisht, një njeriut, nëse i hapet një derë, nuk i hapet tjetra, rrallë janë ata njerëz që u hapen më shumë dyer, andaj në këtë kontekst është edhe ajo që ia tha Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Ebu Bekrit, radijall-llahu anhu: "Shpresoj të jesh prej tyre, o Ebu Bekr".

Shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, shumë e donin veprën e mirë dhe kujdeseshin për te saqë e pyetnin Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Cila vepër është më e mira?" E Pyetnin: cila vepër është më e dashur te All-llahu?" Sepse ata e dinin se njeriu nuk ka mundësi që t'i realizojë të gjitha veprat e mira.

Përgjigja e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte e ndryshme me ndryshimin e gjendjes, kohës dhe njerëzve. Dijetarët kanë treguar urtësinë për ndryshimin e përgjigjeve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: "Kjo ka ndodhur për shkak të ndryshimit të gjendjes së pyetësve dhe ndryshimit të kohës së tyre, andaj ia mësoi secilit pyetës gjërat që i nevojiten, ose për të cilat ka nevojë ose që i përkasin dhe i përshtaten".

Mendoni rreth këtyre përgjigjeve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

Abullah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, thotë:

"E pyeta Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: cila vepër është më e dashur te All-llahu? Tha: Namazi në kohën e vet. Tha: pastaj cila është? Tha: Bamirësia ndaj prindërve. Tha: pastaj cila është? Tha: lufta në rrugë të Zotit. Tha: këto mi tregoi, e nëse pyetësja edhe ma shumë, ai do të më përgjigjej akoma. (Buhariu dhe Muslimi).

Maizi, radijall-llahu anhu, thotë: e pyeta Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, cila vepër është më e mirë? Tha:

"Besimi në Zotin Një, pastaj xihadi në

rrugë të Zotit, pastaj haxhi i pranuar, është më i vlefshëm se veprat tjera, ashtu siç ka dallim në të mes lindjes dhe perëndimit të diellit”. (Sahih, Ahmedi).

Ebu Umamete, radijall-llahu anhu, ka pyetur: cila vepër është më e mira? Ka thënë:

“Agjëro, sepse agjërimi nuk ka rival”. (Sahih, Nesaiu).

Ebu Dherri, radijall-llahu anhu, o i Dërguari i All-llahut, cila vepër është më e mirë? Tha:

“Besimi në All-llahu dhe xihadi në rrugë të All-llahut”. Tha: cili skllav është më i miri? Tha: “Më i shtrenjti dhe më i çmueshmi në familjen e vet”. Tha: nëse këtë nuk mundem ta bëjë, çka të bëj? Tha: ndihmoji atij që di të punon ose puno për ate që nuk di (të punojë gjë)”. Tha: e nëse jam i dobët? Tha: “Nguro nga e keqeja, sepse kjo është sadaka për vehten tënde”. (Buhariu dhe Muslimi).

Aisheja, radijall-llahu anha, tha: e kanë pyetur Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: Cila vepër është më e dashur te All-llahu? Tha:

“Ajo e vazhdueshmeja, edhe në qoftëse është pak”. Dhe tha: merni përsipër veprat që mund ti bartni”. (Buhariu).

Muadhi, radijall-llahu anhu, thotë: e kam pyetur Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: cila vepër është më e dashur te All-llahu? Tha:

“Të vdesish me gjuhë të lagur nga përmendja e All-llahut”. (sahih, Ibën Hibbani).

Kur fukaratë i thanë Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

“O i Dërguar i All-llahut, na e kaluan të pasurit me shpërblime, falen sikur falemi, agjërojnë si agjërojmë, mirëpo ata japin sadaka nga pasuria e tyre”.

Dijetarët thanë: ata menduan se sadakaja është vetëm me pasuri, kurse ata nuk kanë mundësi të bëjnë një vepër të tillë. Andaj

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u tregoi se të gjitha veprat e mira dhe bamirëse janë sadaka, duke u thënë:

“A nuk ju ka dhënë All-llahu çka të jepni sadaka? Çdo tesbih është sadaka, çdo tek-bir është sadaka, çdo tahmid është sadaka, çdo tehليل është sadaka, urdhërimi në të mirë është sadaka, ndalimi nga e keqeja është sadaka edhe marëdhëniet intime tuaja janë sadaka”. (Muslimi).

Robër të All-llahut!

Me të vërtetë rrugët e të mirës janë të llojllojshme, dyert e të mirave janë të gjëra, madje edhe një vepër dallon nga personi në person nga shkaku i fuqisë së bindjes dhe vërtetësisë së sinqeritetit, pastrimit të shpirtit dhe realizimit të mbështetjes.

Transmeton imam Nesaiu dhe Ebu Davudi nga Abdullah ibën Hubshi el-Hathemiu, radijall-llahu anhu: e kanë pyetur Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

“Cila vepër është më e mira? Tha: besimi, në të cilin nuk ka dyshim, xihadi në të cilin nuk ka vjedhje dhe haxhi i pranuar”. I thanë: cili namaz është më i mir? Tha: namazi me kizam të gjatë”. Thanë: cila sadaka është më e mira? Tha: kontributi i atij që ska”. Thanë: cili hixhret është më i mir? Tha: ai që largohet nga gjërat që i ka ndaluar All-llahu”. (Sahih).

Transmeton Ebu Davudi, rahimehull-llahu, nga Muadh ibën Xhebeli, radijall-llahu anhu, i cili thotë: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Betejat janë dy lloje: ajo që bëhet duke shpresuar fytyrën e All-llahut, duke respektuar Imamin, duke dhënë pasurinë e vlefshme, duke ia lehtësuar ortakut dhe duke u larguar nga fesadi. Ky njeri edhe gjumin edhe zgjimin e ka shpërblim. Dhe ajo që bëhet për mburrje, syfaqësi, për tu dëgjuar, duke bërë mëkat ndaj Imamit, duke bërë fesad në tokë, ai kthehet bosh”. (Hasen).

Musliman të nderuar!

Nëse kështu është puna, shikoni, All-llahu ju mëshiroftë, ata që All-llahu ua hap dyert e veprave të mira, llojet e ndryshme të adhurimeve, do të shihni se dikujt All-llahu ia hap derën e Kur'anit, përkujdesi për te, leximi i tij në çdo rast, në namaz dhe jashta namazit, gjatë ditës dhe natës. Dikujt ia hap dyert e mësimdhënies, andaj ai preokupim të vetin kryesor e ka mësimdhënien, rregullimin dhe përsosjen. Dikujt All-llahu ia hap dyert e dijes në kapitujt e tevhidit, hadithit, fikhut dhe tefsirit, kurse të tjetrit ia hap dyert e shkencave të ndryshme, e këshut me rradhë. Dikush është i aftë për mësimdhënie, e tjetri për këshillim, e i treti për përpilim.

Dikujt All-llahu ia hap dyert e namazit, sa që namazi bëhet preokupimi i tij kryesor, është kënaqësia e tij gjatë ditës dhe natës, falet me përulje, mposhtje dhe lutje. Tjetrit All-llahu ia ka hapur dyert e agjërimin vullnetar, e shton agjërimin e ditëve të vlefshme, siç është e hëna dhe e enjta, ditët e bardha, një ditë po e një ditë jo, dhe në këtë drejtim dallohet prej tjerëve.

Tjetrit All-llahu ia hap dyert e përkujdesit për prindërit, farefisit dhe familjes, kujdeset për ta, i viziton dhe interesohet për gjendjen e tyre, duke mos pritur prej tyre kundërvlerë dhe falënderim.

Tjetrit ia hap All-llahu dyert e kujdesit dhe solidarizimit me të varfërit, nevojtarët, qofshin afër ose larg, brenda ose jasht, kujdeset për të vejën, për të ngratin, për të huajin, për të varfërin, nuk lodhet nga grumbullimi i ndihmave dhe donacioneve, i troket dyert e të pasurve, futet te bamirësit dhe ua ofron këto gjëra atyre që e meritojnë. Vepron pa ndalë për të larguar brengat e njerëzve, për tua larë borxhet, për tu kujdesur për jetimat, duke u solidarizuar për ta, duke i mësuar ata dhe duke i ruajtur.

Dikujt All-llahu ia hap dyert e ndërtimit të xhamiave, themelimit të vakëfeve, kanë kup-tuar rëndësinë e hapjes së institucioneve shëndetësore, sigurimin e aparateve të ndryshme medicinale, sepse janë përhapur shumë sëmundje që skanë qenë më herët dhe është shtrenjtuar shumë shërimi.

Tjerëve All-llahu u ka hapur dyert e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqeja, durimi në vështirësitë e këtij misioni, duron në këtë drejtim atë që nuk mund ta duron tjetri.

Dikujt All-llahu ia ka hapur dyert e ndërmjetësimit, pajtimit të njerëzve, lirimin e robit, ndaljen e gjakderdhjes, eliminimin e një të keqes, ngritjen e të vërtetës, pengimin e të kotës, izolimi i zullumit, aq sa tjerët nuk mundin.

“Një fjalë e mirë dhe një lehtësim (që i bëhet lypësit) është më e dobishme se një lëmshë që përcillet me të keqe. All-llahu nuk ka nevojë për askë, është i butë”. (El-Bekare: 263).

“Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e All-llahut, Ne do ti japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh”. (En-Nisa: 114).

O ju musliman!

Vepra e mirë ka mejdan të gjërë dhe të madh dhe i nënkupton shumë gjëra. I organizon veprat e zemrës dhe gjymtyrëve, qofshin fjalë, vepra ose qëllime, të brendshme ose të jashtme, prirje ose aftësi, vepra private ose të përgjithshme, individuale ose kolektive, siç është nderimi i musafirit, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazës, përgjigjeja e ftesës, ndihmesa atij që i bëhet zullum, solidarizimi me të varfërin, dhënia ujë, largimi i brengave, dhënia afat borxhliut,

udhëzimit i të devijuarit, krijimi i mundësive të punës, etj. Edhe prej kafshëve mund të fitoni shpërblime, çdo gjë që mbjellni, e nga ajo hanë kafshët, shpezët, ose njerëzit, fiton shpërblime prej sajë...

Vëllezër të nderuar!

Hapja e derës së një vepre do të thotë dashuria e sajë, shtimi, bërja mirë, pasioni pas sajë, përpjekja e madhe për te dhe me te njihet ai njeri.

Bani gara, All-llahu ju mëshiroftë, në vepër të mira, sepse melaqet i dojnë burrat e mirë dhe gëzohen me ta. Keni ambicie të larta, sepse do të ketë njerëz që do të thirren nga të gjitha dyert e xhennetit si shenjë e nderimit dhe madhërimit të tyre për shkak të agjërit, namazit, dhe veprave të tyre të mira të shumta. Ata do të kenë të drejtën të zgjedhin nga cila derë dëshirojnë të hyjnë. Keni ambicie të larta në garimin në vepra të mira dhe mirësi, secili le ta shfrytëzon prirjen për një veprë qoftë nafile ose farzi kifaje.

Kërkoj strehim te All-llahu prej shejtanit të mallkuar:

“Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre. E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë”. (El-Zelzele: 6- 8).

Përfitofsha unë dhe ju nga Kur'ani i Madh dhe udhëzimi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. E them këtë që dëgjuat dhe kërkoj falje prej All-llahut për mëkatet e mia, të juaja dhe të mbarë muslimanëve, kërkoni falje prej Tij sepse ai është Falës dhe Mëshirues.

II

All-llahun e falënderojmë, i Cili vazhdon të na jap dhunti, të Jetë Bamirës ndaj nesh, Ta ndihmon të frikësuarin, Dërgon argumente për të na frikësuar, Ate e falënderoj dhe

ndaj Tij jam mirënjohës, te Ai pendohem dhe prej Tij falje kërkoj. Dëshmoj se ska hyjni tjetër përveç All-llahu, i cili është Një dhe pa ortak, i dorëzohem me besim të drejtë. Dëshmoj se zotëriu dhe pejgamberi ynë, Muhammedi është rob dhe i dërguar i Zotit, të cilin All-llahu e ka dërguar për të vërtetuar pejgamberët që kanë qenë para tij, i cili ka qenë besnik dhe i ndershëm. Paqa dhe bekimi qofshin mbi te, mbi familjen dhe shokët e tij, paqë dhe bekimi i cili sa ma shumë që ia thojmë atij aq ma shumë na shtohet nderi dhe vlera...

O ju musliman!

Duhet sqaruar edhe një, të cilën shumë njerëz e neglizhojnë. E kjo është nënçmimi që ia bëjmë njëri tjetrit, për shkak se dikujt nuk ia ka hapur All-llahu derën e ndonjë adhurimi vullnetar, qoftë namaz, ose agjërim. Atij që ja ka hapur All-llahu një derë të veprave të mira, për këtë duhet ta falënderojë All-llahun, ta ruajë ate dhe ti shtojë të mirat, mirëpo tjetrin nuk duhet ta shikon me sy të nënçmimit, defektit dhe mangësisë, sepse ndodh që vëllaut tënd i është hapur dera e ndonjë të mirës, të cilën nuk e ke parë, ose nuk e di, ose nuk e ke kuptuar, siç është kujdesi për farefisën, kërkimi i diturisë, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqeja, ose dyert e bamirësisë, ndihmave, ndërmjetësimit, etj.

I kanë thënë Abdullah ibën Mesudit, radijall-llahu anhu:

“Pak po agjëron! Ai u përgjegj: kjo më dobëson nga leximi i Kur'anit, kurse unë më shumë dëshirë kam të lexoj Kur'an”. (Taberaniu).

Në librin “El-Ilel”, të Imam Ahmedit qëndron:

“Hasan Basriu ka folur dhe ka shpërndarë dijen duke shpresuar shpërblimin, kurse Ibën Sirini ka heshtur duke shpresuar shpërblimin”. (Bejhakiu).

Evzaiu, rahimehull-llah, ka thënë:

“Ua ka kaluar Hasan Basriu me këshillim, kurse Atau me kryerje të haxhit”. (“El-Ilel”, fq. 1140).

Më e qartë se kjo është ajo që u ka thënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, shokëve të vet kur ka sqaruar se:

“Njeriu më i mëshirshëm i ummetit tim është Ebu Bekri, më i fuqishmi në fenë e All-llahut, është Omeri, më i vërteti është Othmani, më mirë lexon Librin e All-llahut, Ubej ibën Kabi, më mirë e njuh Feraizin, Zejd ibën Thabiti, më mirë njuh hallallin dhe haramin, Muadh ibën Xhebeli, secili ummet ka nga një besnik, e besniku i këtij ummeti është Ebu Ubejde ibënul-Xherrah”. (sahih, Tirmidhiu).

Keni frikë All-llahun dhe angazhohuni duke e kontrolluar vetveten, veprat e zemrës, siç është frika, sinqeriteti, vetkontrolli, ikja nga përgojimi, zilia, inati, nënçmimi i tjerëve, kurthet, dinakëria, prekja e nderit të tjetrit, këto vepra i asgjësojnë veprat e mira, i eliminojnë ato edhe nëse janë sa kodrat e mëdha.

Secili le ta kujotn fjalën e Imam Malikut, rahimehull-llah:

“Secili prej nesh është në mirësi dhe bami-rësi, ndoshta vepra që jam duke e bërë është më e mirë se vepra që je duke bërë ti”.

Nëse e sheh dikend prej vëllezërve që është i angazhuar me të mira me të cilat nuk je i angazhuar ti, thuaj: secili prej nesh jemi në mirësi.

All-llahu subhanehu ve teala, ka thënë:

“E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se All-llahu është në krahun e bëmirësve”. (El-Ankebut: 69).

Dërgoni salavate dhe selame mbi njeriun më të mirë, pejgamberin tuaj, Muhammedin, sepse All-llahu ju ka urdhëruar me këtë gjë në Librin e Tij duke thënë:

“Është e vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam”. (El-Ahzab: 56).

All-llahu ynë, beko dhe dërgo selame mbi robin dhe të dërguarin tënd, Muhammedin, mbi familjen e tij të pastër dhe të mirë, mbi gratë e tija që janë nënat e besimtarëve, dhe je i kënaqur nga katër halifet e drejtë...

Salih ibën Humejd
Imam dhe hatib i Mesxhidul-Haramit
Mekë: 1/ 28/ 1425
Përshtati: Bekir Halimi
www.alminbar.net,
26.3.2004



Lënia e dispozitave të shariatit nga ana e shteteve muslimane ka sjellë padrejtësi njerëzve

Një studim bashkohor kuvajtian, ka potencuar se burimet e gjykimit në shariatin islam i kaplojnë të gjitha risitë në jetën njerëzore dhe se shiariati dallohet nga ligjet tjera pasi që ai është i vlefshëm për çdo kohë dhe vend.

Kjo është shprehur në studimin, të cilin e ka prezantuar dekani i Fakultetit të Shariatit dhe studimeve islame në universitetin e Kuvajtit, dr. Muhamed Tabetabai, në një konferencë mbi gjyqësinë dhe sistemet e drejtësisë në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Studimi ka titullin "Burimet e Vendimit gjyqësor në shariatin Islam dhe kaplimi i të gjitha ndodhive të reja".

Ky studim ka potencuar se vendimi gjyqësor në shariatin Islam synon realizimin e interesit dhe eliminimin e dëmit në shoqëri. Pasi që tekstet e shariatit islam i mbulojnë të gjitha kodet penale dhe nuk ka dënim, për të cilin nuk ka tekst. Kurse ixhtihadi i kaplon edhe ato risi, të cilat janë paraqitur në sferën e gjyqësisë.

Sipas gazetës "Er-Rejul-Am" dr. Tabetabai ka potencuar se lënia e shariatit nga ana e shumë shteteve muslimane u ka bërë njerëzve padrejtësi. Me vet ndryshimin e burimeve të vendime gjyqësore dhe ndryshimin e tyre me ligje perëndimore, duke besuar se shiariati islam nuk është në përputhje me të gjitha risitë që paraqiten në shoqëri!

Dr. Tabetabai në këtë studim të tij, solli shumë argumente që tregojnë se shiariati islam i kaplon edhe ndodhitë e reja, urtësinë e tyre dhe burimet e vendimeve gjyqësore në Islam.

Ky studim kuvajtian ka sqaruar urtësinë e kaplimit të vendimeve dhe risive nga ana e shariatit islam dhe se kjo përmban në vehte realizim të interesit dhe argument kundër pretendimeve si dhe argumenton ate se shiariati islam është përmbyllja e shpalljeve.

Konferenca mbi gjyqësinë dhe sistemet e drejtësisë, të cilën e organizoi Ministria e Drejtësisë të Arabisë Saudite ka vazhduar tre ditë.

Marrë nga: islammemo.cc
9.4.2004



Të veshura, të zhveshura

Falenderimi i takon Allahut, Zotit të botrave. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut, të Vetmit, që s'ka shok. Dhe se zotëriu ynë, Muhamedi, është rob dhe i dërguar i Tij, i dashur i Tij dhe i zgjedhuri prej krijesave. E kreu amanetin, e transmetoi shpalljen dhe e këshilloj Umetin. Luftoi në rrugë të Allahut me një luftë të vërtet gjersa i erdhi vdekja. O Allah shpërbleje atë ndaj nesh më mirë se çdo Profet tjetër ndaj popullit të vet dhe më mirë se çdo i dërguar ndaj thirrjes së tij! Paqja, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, mbi familjen e tij, shokët e tij, te dashurit e tij dhe të gjith ata që ndjekin udhëzimin e tij, kapen prej sunetit të tij dhe pasojnë gjurmët e tij deri në ditën e fundit.

Vëllezër dhe motra ne Islam, jemi duke vazhduar mësimin tonë, me ndihmën e Allahut dhe mbështetjen e Tij, rreth shenjave te vogla të Kijametit, në serinë e mësimëve mbi ditën gjyqimit, si një prej shtyllave të Imanit. Po e shfrytëzoj këtë takim për të folur rreth shfaqjes së grave të veshura por edhe të zhveshura si një prej shenjave të vogla të Kijametit, për te cilën na ka informuar ai që flet të vërtetën dhe i besohet, ai i cili nuk flet nga mendja e tij. Dhe sot po shohim si u vërtetua fjala Pejgamberike thënë katërmbëdhjetë shekuj më parë.

Dëshiroj të përqëndroheni në Hadithin që do të vijojë, sepse Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, e ka përshkruar situatën me hollësinë më të madhe, sikur po jeton midis nesh e po na flet mbi gjen-

djen e mjeruar të grave tona, përveç atyre që i ka mëshiruar Allahu.

Hadithi transmetohet nga Imam Ahmedi dhe të tjerë me zinxhir të saktë, vërtetuar nga dijetari Ahmed Shakir, Allahu e mëshiroftë. Prej Abdullah ibën Omerit transmetohet se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Në fund të Umetit tim do të ketë njerëz që hipin mbi disa lloj samarësh që ngjajnë si shtëpi, zbresin prej tyre tek dyert e xhamive. Gratë e tyre janë të veshura por, të zhveshura, kokat e tyre janë si gungat e deveve të dobëta. Mallkojini ato sepse ato janë të mallkuara. Nëse do të ketë pas jush ndonjë popull, do t'u shërbejnë gratë tuaja grave te tyre, siç po ju shërbejnë ju gratë e popujve para jush."

Shikoni me vëmendje këtë fjalë Pejgamberike: "Në fund të Umetit tim do të ketë njerëz që hipin mbi disa lloj samarësh që ngjajnë si shtëpi..." Këtu Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, (sikur) ka përshkruar mjetet e sotme të udhëtimit. Po të shohësh një automobil modern vëren se ai nuk ka shumë ndryshim nga një shtëpi. Ulëset janë të rehatshme e mund të shtrihen për të fjetur, në të mund të hash ushqim dhe të marësh pije, bile në autobusët e linjave të largëta ke dhe banjo me ujë të ftohtë apo të ngrohtë brenda, ka frigorifer etj. Kjo nuk ka nevojë për shumë përshkrim por ajo që duhet të ndalemi është fjala e Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, "Në fund të Umetit tim do të ketë njerëz që

hipin mbi disa lloj samarësh që ngjajnë si shtëpi, zbresin prej tyre tek dyert e xhamive..." Sot shohim oborrin e xhamisë plot me makina që arrijnë deri tek dera, makinat private, pak më tutje sheh taksitë, autobusët e linjave urbane etj. Prej këtyre burrave që vijnë me makinat e tyre deri tek dera e xhamisë ka të tillë që gratë i kanë të veshura por, të zhveshura. E lus Allahun ti mbulojë gratë tona dhe vajzat tona me mbulesën islame. O Allah bëja të dashur atyre mbulesën dhe zbukuroje në zëmrat e tyre, me mëshirën Tënde, Ti je Mëshiruesi i Mëshiruesve!

Thotë Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të: "... gratë e tyre janë të veshura por të zhveshura, kokat e tyre janë si gungat e deveve të dobëta..."

Nga gunga që deveja ka mbi shpinë mund të kuptohet nëse ajo është e fortë dhe shëndoshë apo e dobët, kur gunga është e ngritur tregon se deveja është e fortë ndërsa nëse është e ulët dhe e vogël tregon se deveja është e dobët. Sot nuk mungojnë gra të tilla, që i rregullojnë flokët duke i mbledhur mbi kokë si topuz, pikërisht si gungat e deveve të dobëta. Ka mënyra nga më të ndryshmet për prerjen e flokve, sallonet e bukurisë nuk kanë të mbaruar. Sapo del një model i ri shkon gruaja për ti prerë flokët sipas tij, bile dhe për ti ndryshuar flokët me flokë artificiale. Shkon e ulet para një burri të huaj, me dëshirën e saj të plotë, që t'i rregullojë asaj flokët e ta zbukurojë.

Thotë Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të: "...mallkojini ato sepse ato janë të mallkuara..." Këtu dëshiroj të ndalem për të shpjeguar me hollësinë më të madhe një rregull bazë, i cili është; gjykimi i përgjithshëm dhe gjykimi i veçantë. Nuk lejohet t'i shkosh një gruajë që del "e veshur por e zhveshur" e ti thuash; ti je e mallkuar. Kjo është rreptësisht e ndaluar. Ajo ç'ka du-

het bërë është që ti sqarohet asaj çështja, ti shpjegohet e vërteta me urtësi dhe mëshirë, me edukatë dhe modesti. Ka shumë dallim kur thua; i mallkoftë Allahu ato gra që dalin të veshura por të zhveshura, ky është gjykim i përgjithshëm, dhe kur thua; e mallkoftë Allahu filan grua që del e veshur por e zhveshur, ky është gjykim i veçantë.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: "...mallkojini ato sepse ato janë të mallkuara. Nëse do të ketë pas jush ndonjë popull, do t'u shërbejnë gratë tuaja grave të tyre, siç po ju shërbejnë ju gratë e popujve para jush." Ky është poshtërimi që po përjetojnë muslimanët në këtë kohë, si pasojë e lënies së fesë së Allahut. Këto janë frytet e hidhura të largimit nga parimet islame. Sot muslimanët poshtë-rohen...nga çifutët, mbi të cilët Allahu ka vendosur poshtërimin. S'ka ndihmë dhe ndryshim veçse prej Allahut.

Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë gjithashtu në Hadithin e Muslimit, të trasmetuar nga Ebu Hurejra: "Dy grupe njerëzish prej banorve të zjarrit nuk i kam parë akoma; disa burra që mbajnë shkopinë si bishtat e lopëve e godasin njerëzit me ta dhe gra që janë të veshura por të zhveshura, përdridhen dhe bëjnë njerëzit të dridhen, kokat e tyre janë si gungat e deveve të dobëta, nuk kanë për të hyrë në Xhënet dhe nuk do ta ndjejnë aromën e tij dhe pse ajo ndjehet nga një largësi e madhe."

Kjo është dëshmi e të Dërguarit të Allahut se këto dy grupe njerëzish do të jenë në zjarr. Po ndalem të shpjegoj mbi grupin e dytë të përmëndur në Hadith, "gra që janë të veshura por të zhveshura", çdo të thotë kjo? Dijetarët kanë dhënë disa shpjegime, i pari; gruaja që vesh rroba të holla, të tejudukshme dhe shihet se ç'ka përtej tyre, kështu duket sikur të ishte e zhveshur.

Shpjegimi i dytë; gruaja që vesh rroba të ngushta të cilat shfaqin edhe pjesët më intime të saj. Këto janë më provokuese se ato që dalin të zhveshura plotësisht sepse e ndaluar është e lakmuar dhe se njeriu është i prirur që të zbuloj se çka përtej mbulesave, çka përtej perdeve.

I Dërguari i Allahut thotë në Hadithin e trasmetuar nga Ebu Hurejra: “Prej shenjave të Kijametit është që të shfaqen rroba të cilat i mbajnë gra të veshura, por të zhveshura.” Nuk ka dyshim se këto veshje që shohim sot me prerje nga më të ndryshmet, të ngushta, të shkurtëra, të çara nga të gjitha anët nuk kanë ekzistuar apsolutisht në kohën e Pejgamberit. Këto Hadithe janë prej mrekullive të Pejgamberit Muhamed, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, paralajmërimet e bëra në to po i shohim të vërtetohen sot në ditët tona, mëse katërmbëdhjetë shekuj pas thënies se tyre.

“... përdridhen dhe bëjnë njerzit të dridhen...” Pra, përdridhet gruaja gjatë ecjes, majtas e djathtas, dhe bën që të kthehen e ta shikojnë burrat dhe djemt e të dridhen zemrat e tyre prej saj. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë në Hadithin e trasmetuar nga Usama ibën Zejd “Nuk kam lënë sprovë më të dëmshme për burrat se gratë” (trans. Buhariu dhe Muslimi)

Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ue selem, ka gjykuar mbi këto gra se ato do të jenë prej banorve të zjarrit. A ka mundësi femra muslimane e cila del e veshur por e zhveshur ta duroj zjarrin? O ti motër që vesh rroba të ngushta dhe ti që vesh rroba të tejdukshme, a mund ta durosh nxehtësinë e zjarrit? A e di se ushqimi i banorve të zjarrit është zjarr, se pija e banorve të zjarrit është zjarr, e di se rrobat e banorve të zjarrit janë prej zjarri?

“A të erdhi ty lajmi për belanë që kaplon? Atë ditë sheh fytyra të përlulura, të lodhura

e të raskapitura. Ato do të hidhen në zjarrin e nxehtë flakërues, u jepet të pijnë nga një burim që valon. Ata nuk kanë ushqim tjetër përveç “Edari’a” (El Gashije: 1-6) A e di çfarë është “Edari’a”?

Gjithashtu thotë Allahu i Lartësuar: “Pastaj hidheni në zjarrin flakërues, pastaj lidheni atë me zinxhir të gjatë shtatdhjetë kut. Vërtet ai nuk besoi në Allahun, më Madhështorin, nuk dha e nuk nixiti për të ushqyer të varfrit. E ai nuk ka këtu ndonjë shok, e as ushqim veçse prej “Gislin” (El Hakah: 31-36) Po “Gislin” e di se ç’është?”

Edari’a është një llojë bime me gjemba helmues ndërsa Gislin është pislëku që del nga të shplarar e plagëve. Ky është ushqimi i banorve të zjarrit.

“ ...Kjo pritje (me shpërblim prej Allahut) është më e mirë apo pema e Zekumit? Ne atë e kemi bërë sprovë për zullumqarët. Ajo është një pemë që del nga fundi i Xhehenemit. Frutat e saj janë si kokat e shejtanëve. Vërtet ata do të hanë prej saj dhe do të mbushin barqet me të. Pastaj mbi gjith këtë do t’u jepet për të pirë ujë i valë. Dhe më pas kthimi i tyre është në Xhehenem.” (Es Saffat: 62-68)

A i duron dot gjithë këto; Edari’a, Gislin, Zekum? Pasi të kenë ngrënë prej këtij zjarri dhe ti këtë përvëluar barqet e tyre, banorët e Xhehenemit kërkojnë ujë që të shuajnë etjen nga përvëlimi dhe nxehtësia e tmerrshme. U jepet për të pirë një lloj uji si vaji që valon nga nxehtësia.

Thotë Allahu i Madhëruar: “ Dhe u shuhet etja me ujë të valë që ua copton zorrët e tyre.” (Muhamed: 15)

“Ne kemi përgatitur për Dhalimunët (zullumqarët, keqbërësit, jobesimtarët) një zjarr, muret e të cilit do ti mbështjellin ata, dhe nëse kërkojnë ndihmë (lehtësim, ujë) u jepet ujë si vaji që valon, pije e tmerrshme dhe vend i poshtër për tu banuar” (Kehf: 29)

“Ata (të dërguarit) kërkuan ndihmën, ndërsa çdo diktator arrogant pësoi dështim. E pas tij është Xhehenemi, në të cilin detyrohet të pijë ujë të vluar, të qelbur. Përpiqet ta kapërcej, por nuk mund ta gëlltis atë, atij i vjen vdekja nga të gjitha anët po ai nuk vdes, atë e pret dënim shumë i rënd.” (Ibrahim: 15)

Edhe rrobat që veshin sot femrat e zbuluara, për të sprovuar me to zemrat e djemve dhe të burrave, do të kthehen në rroba prej zjarri nëse nuk pendohen tek Allahu, Krenari, Falësi.

Thotë Allahu i Madhëruar: “Këta dy kundërshtarë (besimtarët dhe jobesimtarët) kundërshtohen mes veti në lidhje me Zotin e tyre; sa i përket atyre që nuk besojnë, do tu priten rroba prej zjarri, do tu derdhet ujë i valuar mbi kokë, më të u shkrihet ç’kanë në barqe e edhe lëkurat.” (Haxh: 19-21)

Njeriu nuk mund ta duroj dot diellin në një ditë të nxehtë, as zjarrin normal në këtë botë. Dije motër e nderuar se ky zjarr është vetëm një e shtatëdhjeta e zjarrit të Xhehenemit. Sahabët, kur e dëgjuan Pejgamberin, sal-Allahu alejhi ue selem, thanë: Për Allahun, o i Dërguar i Zotit, do të mjaftonte edhe ky zjarr. Tha Pejgamberi (paqa dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të): “Por, zjarri i Ahiretit është gjashtëdhjetë e nëntë herë më i fortë se zjarri i Dynjasë”

Unë nuk e imagjinoj dot se ka burrë në shtëpinë nga e cila del vajza me pantallona të ngushta, bile dhe me streçe, e lyer dhe e pispillosur me makijazh, për të shkuar kësh-tu në shkollë apo në universitet. Nuk po them s’ka besimtar, po burrë.

Por, kësaj i hapen dyert kudo që shkon, ndërsa muslimania, besimtarja e ndershme e veshur me mbulesën islame, duhet të ndalojë tek dera e shkollës apo fakultetit për të hequr shaminë e pastaj të futet në mësim?!

Sot kush flet për mbulesën quhet i prapambetur, fanatik. Pastërtia dhe nderi shikohet si prapambetje, ndërsa degjenerimi si

përparim dhe qytetërim. Në këtë kohë kanë ndryshuar vlerat. Betohem për Allahun se kjo është një nga arsyt kryesore që ne (muslimanët) nuk e meritojmë ndihmën e Allahut në këtë gjendje që ndodhemi.

Pejgamberi, paqa dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Do t’iu vijë njerzve një kohë mashtruese, dëgjohet në të gënjeshtari dhe përgënjeshtrohet i drejti, i besohet tradhëtarit dhe tradhëtohet besniku. Në atë kohë do të flasin Ruejbitat, thanë: Kush janë Ruejbitat o i Dërguar i Allahut? Tha: Njeriu i ulët që flet për çështjet e interesit të përgjithshëm” (ruvejbida)

Këshilla ime për vajzat është që të mbulohen, kini frikë Allahun në veshjen tuaj, kini frikë Allahun në mbulesën islame. Motër e nderuar, të thëras ty, e unë betohem për Allahun se unë të dua të mirën siç dua për vajzën time, dua të jesh e mbuluar siç dua për gruan time, dua të jesh e ndershme siç dua për nënën time dhe motrën time. Ti je perlë e çmuar, je xhevahir i shtrenjt, dhe është e pamundur për një njeri që logjikon, që ta lërë perlën e tij ta shoh çdo sy e ta prek çdo dorë. Motër e nderuar, mos thuaj më bind për mbulesën por, unë po ta korrigjoj kërkesën, thuaj më bind për Islamin. Nëse je muslimane, Ai që të ka urdhëruar për tu mbuluar është Allahu, dhe kur urdhëri vjen prej Allahut ti nuk duhet të thuash gjë tjetër veç asaj që tha muslimania e parë, e mirë dhe e pastër; “Dëgjuam dhe u bindëm, na fal o Zoti ynë tek Ti është kthimi” (Bekare:285)

E lus Allahun ti mbulojë gratë tona dhe vajzat tona, t’iu hap zemrat e tyre për Islamin dhe të vërtetën, vërtetë Ai ka mundësi për çdo gjë.

Por a ka pendim?

Eja vajzë, ti që ke renë në këtë pellg, eja pendohu tek Allahu i Madhëruar, lutju Atij që ti fali gjynahet e shkuara. Dijeni se Allahu

gëzohet kur një person pendohet dhe kthehet tek Ai, e Ai është i Pasuri që s'ka nevojë për askënd. Ai, i Lartësuar, e ka hapur derën e pendimit për robërit e Tij.

Thotë Allahu i Madhëruar: "Thuaj o ju robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar veten me shumë gabime, mos e humbni shpresën prej mëshirës së Allahut, se vërtet Allahu i fal të gjitha gjynahet, Ai fal shumë dhe është Mëshirues." (Zumer: 53)

I Lartësuar i thërret besimtarët dhe kërkon që ata të pendohen sepse njeriu do të pyetet për çdo vepër të tijën e vogël qoftë apo e madhe. Thotë Allahu i Madhëruar: "O ju që keni besuar, pendohuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, në mënyrë që Zoti juaj t'ju falë të këqijat, t'ju çojë në xhenete në të cilat rrjedhin lumenj, ditën në të cilën Allahu nuk e turpëron Pejgamberin dhe së bashku me të as ata që kanë besuar, drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre, e ata thonë: Zoti ynë, na e bëj të përkryer dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti ke mundësi për gjithçka." (Tahrim: 8)

"Pendohuni të gjithë tek Allahu o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim" (Nur: 31)

Dhe çdo natë o ju muslimanë, o ju djem, o ju vajza zbret Allahu i Madhëruar në qiellin e dynjasë (në një mënyrë që i përshtatet madhërisë së Tij) dhe thotë: "Unë jam Sunduesi; A ka ndonjë që më lutet ti përgjigjem atij, a ka ndonjë që kërkon ti jap atij, a ka ndonjë që kërkon falje ta fal atë? Dhe vazhdon kështu deri sa të zbardh agimi"

Trasmetohet se Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një Hadith kudsi: "Allahu i Madhëruar thotë: Unë jam për robin Tim ashtu siç më mendon ai. Unë jam me të kur më përmend, nëse më përmend në veten e tij Unë e përmend atë në veten Time, e nëse më përmend në një bashkësi Unë e përmend atë në një bashkë-

si më të mirë se e tija. Nëse më afrohet një pëllëmbë Unë i afrohem atij një hap, nëse më afrohet një hap Unë i afrohem edhe më shumë, nëse më vjen duke ecur Unë i shkoj atij duke vrapuar" (Buhariu dhe Muslimi)

Gjithashtu Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: "Vërtet Allahu i Lartësuar e shtrin dorën e Tij natën që të pendohet mëkatari i ditës dhe e shtrin dorën e Tij ditën që të pendohet mëkatari i natës" (Muslimi)

Po e mbyll temën me këtë Hadith të nderuar. Trasmetohet prej Omerit se Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, pa një grua prej robëreshave në një luftë duke kërkuar fëmijën e saj, kur e gjeti atë e mori në krah, e shtrëngoi fort dhe i dha për të pirë, kjo pamje rënqethëse ndikoi thellë në zemrën e të Dërguarit të Allahut prandaj i pyeti shokët: A mendoni se kjo nënë mund ta hedhë në zjarr foshnjën e saj? Thanë: Jo o i Dërguar i Allahut, tha: Allahu është më i mëshirshëm me robërit e Tij se kjo nënë me fëmijën e saj" (Buhariu)

Prandaj ejani ju vajza pendohuni, kthehuni tek Zoti i qiejve dhe i tokës! Mjerë për ty nëse thirresh sot që të pendohesh dhe nuk kthehesh, të përkujtohet Allahu e nuk udhëzohesh. Çfarë do të thuash nesër kur të dalësh para Zotit tënd? Kujtohu o motër! Kujtohu o ju muslimanë!

*Kujto veten ditën e ringjalljes të zhveshur.
I vetmuar, trupi të dridhet, i çoroditur!
Zjarri flakëron për mëkatarët prej zemërimi
E Zoti i Arshit me ta është i zemëruar.
Lexoje librin me kujdes o robi Im!
A sheh në të ndonjë shkronjë të pa qenë?
Pasi e lexove dhe gjynahet ti pranove
Thërret i Madhëruari merreni o engjuj!
E shihe këtë mëkatar të etur në zjarr.
Nesër mushrikët do të hidhen në skëterrë
E besimtarët ne Xhenet janë përherë.*

Motër e nderuar, mos u mashtro nga mo-sha jote e re, nga bukuria jote, nga shoqëria as nga gënjeshtret që mund ti bësh prindër-ve sepse një ditë do të qëndrosh para Allahut të Lartësuar i Cili “E di shikimin me cep të syrit dhe atë çka fshehin në zemra” (Gafir: 19)

*O ti muslimane!
Lëre ç'ka kaloi në fëmijëri
Kujto gjynahet e qaj për to
Engjujt jo s'i kanë harruar
Dhe pse ti aspak si kujton
Por mirë i kanë regjistruar
E ti luan dhe jetën dëm e çon
Ty shpirti t'është lënë amanet
Do ta kthesh një ditë dhe pse ti s'do
Dhe dynjaja që t'ka mashtruar
Është kënaqësi e shkurtër, një moment
Ta dish se çdo natë e çdo ditë
Dalin shpirtrat tanë t'japin llogari.*

Të vërteten ka thënë Allahu i Madhëruar: “Por kur (shpirti) vjen tek fyti. Dhe kur të thuhet: Kush mund ta shëroj (dhe ta shpëtoj nga vdekja)? E ai (që po jep shpirt) do ta kuptoi më në fund se është ndarja (koha e vdekjes). Dhe këmbët do të bashkohen me njëra-tjetrën (të mbështjella me qefin). Kthimi atë ditë do të jetë për tek Zoti yt. Kështu pra, ai as nuk besoi as nuk u fal, por përkundrazi ai përgënjeshtroi dhe ktheu shpinën, pastaj ecte gjith krenari drejt familjes

së vetë duke i pëlqyer vetja. Mjerë për ty, mjerë për ty, përsëri mjerë për ty e mjerë për ty! A mendon njeriu se do të lihet i harruar? A nuk qe ai një Nutfah (lëng i ngjizur i vezve të bashkuara) prej spermës që derdhet? Pastaj u bë një Alakah (gjak i mpiksur), pastaj (Allahu) i dha trajtë dhe formë atij në përpjestimin e duhur, dhe bëri prej saj çiftin; mashkullin dhe femrën. A nuk është Ai në gjendje të ngjallë të vdekurit?” (Kijameh: 26-40)

E lus Allahun që të na kthej tek e vërteta me një kthim të bukur. Zoti ynë, na jep prej grave tona dhe pasardhësve tanë të atillë që të jenë qetësia e syve tanë dhe na bëj prijës të të devotshmëve! O Allah mbuloji gratë tona dhe vajzat tona, na ruaj djemt tanë, ktheji ata tek e vërteta me një kthim të mirë, me mëshirën Tënde, Ti je Mëshiruesi i Mëshiruesve!

Të dashurit e mi, kjo është një thirrje që ju bëhet nga një vëllai juaj që ju do për hir të Allahut, e lus Allahun që ta bëjë atë të sinqertë, për kënaqësinë e Tij dhe ti bëjë dobi me të myslimanëve dhe myslimaneve. Çfarë është arritur me të është prej Allahut, të Vetmit, ndërsa ç'ka është gabuar apo harruar është prej meje dhe Shejtanit, vetëm Allahu dhe i Dërguari i Tij janë larg prej gabimeve. Kërkoj mbrojtje nga Allahu që t'ju përkujtoj juve me këtë e të harroj veten.

Paqa, mëshira dhe begatia e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij.

Muhamed Hassan
shkëputur nga një ligjëratë e Muhamed Hassan
përktheu: Altin Braka

Parapëlqehet ndarja e gjinive në arsim

Sistemi i zakonshëm i arsimit të përgjithshëm në Sh.B.A-të ballafaqohet me sfida nga organizatat dhe njerëz që besojnë se mësimi i djemve dhe vajzave në shkolla të ndara jep rezultate më të mira.

Që nga themelimi i arsimit të përgjithshëm në Sh.B.A-të meshkujt dhe femrat mësojnë së bashku në një klasë. Prej 93 mijë shkollave shtetërore anë e mbanë shtetit vetëm disa dhjetra shkolla kanë sistem të arsimit të ndarë mes gjinive.

Prindërit që dëshirojnë që fëmijët e tyre të mësojnë në shkolla të pa përziera duhet ti dërgojnë fëmijët në shkolla private, kurse kjo u kushton shumë para.

Si duket kjo gjë është duke ndryshuar mbështetur në disa parashikime, të cilat vijjnë nga vendimi i qeverisë për përkrahje të arsimit të përgjithshëm të papërzier.

Përderisa kjo ide ka përkrahjen e politikave nga dy partitë politike dhe shumë përpiluesve të politikës amerikane, kundërshtohet nga disa organizata të grave dhe disa mësimdhënësve.

Teri Onil, nga organizata nacionale për gra thotë: "Kjo është shkelje e të drejtave të

grave...kjo do të shkakton që djemtë të arrijnë në arsimim më të mirë dhe më të shtrenjtë se sa vajzat".

Në të kaluarën shkollat shtetërore duheshte të marrin leje nga qeveria për ndarjen e meshkujve dhe femrave në shkolla. Kurse ky vendim i qeverisë së Bushit konsiderohet sinjal i mjaftueshëm për ndodhinë e ndryshimit të qartë në politikën e arsimit në Sh.B.A-të.

Arsimi i përzier është pika kryesore e arsimit shtetëror në Sh.B.A-të që nga koha kur ka filluar ky sistem i shkollimit, pasi që paraqytironin se ky sistem do ti garanton nivel më të lartë të arsimit të vajzave.

Duket se në mënyrë etapore shkenctarët dhe politikanët kanë arritur në rezultat se klasat shkollore të ndara për djemtë dhe vajzat mund të sjellin rezultate më të mira. Edhe pse këtë vit zgjedhor e kanë mbuluar çeshtjet politike, sërrish kjo ide ka arritur përkrahje nga dy partitë politike, përkrahje e cila përfshinë republikanët konservativ e deri te demokratë liberal, siç është edhe Hilary Clinton, anëtare e kongresit të Njujorkut.

Marrë nga: almokhtsar.com
almokhtsar.com,
9.4.2004

Mbulesa nëpër kohëra

Flokët e mendjelehtësisë.

Koha që mbahet mend, është periudha e filmave historikë rreth historisë së Britanisë, ku kur shihej në to një grua e mbuluar me shami ishte gjë mjaft normale. Nëse surfojmë në internet, mund të fillojmë të besojmë se shamia (mbulesa, velloja) fillon dhe përfundon me Islamin, ose se është një pjesë përbërëse e fustanit të martesës. Çështja e ndalesës për të mbajtur shami në Francë shërbeu vetëm për të treguar se sa shumë ajo është e bazuar në reagimin emocional, aq të thellë sa që ka një të kaluar në të. Një keqinterpretim tjetër është se shkaku që kryetari i Francës Jacques Chirac i ndaloi të gjitha simbolet religjioze, është se ai është një njeri i dëshpruar që përpiket të shtyp valën e pakontrolluar në rritje të anti-semitizmit në Francë. Hebrejtë lokalë të Lindjes së Mesme janë të njëjtës racë semite si ata që ndjehen superiorë ndaj palestinezëve (edhe muslimanë edhe krishterë)!. Si të tilla, sulmet në rritje kundër hebrejve anembanë Evropës, në Britani, Gjermani, Itali, Belgjikë, etj., janë të disjenuara të kthehen kundër muslimanëve. Kjo simbolizon se sa larg duhet të shkojë humaniteti para se të bëhet humane, ku burrat, gratë dhe fëmijët kanë dalë nëpër rrugë në shekullin XXI për të marshuar për të drejtat e tyre individuale.

E drejta për të votuar, dikur luftoi për të drejtat e gruas, që vetëm e burgosën gruan në robëri të bukurisë së trupit, kundër diktateve të Evropës krishtere që burgosi gruan përjetë ndaj lakmive të mendjes dhe trupit, kur Islami i ka dhënë gruas muslimane të drejtat e saja.

Ky rregull (diktat) rrjedh nga bibla krishtere, në 1 e Korintasve:

"Më imitoni mua, ashtu si unë jam imitues i Krishtit. Dhe unë po ju lavdëroj, vëllezër, që më kujtoni në të gjitha gjërat dhe i zbatoni porositë ashtu siç ua kam transmetuar. Por dua që të dini se kreu i çdo njeriu është Krishti, edhe kreu i gruas është burri; edhe kreu i Krishtit është Perëndia. Çdo burrë, kur lutet ose profetizon kokëmbuluar, turpëron kryet e tij. Edhe çdo grua, që lutet ose profetizon kokëzbuluar, turpëron kryet e saj, sepse është njëllor sikur të ishte e rruar. Sepse në qoftë se gruaja nuk mbulohet, le të ia presin flokët; por në qoftë se për gruan është turp të qethet a të rruhet, le të mbulojë kryet. Sepse burri nuk duhet të mbulojë kryet, sepse është shëmbëllimi dhe lavdia e Perëndisë, kurse gruaja është lavdia e burrit, sepse burri nuk është nga gruaja, por gruaja nga burri, edhe sepse burri nuk u krijua për gruan, por gruaja për burrin".

Një sqarim i mëtejshëm është dhënë në 1 e Timoteut 2:

"Për të cilin unë u vura predikues dhe apostull (them të vërtetën në Krisht, nuk gënjej), mësues i johebrejve në besim dhe në të vërtetë. Dua, pra, që burrat të luten në çdo vend, duke ngritur duar të pastra, pa mëri dhe pa grindje. Në mënyrë të njëjtë dua që edhe gratë, të vishen hijshëm, me cipë dhe modesti dhe jo me gërsheta a me ar, a me margaritarë, a me roba të shtrenjta, po me vepra të mira, si u ka hije grave që i kushtohen perëndishmëri. Gruaja le të mësojë në heshtje dhe me çdo nënshtrim. Nuk

e lejoj gruan që të mësojë, as të përdori pushtet mbi burrin, por të rrijë në heshtje”.

Kështu, në rregullat e hershme të krishterizimit është shkruar se gruaja duhet të mbulohet me shami. Jo shumë larg në të kaluarën, shamia është përdorë për ta shtypur gruan në krishterizëm. Teologu i parë Latin i shekullit II dhe III, Quinus Septimus Florens Tertullianus me entuziazëm ka shkruar për shaminë e gruas:

”Për atë praktikë që kundërshtojnë virgjinitet përdërisa i shfaq ato, asnjëherë nuk do të ishte miratuar pa asnjë përjashtim nga di-sa burra të cilët duhet të kenë qenë të ngjashëm në karakter me vetë virgjinitet. Sytë e tilla do të dëshironin që virgjinja të shihet si një virgjine e cila dëshiron të shihet ashtu. Të njëjtat sy në mënyrë reciproke janë përplot epsh për njëri-tjetrin. Të shikuarit dhe të qenurit, i takojnë epshit të njëjtë...”

Çështja që është lënë të zgjedhet, për secilën virgjine të mbulohet me shami, siç do të kishte zgjedhur, njëjtë sikur (ajo të kishte liri të barabartë)... Por kur fuqia e diskriminimit filloi të përparojë, leja e fituar për cilëndo modë ishte duke u bërë mjet, ku shenja e pjesës së mirë u paraqit; përnjëherë sfiduesi i madh i gjërave të mira dhe të shumë institucioneve të mira iu kthyen punës së tyre...

Çdo ekspozim publik i një virgjine të ndershme është (për të) një vuajtje nga përdhunimi; në të njëjtën kohë vuajtja nga përdhunimi është më pak e keqe, për shkak se vjen nga një mënyrë natyrore. Por kur vetë shpirti i një virgjineje dhuhet nga abstraktja e mbulimit të saj, ajo ka mësuar të humbë atë që ka mësuar ta mbajë...”

Këndvështrimi perëndimor patriarkal për gruan mund të përputhet me shkrimet e Tertullianusit:

“Nuk është e lejuar që gruaja të flet në kishë; por poashtu (nuk i lejohet asaj), të ligjerojë, as të baptizojë, e as të udhëheqë.

Kështu që na mbetet neve t’ju kthehemi (virgjineve), t’i përfshijmë ato të pranojnë këto (sugjerime) me sa më shumë vullnet... Por ne ju paralajmërojmë edhe juve poashtu, gra të (shkallës së) modestisë së dytë, të cilat keni ra në martesë, të mos ta rrisni disiplinën e vellos, madje edhe as për një moment të orës, për shkak se, ju nuk mund ta refuzoni atë, as të merrni mjete tjera për ta anuluar atë, duke shkuar as të mbuluara e as të zbuluara... Femrat e pakonvertuara (në besim në zotin e biblës) nga Arabia do të jenë gjykueset e juaja, të cilat nuk mbulojnë vetëm kokën, por edhe fytyrën, aq shumë sa që ato janë të kënaqura, me një sy të lirë, për t’ju gëzuar ose gjysmës së dritës, ose ta prostitutojnë tërë fytyrën. Një femër më mirë të sheh se sa të shihet”.

E mbështjellur në perceptcionin perëndimor të gruas si “Rënia e Havës”, që ka formuar normat shoqërore perëndimore nëpër shekuj. Dijetari krishter Leland Haines thotë: “Ishin vetëm të pasurit ata që kanë hulumtuar ndjenjën e tyre të seksualitetit jashtë rregullave shoqërore. Mos mbajtja e shamisë implikon liri nga nënshtrimi ndaj burrit (Haine fq. 3)

Epoka mesjetare.

Gratë e ndershme e kanë mbuluar kokën me shamia dhe vello, sidomos pasi kisha lëshoi një urdhër që gratë duhet të mbajnë flokët e tyre të mbuluara.

Frustrimi i shumë grave të Perëndimit ndaj gjinisë mund t’i atribuohet kishës, siç i kundërshtohet krishterizmit dhe këndvështrimit të përgjithshëm të gruas në shoqëri. Gjatë kësaj periudhe, gratë e ndershme, të vetmet ose të ndara nga burri kishin të drejtë të posedojnë pronë, një e drejtë që është humbur kur ato janë martuar. Gratë kanë mundur të bëjnë tregti, të ruajnë të holla dhe ishin përgjegjëse para ligjit deri atëherë. Nën “Ligjin Salik” francez në shekullin VI

dhe VII, gratë kanë mundur të trashëgojnë tokë, përderisa nuk ka pasur ndonjë të afërm burrë. Kjo ishte një kombinim i teologjive të Aristotelit dhe Augustinit që ka kulminuar në ato të Toma Akuinit, kreut të kishës Angleze, që fuqishëm kanë vendosur në këtë periudhë besimin se roli i gruas ka qenë vetëm për martesë, lindje dhe rritje të fëmijëve. Çdo ndjekje intelektuale ishte privilegj i burrave. Gratë kanë qenë inferiore dhe shkak i të këqijave. Kjo rriti rrjedhën e grave që të bëhen murgësia, ku ato do të kishin njëfarë shkalle të kontrollit mbi jetën e tyre. (usm, fq.1,2).

Periudha Elizabetiane

Shamia (rrjetë) që u paraqit gjatë periudhës Tudoriane, u bë një mllaf për udhëheqësen e veshjes ditore, Mbretëreshën Elizabetë. Të mbledhura ose të lëshuara, shamitë i kanë mbajtur flokët të mbledhura dhe të pastra. Ato edhe sot janë mjaft të famshme.

Periudha Viktoriane

Shpesh e konsideruar si periudha më shtypëse ndaj gruas në historinë Perëndimore, periudha e shekullit XIX ishte periudha kur flokët filluan të mbahen të lëshuara pas shpine, me nyje, bisht, kurdela dhe të gjitha stilet e 'qendisjes' së flokëve. Revolucioni bujqësor ofroi më shumë ushqim se sa më herët, ndërsa revolucioni industrial ofroi punësime të reja, qytete të reja, shoqëri të reja, si dhe komoditete të shumta. Prezentimi i fustanit martesor nga Mbretëresha Viktoria i dha një jetë të re vellos. Ajo vendosi një trend që është bërë ëndërr për shumë vajza.

Shekulli XIX

Me renovime të mëdha që ndodhnin në Paris, mjekët fuqishëm rekomandonin që gratë të mbajnë kapela-shami për ta mbrojtur veten nga pluhuri dhe nga sëmundjet (infektimet) nga ajri. Në fjalë, ishte aq moderne sa që gratë e shihnin vellon si një simbol i klasit të lartë dhe respektit. Histori-

ani i artit Dr Marni Kessler, si mashkull, mbante këndvështrime kundërshtuese për këtë çështje, por ka theksuar se velloja ofronte një barrierë ndërmjet gruas dhe qytetit. "Ajo nuk ishte e verbuar nga velloja, por ajo e mbante atë mbrapa, e mbronte dhe e ruante atë nga jeta moderne". (Barker, fq.1).

Për këtë shkak, gratë vareshin nga burrat, si dhe nga pronat e burrit, pa të drejta të pronës së saj, siç është e bashkangjitur në mësimet krishtere.

A është kjo e ngjitur dikund në memorien e tyre çdoherë që ata e shohin ndonjë grua muslimane? A nuk mund të shihet se, ndryshe nga mësimet krishtere, shamia në Islam nuk është rreth nënshtimit ndaj burrit, por rreth mos-nënshtimit ndaj trupit. A nuk mund të shihet se të drejtat e gruas në Islam janë të shkruara në Islam dhe nuk janë të ndikuara nga askund?

Gratë e Perëndimit ishin të shmangura nga çdo lloj i të drejtës deri në shekullin XIX. Ajo e kaluar ishte duke u thyer me përparimin e industrializimit, që respekton vetëm profitet, e jo të drejtat. Nëpërmjet automjetit të lëvizjes për fitimin e të drejtave të gruas, gratë u liruan nga një formë e robërisë dhe hynë në një robëri të trupit. Duke besuar se janë të lira, gratë Perëndimore nuk ishin të varura më nga burri. Ndryshimet e shpejta, për disa ishin shumë. U paraqit kisha e lirë, një pjesë e të cilës është grupi krishter Amishët, që e ndanë veten nga bota të cilën nuk e pranonin dhe pasuan rregullat e ashpra kundër involvimit ushtarak; madje anëtarët më të vjetër janë edhe kundër përdorimit të rrymës elektrike. Shamia ishte pjesë e veshjes së përditshme të gruas së Amishit (Headcoverings, fq.1) dhe disa komunitete edhe më tej i mbahen atyre traditave.

Dehumanizimi: Çoroditja pas flokëve

Për shumë gra sot, flokët janë bërë shu-

më të rëndësishme; esenca e feminitetit është shoqëruar me flokët. Por, në Perëndim, deri në shekullin XX rregullimi i flokëve ishte i kufizuar vetëm për përkatësit (përkateset) e klasit të lartë. Asnjëherë nuk mendojmë se sa shumë i ndotim (helmojmë) flokët tona me kimikaliat e shumta që gjenden në shamponat dhe zbutësit modernë. Në përgjithësi, në çfarëdo tradite qoftë, flokët rregullohen dhe stilizohen së bashku me rrojen, prerjen dhe mbështjelljen – me përjashtim të atyre ku çdo lëvizje (strategji) ishte përdorë për të tërhequr mashkullin, për shkak se flokët e gjata provokojnë më shumë. Ndryshe, lëshimi i flokëve pas shpine konsideroheshin si jo-higjienike dhe jo-praktike.

Për të treguar se sa të preokupuar jemi bërë, tregon një anketë nga Yankelovich Partners e zhvilluar në vitin 2001, që tregon se 69 për qind të amerikanëve kanë thënë se veshja, flokët dhe makiazihi ishin faktorët më të rëndësishëm dhe vendimtar për të vendosur nëse personi do të pranohet në punë, 67 për qind kanë thënë se paraqitja e një personi ndikon nëse ai do të fiton ndonjë sfida të re, përgjegjësi apo gjasë. A mund të besoni se 78 për qind e amerikanëve thonë se veshja, flokët dhe makiazihi ndikojnë në aftësinë e personit për ta kryer punën? Sidoqoftë, nuk duhet të harrojmë se ata ishin sponsoruar nga Asociacioni Kozmetik, Tualetik dhe Parfemik (amerikan) për të zhvilluar anketën! (womenwork.org, fq.1).

Ata që marrin rastet për të sulmuar Islamin nëpërmjet çështjes se gruaja, ose përdorin gruan muslimane për të shkarkuar atë që edhe më tej gjendet e ngjitur në psikën e tyre nga e kaluara e shtypjes, e kanë shoqëruar shaminë Islame si një mjet i shovinizmit mashkullor nën pretekst të "Fundamentalizmit Islamik". Mirëpo, ata nuk kanë ndonjë alternativë praktike për ta vendosur në vend të saj! Ata përdorin lojën e vjetër të "etiketi-

mit" në kishë. "Teknika e etiketimit përdoret për të diskredituar një person që kundërshton besimet e një personi religjioz. Etiketi mi përpiqet të dehumanizon personat, në mënyrë që kundërshtimi i tyre dhe i opinioneve të tyre të jetë më i lehtë. Duke zgjedhur që të mos i drejtohet ndonjë personi që ka dyshim në fenë toksike në mënyrë individuale, personi religjioz vendos një etiketë të zbrazët negative në të gjithë ata që nuk pajtohen me shprehitë personale të tij ose të saj. Në vend se të thuhet se personi ka bërë një gjë negative ose ka një qëndrim negativ, personi religjioz thotë se ekzistojnë "armiqt", "tradhëtarët" ose "keqbërës" që do ta shkatërrojnë organizatën. Etiketi mi bëhet një pikë mbledhjeje nën të cilën pasuesit tjerë mund të veprojnë për të heshtur revolten!" (spiritualbase, fq.1). Për këtë shkak, si të tilla, ankesat e mbledhjeve janë bërë dhe ne ngrisim zërat tonë, pyetja është jo nëse, por kur do të arrihet sukcesi të mposhtet gruaja muslimane? Në fund të fundit, ideja (plani) është që të bëhet gruaja muslimane të ndjehet si e prapambetur, dhe kështu ta bëjnë atë të reagojë emocionalisht rreth asaj që po ndodh dhe pa vetëdije të humbë të gjithë atë që përkrah bazat dhe mirëqenien e shoqërisë muslimane-familjen. Tregimi i Rapunzelit ishte tërheqës vetëm për disa, për shkak të gjatësisë së flokëve, nëpërmjet të cilave kalorësi në veshje të ndritshme është ngjitur drejt zemrës së saj. Njerëzit janë bërë të ndjehen inferiorë për shkak të flokëve:

"Ne edhe më tej jemi të robëruar në mendimet tona.

Shoqëria na ka formuar në të folurit.

Kam problem me fjalën shkumë, për shkak se ajo nuk shoqërohet me identitetin tonë të vërtetë si të lumtur.

Pse duhet të kem kimikali në flokë?

Nuk dua të pajtohem me asnjë standard të tyre.

Ata janë ata që imponojnë ndjenjat e tyre të shtypura tek të rinjët e pashtypur.

Të cilët janë duke mësuar të dojnë vetveten brenda dhe jashtë.

Të rinjë të cilët vetëm dëshirojnë të përputhen në kompletin e standardeve të bukurisë, pa dyshim.

Ne si njerëz duhet të bashkohemi në këtë.

Shumica janë duke jetuar në lumturi për shkak se injoranca është kënaqësi.

Ata nuk e dinë se nëse thuhet "flokë të mira" është degraduese si përdorimi i shkronjës N, si një term i kënaqësisë.

Duke ndryshuar mendimet tona, ne jo vetëm që mund të dalim nga errësira mentalisht, por mund të dalim nga represioni!" (nappyhair.com)

Shumica distancohen nga të tjerët për shkak të humbjes së flokëve gjatë sëmundjeve. Një adoleshente ka shkruar:

Flokët e saja. Flokët e saja ishin si një oqean me rrudha dhe rrudha dhe valë. Kish-te vija të kuqe, në flokët e gjata të saja ngjyrë kafe; sytë e saj ishin smaragd, lëkura e saj bronzë ari. Ajo është shoqja ime më e mirë. Do të bëja çmos t'i kem flokët e saja – mënyra se si lëshohen në shpinën e saj, si një kornizë prej ari në një fotografi të bukur. Ç'ka është hemo (terapia)?" pyeta, përdërisa nëna më tërhoqi anash. Shpresoj se ajo nuk do të vdesë. Shpresoj se ajo sërish mund t'i ketë flokët e saja. Por; ajo nuk mund, ato i ranë. Ajo e kishtë sëmundjen e Hodgkinsit dhe ajo i humbi flokët e saja. E shihja atë të shtrirë në spital me disa gypa të dhimbshme të ngjitura në gjoksin e saj, me disa maqina ngjyrë hiri të ngjitura për të – pa flokë. Ishte rëndë të shihet. Të shihet ajo duke vuajtur aq keq, më bëri edhe mua të vuaj, më lëndoi, kështu që i preva flokët. Nga Ashley Nestor, New City, NY" (Ashley, teenink.com).

Çmimi i lartë i sekspluatimit

Jemi në refuzim, mendoj, deri në atë shkallë që floku ka ndikim vendimtar në atë se kush jemi, jo për shkak të asaj se çka bën floku aktualisht, por për disa domethënie më të thella. Ajo ka një ndikim alogjik në qeniet njerëzore që mund ta bëjë dikë të dojë, urrejë, pëlqejë ose refuzojë dhe pa asnjë shkak. Çdo karakteristikë fizike në trupin e gruas duhet të ketë një apel vizuel që disa gra jo-perëndimore përpiqen të imitojnë. Ai apel vizuel është paketuar si seks; seksi si komoditet. Gratë e bukura janë bërë vizuelisht të afta për të shitur të pashturën. Sekspluatimi i fton burrat të posedojnë me sytë e tyre atë që ata nuk mund ta posedojnë me duar, duke luajtur me ndjenjat e burrave, duke i ngritur ndjenjat e tyre deri në atë shkallë që shumica e kanë vështirë të mos marrin atë në të cilën janë "ftuar" ta marrin. Iluzioni i të drejtave të grave në përndim është zhvilluar në dëm të të drejtave të burrit, që vetëm ka shërbyer në robërimin e të dyja gjinive në të drejtën e pakontestueshme "për të poseduar".

Forma tjetër e saj është "konsumatorizmi" – konsumatorizmi i njëjtë që është edhe çerdhe e industrializimit perëndimor, kolonializmit dhe globalizimit; dhe që ka çuar deri te të gjitha format e dhunës që paraqiten në shoqërinë civile.

Organizata RAINN që ofron ndihmë telefonike (hotline) për Keqtrajtme Seksuale në shtetet amerikane jep këto të dhëna: Çdo dy minuta, diku në Amerikë, dikush seksualisht keqtrajtohet". Në vitin 2002 ka pasur 247.370 viktima të përdhunimit, 44.000 e të cilave ishin të moshës nën 18-vjeçare. 93 për qind e viktimave adoleshente të keqtrajtmeve seksuale i njihnin sulmuesit e tyre, 34 për qind ishin anëtarë të familjes dhe vetëm 7 për qind të sulmuesve ishin të huaj (rain.org, fq. 1, 2) Kjo shërben vetëm për të treguar se sa është ndryshkur madje edhe koncepti individual i familjes.

Shpërbërja e një miti

Kur gratë zgjedhën të neglizhojnë të drejtat e tyre, të pranuar nga Islami, ato poashtu u bënë neglizhente edhe ndaj pasojave të mundshme, jo vetëm për vetveten, por poashtu edhe për familjet e tyre, dhe shoqërisë si tërësi. Shamia është mbrojtës i atyre të drejtave, që shumë pak (gra) jo-perëndimore kanë filluar të zgjohen. Për transferimin e perceptcionit të zakonshëm perëndimor të gruas muslimane me shami (të mbuluar), që ishte formuar nga e kaluara e tyre, Mary Walker, koordinatorë e produksionit për serialin “Living in Islam” (Jeta në Islam) në televizionin BBC2, për revistën Impact ka thënë: “Për mua mbulesa ka simbolizuar shtypje të gruas, duke i bërë ato të padukshme, anonime dhe të pazëshme, dhe shkak i kësaj shtypje qëndronte në vullnetin për të ndikuar në familjen dhe për të mbajtur një kornizë patriarkale – bazë e shoqërisë Islame. Mendoja se gratë ishin tërësisht të shtypura nga arsytimi Hyjnor i rolit të tyre si grua, nënë... “Jeta në Islam” është gjiruar gjatë dy vjetëve në 19 shtete të ndryshme, dhe në terren unë isha gruaja e vetme në një ekip përplot meshkuj... Gruan e parë muslimane që e njoftova në Mali ishte shumë larg nga parakonceptimi im i gruas muslimane. Ajo ishte grua e një sheikut të dedikuar konvertimit të fshatarëve të paganë, në Islam. Një grua e sofistikuar, e edukuar dhe e arsimuar, paraprakisht e martuar për një diplomat, ajo kishte hequr dorë nga jeta e stilit perëndimor për një jetë në vetmi... ”

Gruaja e emancipuar në perëndim ballafaqohet me konfliktin ndërmjet konfirmimit të feminitetit të saj dhe privilegjeve që ajo i sjell,

dhe refuzimit të kufijve të rolit të saj femëror dhe të gjitha kufizimeve të tjera që burri dëshiron ajo ti merr. Nga vendi ku qëndroja, kjo grua i kishte transformuar këto kufizime në privilegje... Në udhëtimin e ardhshëm në Nigerinë veriore, njoftova edhe dy gra, të cilat do të mi ndryshonin këndvështrimet e mia edhe më tej... Sërish, ata kishin refuzuar jetën e stilit perëndimor, të cilat unë i konsideroja aq superiore ndaj Islamit në trajtimin ndaj gruas... Gratë flisnin, dhe në përgjigjet e tyre, pash fillimin e ri-vlerësimit tim personal. Ata argumentuan se mbulesa sinjalizonte një refuzim të një sistemi të papranueshëm të vlerave që poshtëronin gruan, ndërsa Islami ngrit gruan në një shkallë të nderit dhe respektit. ‘Nuk është liri ku mund të thuash se gratë mund të shkojnë lakuriqë’. Njëjtë si mbulesa që na simbolizon neve shypjen muslimane, për ato fundet e shkurta dhe gjokset e hapura përfaqësojnë shtypje. Thonë se në perëndim burrat i tradhëtojnë gratë. Ata na lënë të besojmë se jemi të lira, të çliuruara, por në të vërtetë na robërojnë në vështrimet e burrave...”.

Flokët e mendjelehtësisë ranë me një vullëzim tërheqës,

Për të shkëlqyer trupin e saj në diellin e ndritshëm.

Ato flokë nuk tërheqin vetëm syrin e tij, por edhe ndjenjat dhe nuk mund,

Nuk do të, ngritet mbi atë ëndërr,

Imagjinata e tij zgjeroni pasione brenda, nga të cilat nuk brengoseshte,

Sepse gjith atë që e pa në atë moment

Ishte nevoja për të plotësuar atë se çka qëndronte brenda asaj që e pa –

Kush ishte ajo

Nuk ishte me rëndësi, e as nderi i saj.

Hwaa Irfan

IslamOnline

Përktheu: xh.a.

2.4.2004

Përhapja e kulturës së çiltërisë

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin melekët e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar". (Et-Tahrim: 6).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"All-llahu do të mer në pyetje secilin bari për tufën e tij, është kujdesur për ta ose i ka humbur, gjersa do ta pyet edhe burrin për familjen e tij". (Sahih, Ibën Hibbani).

Familja muslimane është çelësi i fitoreve dhe dështimeve, ashtu që me ndryshimin e familjes ndryshohet edhe bota.

Veçori më e madhe me të cilën dallohet islami, prej ligjeve tjera është qartësia dhe çiltëria, pasi që në islam nuk ka asgjë të paqartë, në islam nuk ka informata që janë të ndaluara për disa njerëz e për tjerët të lejuara. Në islam nuk ka mjegullira, por cilësi e përhershme dhe e pandarë e islamit është qartësia e shikimit në çdo gjë. Muslimani është i qartë në të gjitha raportet, raporti i tij me Zotin është raport adhurimi, raporti i tij me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është raport dashurie dhe pasimi, raporti i tij me muslimanët është raport vëllezërie, raporti i tij me familjen është raport kujdesi, furnizimi dhe mbikëqyrjeje, raporti i tij me ithtarët e Librit poashtu është raport i qartë. . . .

Nuk ka gjë më të qartë se ajeti Kur'anor:

"O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në

tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (risalen)". (El-Maide: 67).

Dijetarët me këtë ajet kanë argumentuar se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka komunikuar tërë fenë që i është shpallur.

Pasi që qartësia është cilësi e pandarë dhe e përhershme e Islamit, ajo duhet të jetë edhe cilësi e pandarë e familjes, e cila paraqet bërthamën e shoqërisë muslimane. . . .

Shumë njerëz jetën e tyre e ndërtojnë mbi një paqartësi, befasohet gruaja ose burri prej shumë gjërave që nuk i kanë llogaritur, e më pastaj vijojnë problemet.

Kur'ani na ka dhënë shembull shumë të lartë në çiltërsi. Mundet që kalojmë këtë shembull të shkëlqyeshëm shumë herë në Kur'an, mirëpo nuk ndalemi të mendojmë rreth aludimeve të tija dhe rreth rëndësisë së tij. . . . ky rast është tregimi i Musait, alejhisselam, me njëren nga vajzat e burrit të mirë, kur ajo tha:

"Njëra prej atyre dyjave tha: "O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besniku!" (El-Kasas: 26).

Kurse përgjigja e babit të saj ishte:

"Ai tha: Unë dëshiroj të martoj ty me njëren prej këtyre dy vajzave të mia, . . .". (El-Kasas: 27).

Ky rast është shembull i qartë i qartësisë dhe çiltërisë. Vajza nuk fshehu pëlqimin e saj për Musain, alejhisselam, kurse prindi kuptoi nga kjo çiltërsi se vajza e tij pëlqeu besnikërinë dhe fuqinë e tij. Pra, çiltëria nuk ishte problem për asnjëren anë, përderisa

është e rregulluar me rregullat e përgjithshme të islamit. Ky rast paraqet gradën më të lartë të çiltërisë, kurse kur Kur'ani prezanton rastin me gradën më të lartë të çiltërisë, kjo domethënë se gradat më të ulta as nuk duhet të bisedohen, mirëpo fatkeqësisht muslimanët janë larguar nga kjo rrugë.

Muslimanët nuk janë të qartë dhe të çiltër edhe në gjëra shumë më të vogla se këto në shtëpitë e tyre, andaj shumë herë ndodh se miku i djalit tim di më shumë për djalin tim se unë, dhe shoqeja e vajzës time di më shumë për vajzën time se unë, dhe shoqeja e gruas time di ma shumë për gruan time se unë...!

Hapi i parë në çiltërsi bëhet nga prindi e jo nga fëmiju, sepse djali dhe vajza nuk munden të jenë të çiltër me prindërit në fillim, andaj hapin e parë duhet ta bëjnë prindërit në shtëpi, derisa të adaptohen fëmijët në çiltërsi.

Koha i nxori në shesh këto gabime të mëdha shoqërore në jetën tonë si rezultat i mosqartësisë dhe çiltërisë në shtëpitë tona, andaj edhe dolën në shesh këto fatkeqësi që i shohim... me të vërtetë çiltëria në shtëpi ka disa dobi, prej tyre:

1- Guxim dhe aftësi për dialog. Sa të rinjë janë ritur dhe kanë hyrë në rradhët e burrave mirëpo nuk kanë mundësi të thonë asgjë, e as që dinë të thonë gjë. Andaj çiltëria e bën të riun të anon kah guximi dhe ta mbron idenë dhe atë që dëshiron.

2- Aftësi për të dalluar gabimin nga e sakta. Çiltëria shkakton që çeshtjet të hedhen në analizë, e kjo shkakton të dallohet gabimi nga e sakta.

3- Shtimi i besimit mes prindërve dhe fëmijëve.

4- Shtimi i lidhshmërisë familjare.

Abdul-Latif Birxhavi
Përktheu: Bekir Halimi
26.3.2004



Imam Muhammedi

Imam Muhammed ibën Hasen Esh Shejbani (132-189 H /748-804 G)

Një ndër dijetarët më meritorë në shkollën hanefite është edhe Muhammed ibën Hasen ibën Ferkad Esh Shejbaniu. Babai i tij ishte ushtarak. U lind në vitin 132 H/748 G në Vasit, edhe pse me prejardhje rrjedh prej një fshati në periferi të Damaskut, i quajtur Hursta. Një kohë e kaloi në Kufe ku i mori mësimet e para mbi shkencën, e pastaj u shpërngul në Bagdad. I ndoqi ligjëratat e Ebu Hanifes i cili ndërroi jetë kur Muhammedi kishte 18 vjet. Mësimin e vazhdoi te Ebu Jusufi. Po ashtu ka mësuar edhe nga Sufjan Eth Thevriu, Mu'ammer ibën Kidami, Malik ibën Mes'udi, Omer ibën Dherri dhe El Evzaiu. Gjatë qëndrimit të tij trevjeçar në Medine u njoh me fikhun dhe pikëpamjet e Malik ibën Enesit dhe të shkollës së tij.

Është marrë me studime letrare e gjuhësore: me poezi, me gjuhë, sintaksë, kurse nga lëndët fetare: me Kur'an, Hadith, fikh etj. Kjo i ndihmoi ta zgjerojë dhe thellojë diturinë e vet.

Rrëfëhet se ka qenë në gjendje të mirë materiale. Për mësimin e sintaksës, poezisë, hadithit dhe fikhut pagoi 30.000 dirhemë. Teksohet se materialisht e ka ndihmuar edhe Ebu Jusufin (nxënësin tjetër të Ebu Hanifës).

Biografët shënojnë se prej tij mësuan: Imam Shafi'iu, Ebu Sulejman El Xhurxhani, Hisham ibën Abdull-Ilah Er Rraziu, Jahja ibën Me'ini, Ahmed ibën Hafsi, Ahmed ibën Hanbeli.

Për shkak të autoritetit të lartë në shkencë, halifi abasit Harun Er Rashidi e emëroi kadi suprem në provincën Rikka, por së shpejti e braktisi këtë shërbim duke u frikësuar nga

mundësia e të bërit padrejtësi. Ishte trim para halifit dhe ia thoshte në fytyrë gabimet.

Pamja e tij e jashtme dhe virtytet:

Thuhet se Imam Muhammedi ka qenë i passhëm, i veshur mirë, elokuent, ekspert i fikhut.

Shafi'iu thotë: "Muhammed ibën Hasani ka qenë i bukur për sy dhe i dashur për zemër".

Qysh si i ri krijoi emër, kështu që në moshën më të re Ismail ibën Hamdiu për të thotë: "Imam Muhammedi ishte 20 vjeçar dhe kishte vendin në xhaminë e Kufes ku ai mbante ligjëratat".

Kurse Ebu Ubejdi thotë: "Nuk kam parë njeri që e kupton Kur'anin si Imam Muhammedi."

Nga veprat e tij që konsiderohen si burime për njohjen e interpretimeve juridike të medh'hebit hanefij do t'i përmendim:

- El Mabsut
- El Xhami'ul Kebir
- El Xhami'us Sagir
- Es Sijerul Kebir
- Es Sijerus Sagir
- Ez Zijadat

Në fillim të shekullit IV hixhri, këto gjashtë libra, Ebul Fadl El Mirvezi i përmbledhi në një libër me titullin El Kafi.

- El Ihtixhaxh ala Malik
- Esh Shurut
- El Iktisab fi Er Rizki El Mustetab

Vdiq në moshën 58 vjeçare në vitin 189 H/804 G, gjatë një shëtitjeje me Harun Er Rashidin në qytetin Rej. Po atë ditë vdiq edhe Imam Kisaiu (një kolos i dijeve gjuhësore arabe), e Haruni i prekur me këtë që ndodhi tha: "Sot u varrosën së bashku fikhun dhe gjuha".

Përktheu: Talha Kurtishi

16.4.2004

El-Begavi

Husejn ibën Mes'ud ibën Muhammed El Ferra El Begavi.

Ka lindur në vitin 436 H në krahinën e Horesanit në vendin e njohur me emrin El Bega. Kërkoj diturinë nga shumë mësues nga mesi i të cilëve do t'i veçojmë: Ebu Umer El Melihi, Ebul Hasen Esh Shejrizi, Ed Duvejni, Ahmed ibën Ebu Nasr El Kufani dhe të tjerë.

Nga nxënësit më të dalluar të tij janë: Ebu Mensur Muhammed ibën Es'ad El Attari, Ebul Futuh Muhammed ibën Muhammed Et Tajj dhe të tjerë.

Beagavi si dijetar:

El Begavi ishte njeri i dalluar me diturinë e tij dhe njëri nga njerëzit më të ditur të kohës së tij. Ka treguar sukses në shumë lëmi shkencore. Ka qenë hafëz i Kur'anit dhe i ka njohur mirë mënyrat e leximit të tij. Është autor i tefsirit të njohur me emrin «Tefsir El Begavi» në tetë vëllime. Ka patur edhe dituri të thellë në lëminë e fikhut, gjë kjo për të cilën dëshmojnë edhe veprat e tija nga kjo lëmi.

Ka qenë i dalluar edhe në shkencën e hadithit dhe me të drejtë e fitoi titullin (Muhjissunneh) ai që ngjallë sunetin. Nga virtytet e tij do t'i përmendim: modestinë, asketizmin, devotshmërinë dhe përpikshmërinë në punë. Për modestinë e tij flet fakti se një kohë të gjatë është ushqyer me bukë të thatë, mbante rroba të vrazhda, dhe nuk dallohej me veshje nga njerëzit e thjeshtë. Thirrte në Kur'an dhe Sunnet edhe pse u rrit dhe u

edukua në një rreth ku vendin më të lartë e kishte medh'hebi shafi'ij. Për të dijetar i vërtetë është ai që parimisht i mbështetet Ku'ranit dhe Sunnetit duke mos u përkufizuar me një medh'heb. Nga dijetarët e vërtetë kërkonte që vazhdimisht të zgjerojnë dituritë e tyre.

Veprat e tij ishin të mirëpritura tek dijetarët të cilët përfitonin nga ato.

Përpos tefsirit veprat e tij më të njohura janë:

1. Sherhu Sunne: vepër voluminoze e hadithit e botuan në 14 vëllime. Në të përpos haditheve ka tubuar transmetimet nga as'habët dhe tabi'inët.

2. Mesabihus Sunne: në këtë vepër ai i ka tubuar hadithet të cilët dijetarët e mëparshëm i kanë transmetuar pa sened. Hadithet të cilët i kanë transmetuar Buhariu dhe Muslimi i ka klasifikuar si të saktë kurse hadithet të cilat i kanë transmetuar autorët e suneneve i ka klasifikuar si hasen.

3. El Xhem`u Bejne-Sahihajn: në këtë vepër ka tubuar hadithet e transmetuara nga Buhariu dhe Muslim duke u përqëndruar te hadithet për të cilët janë pajtuar dy Imamët.

4. Et Tehdhiib: vepër nga lëmia e fikhut. Në këtë libër është mbështetur Neveviu gjatë shkruarjes së librit të tij Reudatu Talibin.

5. El Erbe`une hadithen: në të cilin ka tubuar dyzet hadithe.

Jeta e tij në këtë botë përfundoi në vitin 516 H.

All-lahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjërë.

Talha Kurtishi
9.4.2004

Imam Taberani

Imam Ebul Kasim et Taberani, njëri prej ekspertëve të hadithit dhe shkencave të tij, autori i veprave të shumta në lëminë e tij të preferuar ate të hadithit. Në tre librat e tij (El Mu'xhem Es Sagir, El Evsat dhe El Kebir) ka tubuar afro njëqind mijë hadithe të Resullullahit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Quket Ebul Kasim, Sulejman ibën Ahmed ibën Ejjub ibën Mutajr, El Lahmi, Esh Shami, Et Taberani. Në literaturën përkatëse është i njohur me emrin Et Taberani. Familja e tij ka prejardhje prej Jemenit e cila më vonë është shpërngulur në Palestinë që në atë kohë ishte pjesë e territorit më të gjërë i njohur me emrin Sham. Disa historian si Ibën Xheuziu thojnë se familja e tij ka banuar fshatin El Lehm në Jemen që më vonë të transferohen në qytetin Bejt Lehm (Betlehem), në qytetin në të cilin ka lindur 'Isa, alejhi selam.

Në vitin 260 H/873 G në qytetin Akka në Palestinë lindi Imam Et Taberani. Imam Et Taberani shumë herët filloi kërkimin e diturisë. Shumë burime pohojnë se viti 273 H/886 g si viti prej të cilit Et Taberani plotësisht i është përkushtuar kërkimit të diturisë.

Në këtë vit ai vizitoi Kudsën që më vonë të viziton edhe qendrat e tjera të diturisë sikur El Kajserije, Hims, Hixhaz, Jemen, Bagdad, Kufe, Basra dhe Asbehan (Isfahani). Qytetin e fundit do ta zgjedhë si vendbanim dhe në të do të qëndron 60 vjet, gjatë të cilëve do të përhap shumë dituri dhe do të shkruan vepra të shumta kapitale.

Imam Dhehebiu tregon se udhëtimi i tij në kërkim të diturisë ka zgjatur 16 vjet. Pas kësaj periudhe ai bëhet burim i pashmangshëm i diturisë dhe autoritet tek i cili mbështeteshin shumë dijetarë.

Rezultat i këtyre udhëtimeve ishin hadithet e shumta të cilat i tuboi. Kur me një rast është pyetur si ka arritur të mëson aq shumë hadithe, ai është përgjigjur: "Në hasër kam fjetur tridhjetë vite me rradhë."

Numri i mësuesve prej të cilëve ka përfituar kalon njëmijshin dhe ne do të përmendim vetëm një numër të vogël prej tyre:

Ebu Zur'a Er Razi, Idris ibën Xha'fer El Attar, Ali ibën Abdul Aziz El Begavi, Mikdam ibën Davud Er Ru'jani, Ahmed ibën Abdul Vehhab El Havti, Ahmed El Busri, Ahmed El Halebi, Bekr ibën Sehl Ed Dimjati, Abdur Rahim ibën Abdull-llah El Berki, Uthman ibën Umer Ed Dabbi, Ebu Abdur Rahman En Nesai, Ahmed ibën Abdull-llah El Lihjani, Hashim ibën Merthed Et Taberani dhe tjerë.

Kur u përhap lajmi i diturisë që e kishte fituar tek ai filluan të vijnë kërkuesit e dijës prej gjitha vendeve. Ndikimin më të madhë e kishte mbi të diturit e qytetit Asbehan, qytet në të cilin qëndroi kohën më të gjatë të jetës së tij.

Njëri prej nxënësve të tij Ebu Ahmed El as-sal El Kadi thotë: duke u shoqëruar me Et Taberaniun prej tij shënova 20 000 hadithe, Ebu Is'haki ibën Hamza 30 000 kurse Ebu Shejhi 40 000 hadithe. Ibën Haxheri në librin e tij Lisanul Mizan transmeton fjalën e Ahmed ibëne Mensur Esh Shirazi i cili thotë: Prej Taberaniut kamë shënuar 300 000 hadithe. Nga mesi i nxënësve të tij më të dalluarit ishin:

Ebu Abdull-llah ibën Mende, Muhammed ibën Is'hak (dijetar i njohur i Egjiptit), Ibën Ukde Ahmed ibën Muhammed El Kufi (hafidhi i njohur për precizitet), Ebu Halifa El Fadl ibën Habbab El Xhumehi, Ebu Bekr ibën Merdevejh (autori i librave në lëmitë e tefsirit dhe historisë), Ebu Nu'ajm El Asbehani (autori i librit të njohur Hiljetul Evlija), Ebu

Bekr Esh Shirazi, Ebu Umer Muhammed ibën Husejn El Bistami, Ebul Fadl Muhammed ibën Ahmed El Xharudi, Ahmed El Ezdi dhe të tjerë.

Dijetarët për Imam Et Taberaniun:

Vlerat e tij njerëzore, respekti që e gëzonte dhe përpikshmëria shkencore e kombinuar me fuqinë e kujtesës e bënë të respektuar në mesin e dijetarëve dhe njerëzve të thjeshtë.

Ahmed ibën Mensuri thotë: Prej Imam Et Taberaniut kam shënuar 300 000 hadithe. Ishte dijetar i besueshëm.

Ebu Bekr ibën Ebi Ali thotë: Ishte dijetarë me dijë të gjërë, ka shkruar shumë vepra.

Ebu Xha'fer Es Sirri rrëfen rastin e udhëtimit në Kufe për të fituar prej muhaddithit të saj Ibën Ukde. Kur është takuar me ta, ai e ka pyetur: Nga po vjen? Ebu Xha'feri është përgjigjur së vjen prej Asbehanit. Ibën Ukdeja e pyeti: A ke dëgjuar prej Taberaniut. Kur Ebu Xha'feri tha se nuk e njeh, ibën Ukdeja i befasuar tha: Subhanall-llah, po jeton në qytetin e Ebul Kasim Et Taberaniut, nuk ke dëgjuar për të dhe ke ardhur tek unë në Kufe?! Unë nuk kam parë dijetar që i përngjan Et Taberaniut.

Imam Dhehebiu kështu e përshkruan: Imam dhe hafidh i haditheve, besnik, njeriu që palodhshëm udhëtonte në kërkim të hadithit, muhaddithi i islamit, dijetar me inteligjencë të dalluar i cili i njihnte mirë mangësitë e haditheve të dobëta dhe transmetuesit e tyre, dijetar i cili shkruajti shumë për islamin në përgjithësi dhe për hadithin në veçanti.

Ed Davudi: Et Taberaniu është imam dhe autoritet i pamohueshëm... kalorësi i shkencës së hadithit, i sinqerti dhe besniku.

Me qëndrimet e tij dhe mënyrën e mrekullueshme të debatimit arriti ti mahnitë njerëzit që mendonin se në dunja nuk ka kënaqësi më të madhe se pasuria dhe pushteti, siç është rasti me Ibën El Amidin. Kur ky i fundit pasi që dëgjoji debatimin e Taberaniut me Ebu Bekr El Xhe'alibi harroi bukuritë dhe kë-

naqësitë e pushtetit i mahnitur nga bukuria e citimit të hadithëve, fuqia e kujtesës që e veçonin Et Taberaniun.

Veprat e tij:

Nga veprimtaria e tij që e shkroi dhe tuboi gjatë jetës së tij do të përmendim:

El Mu'xhem El Kebir (një prej librave bazë të hadithit) në të cilin ka shënuar mbi 20 000 hadithe

El Mu'xhem El Evsat

El Mu'xhem Es Sagir

Kitabud Du'a

Mekarimul Ahlak

Delailun Nubuvve

Kitabul Evail

Fadlu Remji ve Ta'limuhu

En Nevadir

Kitabus Sunne

Kitabut Tefsir

Kitabul Menasik

Ma'rifetu Sahabe

Musned Aishe

Musned Ebu Hurejre

Musned Shu'be

Musned Sufjan

Musnedu Shamijjin

El Ilm

Er Ru'je

Fadlul Arab

El Xhud dhe tjerë.

Në vitin 360 H/971 G në qytetin e Asbehanit, pasiqë jetoi njëqin vjet dhe dhjetë muaj (sipas vitit lunar) përfundoi jeta e tij në këtë botë. U varros në afërsi të sahabiut të njohur Hamame Ed Devsi, radijall-llahu anhu, i cili në këtë vend ra shehid gjatë hilafetit të Umerit, radijall-llahu anhu. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Burimet e bigrafisë: Sijer A'lam En Nubela, 16/119-130; El Muntedham, 14/206; Vefejatul E'jan, 2/141; Lisanul Mizan, 4/77; El Bidaje ven Nihaje.

Përktheu: Talha Kurtishi
2.4.2004

Ibën Hibban

Ebu Hatim ibën Hibban el Busti; Ibën Hibbani ishte një hafidh i besueshëm i hadithëve, njohës i mirë i lëmvive të hadithit dhe të transmetuesve të tij. Përkrah hadithit ai ishte ekspert në astronomi, në lëmitë e gjuhës arabe dhe mjekësi. Libri i tij Es Sahih me 7495 hadithe konsiderohet prej referencave kryesore të hadithit.

Quhet Ebu Hatim, Muhammed ibën Hibban ibën Ahmed ibën Hibban ibën Muadh ibën Ma'bed ibën Se'id ibën Sehid ibën Hedijje ibën Murre El Busti, Et Temimi, Ed Darimi.

Rrjedh prej fisit Benu Temim i cili është prej fiseve arabe të njohur. Paraardhësi i tij ka luftuar së bashku me udhëheqësin Muhammed ibën Kasim Eth Thekafi i cili e çliroi krahinën e Sakhistanin dhe vendosi të mbetet në të për shkak të natyrës së saj magjepsëse, plot me lumenj dhe kopshte të gelbërta. Për vendbanim e zgjodhi qytetin El Bust (në Afganistan) dhe në këtë qytet lindi imami për të cilin flasim.

Këtë qytet në të cilin ka lindur imami fillimisht e çliroi sahabiu i njohur Abdur Rahman ibën Semure, radijall-llahu anhu, në vitin 43 H.. Po në atë vit është çliruar edhe kryeqyteti i Afganistanit Kabuli. Askush prej historianëve, në mënyrë të prerë, nuk e cek vitin në të cilin ka lindur Imam Ibën Hibbani, përpos Dhehebiut i cili thotë se ka lindur pas vitit 270 H.

Në kërkim të hadithit:

Ibën Hibbani udhëtoi shumë për të tubuar hadithet e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Këtë gjë ia lehtësoi edhe gjendja e mirë ekonomike e familjes së tij. Gjatë udhëtimeve vizitoi shumë qendra të diturisë. Jakuti, njëri prej historianëve tregon se Ibën

Hibbani ka vizituar 43 krahina duke mos i numëruar qytetet dhe fshatërat. Ai në atë kohë e vizitoi tërë botën islame duke ecur në këmbë dhe duke kalëruar, gjë e cila me siguri kërkon durim dhe vetmohim. Në këtë mënyrë ai kaloi mijëra kilometra, me një qëllim të vetëm, të tubon trashëgiminë e të dashurit Muhammed, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Gjatë këtyre udhëtimeve ai është takuar me shumë mësues të cilit numërohen me mijëra. Dhehebiu duke përmendur numrin e mësuesve të tij tregon se ai numër kalon 2000-shin!

Në mesin e vendeve që i ka vizituar do t'i përmendim: Herat, Merv, Senxh, Buhara, Nesa, Nejsabur, Xhurxhan, Ehvaz, Basra, Bagdad, Kufa, Mosul, Tarsus, Hims, Damask, Bejrut, Kuds, Egjipti dhe tjerë.

Mësuesit e tij:

Ne këtu do t'i përmendim vetëm ata që konsiderohen imamë dhe dijetarë të shquar të hadithit. Ata janë:

Ebu Ja'la El Musilij autor i Musnedit të njohur, Hasan ibën Sufjan En Nesevi, Ebul Halife El Xhumehi, Ebul Abbas El Lahmi El Askalani, Abdullah ibën Muhammed El Ezdi, Umer ibën Muhammed El Hemedani, Abdullah ibën Muhammed El Firjabi El Makdisi, Ebu Bekr ibën Huzejme, Umer ibën Se'id Et Tai, Imran ibën Musa Es Sihtijani, Husejn ibën Idris El Herevi, Muhammed ibën Abdullah Er Razi, Is-hak ibën Ibrahim El Busti, Ahmed ibën Jahja Et Tusterij dhe tjerë.

Përpos hadithit imami në mënyrë të gjërë studioi edhe shkencën e fikhut dhe u bë kadi një kohë në qytetet Samarkand, Nesa dhe tjerë. Ndikimin më të madh në lëminë e fik-

hut mbi të e pati Imam Ibën Huzejme i cili ia mësoi mënyren e nxjerrjes të dispozitave fetare prej teksteve të Kur'anit dhe Sunnetit.

Nxënësit e tij:

Nxënës të shumtë vizitonin këtë dijetar në medresen të cilën e ndërtoi ai në qytetin e Nejsaburit. Në këtë vend mësonin shkencat e hadithit dhe shkencat e tjera. Shumë prej tyre u bënë dijetarë të njohur dhe hafidhë të hadithit. Do përmendim:

Ebu Abdullah El Hakim En Nejsaburi, Ebu Abdullah ibën Mendeh El Asbehani, ebul Hasen Ed Darekutni, Mensur ibën Abdullah Edh Dhuhli, Muhammed ibën Ahmed En Nukati dhe tjerë.

Shuajb Arnauti, shqiptar, një prej dijetarëve të hadithit, tregon se Ibën Hibban bibliotekën e tij e bëri vakëf për nxënësit e diturisë, ndërtoi shkollë dhe konvikt i cili konsiderohet shembulli i parë i shkollës të specializuar për studimin e hadithit.

Fjalët e imamëve për te:

Shumë prej dijetarëve vërtetuan autoritetin shkencor dhe kualitetet e Imam Ibën Hibbanit edhe pse disa prej tyre e akuzuan gjëkjo e cila ndodhë me shumë dijetarë të cilët nuk gjejnë kuptim tek bashkëkohorët e tyre. Xhelozia dhe zemërgushtësia e tyre shpeshherë ishin shkaqe për sulm mbi të.

Imam Hakimi, autori i Mustedrekut thotë: Ibën Hibbani ka qenë dijetar i shkëlqyeshëm në shumë lëmi për këtë shak shumë njerëz kishin zili ndaj tij.

Ibën Sem'ani dhe Ibën Haxheri e konsiderojnë Imam të kohës së tij.

Hakimi kështu e përshkruan atë: Ishte rezervuar i diturisë të fikhut, gjuhës, hadithit dhe retorikës (dija që shtjellon rregullat e parimet e gojëtarisë; mjeshtëria e gojëtarisë). Një prej njerëzve më të mençur.

Jakut El Hamevi: Shumë mirë e njëjthe hadi-

thin, udhëtonte shumë për të tubuar dituri dhe dëgjoji prej shumë mësues. Dinte shumë tekste të hadithit dhe senedet e tyre. Në shkencën e hadithit arriti atë të cilin shumë tjerë nuk patën mundësi ta arrijnë.

Veprat e tij:

Angazhimi i tij në shkrim është gjithashtu i madh. Mjeshtëria e tij shihet qartë në librat që i shkroi. Në to shihet supiliteti i konkludimit dhe nxjerrjes së dispozitave. Nxënësi i tij Hakimi thotë se aq paletë të madhe të shkrimeve nuk kanë arritur shumë dijetarë. Nga veprat e tij do t'i përmendim:

- Es Sahih, vepra e tij më e njohur të cilën e ka redaktuar dijetari shqiptar Shuajb El Arnaut

- Kitabuth Thikat, libri në të cilin i ka tubuar emrat e transmetuesve të hadithit besnik

- Kitabu Mexhruh-in, në të cilin i ka tubuar emrat e transmetuesve të hadithit që nuk e arrijnë gradën e besnikërisë

- Kitabu meshahiri ulemail emsar, në të cilin ka tubuar biografite e 1602 dijetarë prej tërë botës islame

- Kitabu reudatil ukala ve nuz-hetul fudalai, që trajton virtytet morale dhe çështjet e etikës.

- Kitabus Sahabe (për sahabet)

- Kitabut Tabi'in (për tabi'inët)

- Kitabu Etba'i Tabi'in (për etba'i tabi'inët)

- Shu'abul Iman (nga lëmia e besimit)

- llelu ma Esnede Ebu Hanife (hadith)

- llelu hadithi Malik (hadith)

- Garaibul Ahbar (hadith)

- Ma inferede bihi Ehlul Mekke min Es Sunen (hadith)

- Ma inferede bihi Ehlul Medine min Es Sunen (hadith) dhe të tjera.

Fundi i jetës:

Në vitin 354 H/965G në qytetin e lindjes ndërroi jetë Imam Ibën Hibbani. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjërë.

Përgatiti: Talha Kurtishi

26.3.2004

Tema: Festimi i mevludit

Numri: 1115 **Data:** 9.5.2003

Pyetje: ... qëndrimi i sheriatit në lidhje me kremtimin e mevludit?

Përgjigje:

1) Data në të cilën ka lindur i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk mundë të caktohet me bindje të prerë. Disa nga historianët pohojnë se data në të cilën ka lindur i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është 9/Rebiul Evvel e jo 12/Rebiul Evvel siç është përhapur. Nëse kjo është e saktë atëherë kremtimi i 12/Rebiul Evvelit është pa bazë në aspektin historik.

2) Nga aspekti i sheriatit kremtimi i mevludit nuk ka bazë sepse po të kishte bazë do ta bënte i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ose do ta porosiste Ummetin e tij. Kështu ajo do të mbahej mend dhe do të transmetohej dhe praktikohet.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij." El Hixhr, 9

Pasi që kuptuam se kjo nuk ka ndodhë kuptuam se kjo nuk është prej fesë dhe ajo që nuk është prej fesë nuk lejohet të adhurohet All-llahu me të, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, ka caktuar rrugën e cila na shpion drejt Tij. Këtë rrugë na e ka treguar i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe nuk na lejohet që ne si robër të All-llahut, subhanehu ve teala, të shpikim rrugë tjera. Kjo vepër (shpikja e adhurimeve) është krimë kundër All-llahut, subhanehu ve teala, dhe përgënjeshton ajetin në të cilin All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe" Maide, 3

Themi po të ishte mevludi nga feja e plotësuar do të ishte i pranishëm para se të vdes i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pasi që mevludi nuk ka qenë i njohur në kohën e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, atëherë nuk është prej fesë së plotësuar sepse All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Sot përsosa për ju fenë tuaj..."

Ai i cili pohon se kjo është nga feja e plotësuar e shpikur pas të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, përgënjeshton ajetin në fjalë.

Ata me praktikimin e mevludit dëshirojnë të shprehin dashurinë ndaj të Dërguarit duke e nxitur njëri tjetrin dhe duke i zgjuar aspiratat e larta ndaj ta Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Nuk ka dyshim se shprehja e dashurisë ndaj të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është pjesë e Imanit dhe nuk ka dyshim se a i cili nuk e don të Dërguarin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, më tepër se çdo gjë nuk e ka shijuar ëmbëlsinë e Imanit. Të gjitha këto janë adhurime të kërkuara në fe vetëm se ato duhet të praktikohen në mënyrë të cilën na e ka mësuar All-llahu, subhanehu ve teala, dhe i Dërguari i Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e jo

duke shpikur ibadete dhe adhurime të tjera siç është mevludi. Në këtë rast nuk pranohet puna e tyre (shprehja e dashurisë dhe respektit ndaj të Dërguarit) sepse kanë gabuar mënyrën (kanë shpikur gjë të cilën nuk e ka praktikuar i Dërguari i All-llahut).

Pastaj ne dëgjojmë shumë për gjërat e shëmtura që ndodhin gjatë kremtimit të mevludit, gjëra të cilat nuk i pranon as sheriati e as logjika e shëndosh. Në shumë prej kasideve që lexohen gjatë kremtimit të mevludit i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ngritet më lartë se sa është vendi i Tij. Disa njerëz duke e madhëruar të Dërguarin e kanë bërë të njëjtë sikur All-llahu, All-llahu na ruajt.

Disa prej mendjelehtëve të mashtruar kur lexojnë vargjet për lindjen e tij ngriten në këmbë në shenjë respekti duke thënë erdhi shpirti i të Dërguarit pra të ngritemi në këmbë në shenjë respekti. Kjo me të vërtetë është mendjelehtësi.

I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka urrejtur që për të të ngriten në këmbë shokët e tij dhe ata e zbatonin dëshirën e tij edhe pse më shumë se çdo gjë e donin.

Ky bidat është shpikur pas shekullit të tretë dhe është përzier me shumë gjëra që nuk janë prej Islamit siç është përziera mes burrave dhe grave dhe shumë gjëra tjera.

Muhammed ibën Salih El Uthejmin
përktheu: Talha Kurtishi
9.5.2003

Numri: 639 **Data:** 4.3.2001

Pyetje: ... mevluti, a është i lejuar në islam, nëse jo atëherë dua argument pse nuk është kur ajo është lindja e Pejgamberit, alejhis-selam?

Përgjigje: Falënderojmë All-llahun, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin.

Leximi i mevludit nuk është i lejuar në Islam, sepse këtë vepër nuk e ka bërë Pejgamberi, alejhis-selam. Po të ishte vepër e mirë do ta bënte atë Pejgamberi, alejhisselam.

Pastaj Pejgamberi, alejhis-selam, atë ditë që ka lindur në atë ditë edhe ka vdekur, çka të bëjmë ne të gëzohemi ose të pikëllohemi. (sipas njërit prej transmetimeve 12, Rebiul Evvel, është edhe dita e lindjes e edhe ajo e vdekjes së Pejgamberit, sall-llahu alejhi ve sel-lem sh.r.)

Kjo gjë nuk ka qenë e njohur te muslimanët shtatë shekuj me rradhë derisa kanë ardhur shiitët fatimit dhe e kanë shpikur mevludin në Egjipt. Prej kësaj date ka filluar kjo risi, për të larguar muslimanët nga adhurimet kryesore të tyre. Edhe kjo po ngjan me disa muslimanë; ata namaz nuk falin e mevlud bëjnë. Kjo është një paradoks të cilin vetëm te të krishterët mund ta gjeshë.

Pastaj ne si musliman i kemi vetëm tre festa: dy bajramet dhe ditën e xhuma, asgjë ma tepër... All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi
14.3.2001

Letra e humbur

Asnjëherë nuk më ka shkuar ndërmend ta bëjë këtë bibliografi, sepse nuk është specializimi i imi, as që kam patur kohë që do të më ndihmonte në këtë drejtim, mirëpo All-llahu, subhanehu ve teala, kur dëshiron ta realizojë një gjë, i lehtëson shkaqet për të. U sëmura me një sëmurdje të lehtë në shikimin tim, para më shumë se 12 viteve. Një mjek specialist më këshilloi që të pushoj, ta lë leximin, shkrimin dhe punën si orëndreqës, për gjashtë muaj.

Në fillim e zbatova këshillën e tij. I lash tërë këto gjëra dy javë rresht. Mirëpo pas këtyre ditëve më ngacmonte epshi dhe ma zburonte faktin që të veproj diçka gjatë këtij pushimi të mërzitshëm, ndonjë vepër e cila sipas meje nuk kundërshtohet me këshillën e mjekut. Mu kujtua një dorëshkrim i cili gjindej në bibliotekë, e cila quhej "Dhemul-Melahi", të Hafidh Ibën Ebi Dynjasë, e cila nuk ishte botuar, sipas asaj që e dija. Andaj thash: çka pengon që ta angazhoj dikend që të më shkruajë! Derisa ta përfundon shkrimin, e të vjen koha e krahasimit me origjinalin, do të kishite kaluar një kohë e mjaftueshme dhe unë do të kisha pushuar mjaft. Atëherë do të kisha mundësi ta krahasoj me origjinalin, sepse kjo vepër nuk kërkon shumë mund, i cili do të vinte ndesh me gjendjen time shëndetësore, në të cilën gjindesha. E pastaj do ta recenzoja dalngadal, do ti kisha përpunuar hadithet, e pastaj do ta botonim. Tërë këtë do ta bëjë në etapa që mos tia rëndoj vehtes gjendjen shëndetësore! Mirëpo kur ai që e shkruante arriti në mesin e këtij traktati, më tregoi se mungon një pjesë, i thash vazhdoje shkrimin e traktatit deri në përfundim.

Pastaj e krahasova me origjinalin, vërejtja se ka mangësi, i cili sipas vlerësimeve të mia ishte katër faqe, në një letër në mes të fletores. Fillova të mendoj për këtë gjë, si kam mundësi ta gjejë këtë pjesë të humbur? Ky traktat është i rruajtur në një vëllim, i cili ishte i vënduar në raftin ku shkruante: "Përmbledhje shkrimesh". Secili vëllim kishte disa traktate dhe libra, me shkrime, tema, letra, ngjyra dhe madhësi të ndryshme. I thash vehtes: ndoshta këtë letër e ka humbur libërlihdësi dhe e ka vënduar gabimisht në ndonjë vëllim prej këtyre vëllimeve! Kjo më shtyri që me vullnet dhe gjallëri ta kërkoj këtë letër, duke filluar me rradhë. Në këtë veprimtari e harova vehten dhe gjendjen shëndetësore në të cilën gjindesha, e kur më kujtohej, kisha me çka i arsyetohesha vehtes: kjo nuk është lexim, ky hulumtim nuk ndeshet me këshillën e mjekut, gjatë kësaj veprimtarie nuk jam duke shkruajtur, etj!

Sa i kalova disa vëllime, filloi të ma tërhjekin vëmendjen disa tituj të traktateve dhe librave të muhadithëve me autorite dhe të hafidhave të njohur, ndalesha te to, duke e studiuar dhe duke e hulumtuar, e shpresoja që ajo të shkruhej dhe të recenzohej, e pastaj të botohej, mirëpo zakonisht i gjeja me mangësi, e gjeja pjesën e parë, e nuk e gjeja të dytën, andaj nuk kisha ambicie për ti regjistruar tek unë. Vazhdova hulumtimin e letrës së humbur, mirëpo kot, kështu vazhdova derisa i kalova të gjitha vëllimet që qëndronin në këtë raft, e ato ishin 152 vëllime. Mirëpo gjatë hulumtimit të kësaj letre regjistroja në fletoren time titujt e disa librave që më pëlqenin, në këtë gjë më stimuloi edhe fakti se gjatë

hulumtimit i gjeta disa pjesë që mungonin, të cilat më herët ishin shkak që mos ti regjistroj ato libra.

Pasi që nuk e gjeta këtë letër në vëllimet e përmendura, thash në vehte: ndoshta gabimisht është venduar në vëllimet tjera të shkencës së hadithit, të regjistruara nën titullin "hadith"! fillova ti shfletoj vëllim vëllim, derisa i krewa të gjitha vëllimet, mirëpo nuk e gjeta. Por regjistrova te unë shumë tituj të librave dhe traktateve të ndryshme.

Edhe më tej i jepja arsye vetvetes dhe ia shtoja dëshirën për ta gjetur këtë letër të humbur. Kalova në hulumtimin e kësaj letrë në vëllimet e ndryshme të bibliotekës, nga një shkencë në tjetrën. Kështu i kalova të gjitha dorëshkrimet të gjindeshin në këtë bibliotekë, të cilat arrinin deri në dhjetë mijë copë, mirëpo kot, nuk e gjeta dot!

Por sërish nuk humba shpresë, sepse kishte edhe një sektor që njihet si "Dust", e që ishte një vend ku ishin grumbulluar të gjitha letrat dhe fletoret e ndryshme, që nuk u dihej origjina, andaj fillova ti hulumtoj me një precizitet të madh, por sërish pa dobi.

Tash e humba shpresën nga kjo letër, mirëpo vëreja se All-llahu më kishte hapur dyert e mëdha të dijes pas këtij aktiviteti, të cilën e kisha neglizhuar si shumë të tjerë, e kjo është fakti se në këtë bibliotekë kishte thesare të librave dhe traktateve në shkenca të ndryshme dhe të dobishme, të cilat na i kanë lënë gjyshërit tanë, All-llahu i mëshiroftë. Aty ka dorëshkrime të rralla, të cilat nuk gjinden në bibliotekat tjera botërore, e të cilat akoma nuk janë botuar.

Kur mu sqarua kjo dhe zuri vend në zemrën time, e vazhdova studimin e dorëshkrimeve të bibliotekës që nga fillimi e deri në fund, për herë të dytë nën prizmen e përvojës sime të parë, ku i regjistrova vetëm disa libra të zgjedhura.

Tani fillova ti regjistroj të gjitha librat që kanë të bëjnë me shkencën e hadithit, të cilat më bëjnë dobi mua në specializimin tim. Nuk lisha asgjë pa e regjistruar, edhe qoftë ajo edhe një letër e vetme, nga ndonjë libër ose nga ndonjë pjesë e panjohur! Sikurse All-llahu, subhanehu ve teala, më përgadiste për fazën e tretë dhe të fundit, e ajo ishte studimi i hollësishtëm, nxjerja e haditheve nga këto shkrime, duke i studiuar senedet dhe rrugët e tyre dhe duke i nxjerur edhe shumë dobi tjera prej tyre. Gjatë fazës së dytë i kisha përmbledhur disa dobi, të cilat i kisha zgjedhur në mënyrë spontane. E kur e krewa këtë fazë, mu mbush mendja se duhet ti studioj të gjitha këto libra dhe traktate një nga një.

Andaj përvjela krahët dhe fillova studimin për herë të tretë, nuk lija asnjë faqe pa e shfjetuar, asnjë letër pa e lexuar, nxirja prej tyre përfitimet shkencore që i rastisja aty, hadithet e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nga e tërë kjo mu grumbulluan mëse katërdhjetë vëllime, kurse në secilin vëllim mbi katërqind letra, kurse në secilën fletë nga një hadith, të referuara në të gjitha burimet që e kisha gjetur, me senedet dhe rrugët e tija. Këto hadithe i rendita sipas alfabetit. Nga këto vëllime i ushqej të gjitha shkrimet dhe projektet e mia shkencore. Kjo më ndihmon shumë në recenzimet shkencore, gjë që nuk i mundësohet shumë dijetarëve, sidomos në këtë kohë, kur njerzit mjaftohen me referimin në disa vepra të reduktuara në shkencën e hadithit po edhe në shkencat tjera! Ky thesar gjigant i hadithit që u grumbullua te unë, nuk do të grumbullohej poqese nuk do të ma mundësonte All-llahu këtë studim duke e kërkuar atë letër të humbur! All-llahun e falënderojmë që me dhuntitë e tija përfundojnë veprat e mira".

Muhammed Nasirud-din Albani

Marrë nga hyrja e librit "Bibliografia e Bibliotekës Edh-Dhahirije"

Përktheu: Bekir Halimi

9. Lidhja farefisnore

Transmeton Ebu Hurerja, radijall-llahu anhu, i cili thotë: kam dëgjuar Pejgmaberin, salall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: “kush dëshiron t'i shtohet rizku (furnizimi) dhe t'i zgjatet jeta le të mbajë lidhjet farefisnore.” (Buhariu dhe Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Dhe keni frikë All-llahun që me emrin e Tij përbetoheni, dhe ruajeni farefisnën (akraballëkun)” (Nisa – 1)

Në një ajet tjetër thotë: “Dhe ata që e mbajnë lidhjen për të cilën All-llahu ka urdhëruar të mbahet, që frikësohen nga Zoti i tyre dhe nga llogaria e rëndë e përgjegjësisë.” (Ra'd – 21)

Farefisi nënkupton të afërmit të cilët i lidhë prejardhja, pa marrë parasyshë a trashëgojnë njëri tjetrin apo jo, është mahrem (person me të cilin ndalohet martesë me të) apo nuk është. Disa dijetarë mendojnë se farefis janë vetëm ata që nuk mund të martohen ndërmjet tyre, mirëpo mendimi i parë është më i saktë sepse sipas të dytit patjetëron nxjerrjen e fëmijëve të axhës, hallës, dajës dhe tezes nga farefisi e që nuk është e saktë. (Fet-hul Bari – 10/414)

Kadi ljadi thotë: nuk ka dallim në mendime rreth asaj se mbajtja e lidhjes farefisnore është vaxhib (obligim) në përgjithësi dhe se ndërprerja e saj është mëkat i madh... mirëpo kjo lidhje është në gradë dhe disa gradë janë më të larta se të tjerat. Më e ulta është mos heqja dorë plotësisht dhe mbajtja e lidhjes me fjalë madje edhe vetëm me selam. E tërë kjo dallon sipas dallimit të mundësisë dhe nevojës. Ndonjëherë mbajtja e lidhjes farefisnore është vaxhib e ndonjëherë mustehab (vepër e preferuar). Nëse ndokush mban lidhjet farefisnore mirëpo jo në mënyrë të plotë, nuk konsiderohet se ka ndërprerë këtë lidhje, e nëse duke patur mundësi bën lëshime rreth këtij obligimi, nuk konsiderohet se i mban lidhjet farefisnore. (Sahihul Muslim, sherh Ennevevj – 16/113)

Nga hadithi i lartpërmendur kuptojmë se shtimi i rizkut dhe bereqetit të tij, zgjatja e jetës dhe bereqetit të saj dhe udhëzimi për të bërë vepra të mira janë fryt i mbajtjes së lidhjeve farefisnore.

Pasi që Allahu, subhanehu ve teala, i krijoi të gjitha krijesat “lidhja farefisnore tha: kjo është pozita që kërkon strehim prej teje nga këputja e lidhjes farefisnore. Tha: po, a nuk dëshiron që të mbaj lidhje me atë që mban lidhje me ty dhe t'i ndërpres me atë që i ndërpret me ty? Ajo tha: po, si jo o Zoti im. Tha: ajo është për ty. Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: lexoni nëse dëshironi: “A pritët prej jush (hipokritëve) që nëse merrni sundimin (ose zbrapsetni prej fesë islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërpreni lidhjet e akraballëkut?” (Muhammed – 22) (Transmeton Buhariu)

Mbajtja lidhjeve farefisnore është shkak për të hyrë në Xhennet. Ebu Ejjub Ensarij thotë:

Një njeri i tha Pejgamberit, salall-llahu alejhi ve sel-lem,: më trego ndonjë punë e cila më fut në Xhennet! Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: sa i mprehtë që është! Pastaj tha: ta adhurosh Allahun dhe askend mos t'ia shoqërosh Atij, ta falish namazin, të japësh zekatin dhe t'i mbash lidhjet farefisnore." (Buhariu)

Gjithashtu transmetohet nga Abdull-llah ibën Amr ibën el-'As, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nuk mban lidhjet farefisnore ai që kthen (vizitat) por është ai që kur i ndërpritet farefisnia i rivendos lidhjet (me ta)". (Buhariu)

Erdhi një njeri te Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe i tha atij: o i Dërguar i Allahut! Unë kam disa të afërm me të cilët mbaj lidhje farefisnore kurse ata nuk mbajnë me mua, u bëj mirë kurse atë më bëjnë keq dhe sillem butë me ta kurse ata sillen me arrogancë ndaj meje. Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: nëse vërtet është ashtu si thua atëherë është njësoj sikur t'i ushqesh ata me hi të nxehtë, dhe vazhdimisht do të jetë me ty një ndihmës i Allahut kundër tyre, përderisa je në këtë gjendje." (Buhariu)

Poashtu Pejgamberi, alejhis-salam, thotë: "nuk hyn në Xhennet ai i cili këput lidhjet farefisnore." (Buhariu)

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)

□ h